Raporti me i pershtatshem i volumit te inerteve te trasha ne volumen e inerteve te imta duhet te vendoset nga prova e ngjeshjes se kubikeve te betonit, por Mbikqyresi i Punimeve mund te urdheroje qe keto raporte te ndryshojne lehtesisht sipas klasifikimit te inerteve ose sipas peshes ne se do te jete e nevojshme, ne menyre qe te prodhohen klasifikimet e duhura per perzjerjet e inerteve te trasha dhe te holla. Sipermarresi duhet te beje disa prova ne kubiket e marre si kampione dhe te shenoje inertet dhe fraksionimin e tyre, perzjerjen e betonit ne fillim te punes dhe kur ka ndonje ndryshim ne inertet e imeta apo te trasha ose ne burimin e tyre te furnizimit. Keta kubike duhet te testohen ne laborator ne kushte te njejta, pervec rasteve te ndryshimeve te vogla ne raportet perkatese te inerteve te imta dhe te trasha (lart apo poshte) nga raporti me i mire i arritur nga analizat e sites. Kubiket duhet te testohen nga 7 deri 28 dite.

Nga rezultatet e ketyre provave (testeve) Mbikqyresi i Punimeve mund te vendose per raportet e trashesise se inerteve te imta qe duhet te perdoren per cdo perzjerje te mevoneshme gjate zhvillimit te punes ose deri sa te kete ndonje ndryshim ne inerte.

Shperndarja

Ne kantier nuk do te sillen inerte per tu perdorur derisa Mbikqyresi i Punimeve te kete aprovuar inertet per tu perdorur dhe masat per larjen, etj. Me tej nga Sipermarresi do te merren kampione ne cdo 75m³ nen mbikqyrjen e Mbikqyresit te Punimeve, per cdo tip inerti te shperndare ne kantier (terren) dhe te dorezuar perfaqesuesit te Mbikqyresit te Punimeve per provat e kontrolleve te zakonshme. Kosto e te gjitha testeve do te mbulohet nga Sipermarresi.

Ruajtja e materialit te betonit

Çimento dhe inertet duhet te mbrohen ne cdo kohe nga demtuesit dhe ndotjet. Sipermarresi duhet te siguroje nje kontenier apo ndertese per ruajtjen e cimentos ne shesh. Ndertesa ose kontenieri duhet te jete e thate dhe me ventilim te pershtatshem. Ne se do te perdoret me shume se nje lloj cimentoje ne punime, kontenieri apo ndertesa duhet te jete e ndare ne nendarje te pershtatshme sipas kerkesave te Mbikqyresit te Punimeve si dhe duhet ushtruar kujdes i madh qe tipe te ndryshme cimentoje te mos jene ne kontakt me njera tjetren. Thaset e cimentos nuk duhet te lihen direkt mbi dysheme, por mbi shtresa druri apo pjese te ngritur trotuari per te lejuar keshtu qarkullimin efektiv te ajrit rreth e qark thaseve. Çimentoja nuk duhet te

mbahet ne nje magazine te perkohshme, pervec rasteve kur eshte e nevojshme per organizimin efektiv te perzjerjes dhe vetem kur eshte marre aprovimi i meparshem i Mbikqyresit te Punimeve. Agregati duhet te ruhen ne kantier ne hambare ose platforma betoni te padeptueshme te pergatitura posacerisht, ne menyre qe fraksione te ndryshme inertesh te mbahen te ndara per gjithë kohen ne menyre qe perzierja e tyre te ulet ne minimum. Sipermarresit mund t'i kerkohej te kryeje ne kantier procese shtese dhe/ose larje efektive te inerteve atehere kur sipas Mbikqyresit te Punimeve ky veprim eshte i nevojshem per te siguruar qe te gjitha inertet plotesojne kerkesat e specifikimeve ne kohen kur materialet e betonit jane perzjere. Mbikqyresi i Punimeve do te aprovoje metodat e perdorura per pergatitjen dhe larjen e inerteve.

Uji per cemento

Uji i perdorur per beton duhet te jete i paster, i fresket dhe pa balte, papasteri organike vegjetale dhe pa kripera dhe substanca te tjera qe nderhyjne ose demtojne forcen apo durueshmerine e betonit. Uji duhet te sigurohet mundesisht nga furnizime publike. dhe mund te merret nga burime te tjera vetem nese aprovohet nga Mbikqyresi i Punimeve. Nuk duhet te perdoret asnjehere uje nga germimet, kullimet siperfaqesore apo kanalet e vaditjes. Vetem uje i aprovuar nga ana cilesore duhet te perdoret per larjen e pastrimin e armaturave, kujdesin e betonit si dhe per qellime te ngjashme.

05. Kërkesat për përzjerjen e betonit

- Fortesia
- Klasa e betonit

Fortesia

Klasifikimet i referohen raporteve te cementos, inertve te imta dhe inerteve te trasha. Kerkesat per perzjerjen e betonit duhet te konsistojne ne ndarjen propocionale dhe perzjerjen per fortesite e meposhtme kur behen testet e kubikeve;

Klasa e betonit	Fortesia ne shtypje ne N/mm2 (NEWTON/mm2) 7 dite 28 dite
Klasa A&A (M100) (s)1:1,5: 3	17.00 25.50
Klasa B&B (M200) (s)1:2:4	14.00 21.00

Klasa C&C (M250) (s)1:3:6	6.50 10.00
Klasa D&D (M300) (s)1:6:12	Me pelqimin e Menaxherit te Projektit

Shenim. (s) = Çimento sulfate e rezistueshme.

Raporti uje-cimento

Raporti uje-cimento eshte raport i peshes se cimentos ne te. Permbajtja e ujit duhet te jete efikase per te prodhuar nje perzjerje te punueshme te fortesise se specifikuar, por permbajtja totale e ujit duhet te percaktohet nga tabela e meposhtme:

Klasa e betonit	Max. i ujit te lire/raporti cimento
Klasa A&A (M100) (s)1:1,5: 3	0.5
Klasa B&B (M200) (s)1:2:4	0.6
Klasa C&C (M250) (s)1:3:6	0.65
Klasa D&D (M300) (s)1:6:12	Me pelqimin e Menaxherit te Projektit

Shenim. (s) = Çimento sulfate e rezistueshme.

Qendrueshmeria

Raportet e perberesve duhet te jene te ndryshem per te siguruar qendrueshmerine e deshiruar te betonit kur provohet (testohet), ne pershtatje me kerkesat e meposhtme ose sipas urdherave te Mbikqyresit te Punimeve.

Perdorimet e betonit	Min&Max (mm)
Seksionet normale te perforcuara te ngjeshura me vibrime, ngjeshja me dore e mases se betonit	25 ne 75
Seksione prej betonarmeje te renda	50 ne 100 te

ngjeshura me vibracion, beton i ngjeshur
me dore ne pllaka te perforcuara normalisht,
trare, kollona dhe mure.

Ne te gjitha rastet, raportet e agregatit ne beton duhet te jene te tilla qe te prodhohen perzjerje te cilat do futen neper qoshe edhe cepa te formave si dhe perreth perforcimit pa lejuar ndarjen e materialeve.

06. Matja e materialeve

Inertet e imeta dhe te trasha do te peshohen ose te maten me kujdes ne pershtatje me kerkesat e Manaxheri te Projektit. Ato nuk do te maten ne asnje rast me lopata apo karroca dore. Cemento do te matet me thase 50 kg dhe masa e perzjerjes do te jete e tille qe grumbulli i materialeve te pershtatet per nje ose me shume thase.

07. Metodat e përzjerjes

Betoni duhet te perzjehet ne perzjeresa mekanike te miratuar qe me pare. Perzjersi, hinka dhe pjesa perpunuese e tij duhet te jene te mbrojtura nga shiu dhe era. Inertet dhe cemento duhet te perzjehen se bashku para se te shtohet uje derisa persjerja te fitoje ngjyren dhe fortesine e duhur. Duhet te largohen papastertirat dhe substancat e tjera te padeshirueshme. Uji nuk duhet te shtohet nga zorra apo rezervuare ne menyre te pakujdesshme. i gjithe betoni duhet te perzihet uniformisht ne fabrika moderne perzjerjeje per prodhimin maximal te betonit te nevojshem per plotesimin e punes brenda kohes se percaktuar pa zvogeluar kohen e nevojshme per perzjerje. Betoni duhet te perzjehet ne perzjeresa betoni per kohezgjatjen e kerkuar per shperndarjen uniforme te perberesve per te prodhuar nje mase homogjene me ngjyre dhe fortesi por jo me pak se 1- 1/2 minute. Perzjersi duhet te perdoret nga punetore te specializuar qe kane eksperience te meparshme ne drejtimin e perdorimin e pezjeresit te betonit. Me mbarimin e kohes se perzjerjes, perzjersi dhe te gjitha mjetet e perdorura do te pastrohen mire perpara se betoni i mbetur ne to te kete kohe te forcohet. Ne asnje menyre nuk duhet qe betoni te perzjehet me dore pa miratimin e Mbikqyresit te Punimeve, miratim ky qe do te jepet vetem per sasi te vogla ne kushte te vecanta.

08. Provat e fortësisë gjatë punës

Sipermarresi duhet te siguroje per qellimet e provave nje set 3 kubikesh per cdo strukture betoni, perfshire derdhje betoni nga 1-15 m³. Per derdhje betoni me shume se 15 m³, Sipermarresi duhet te siguroje te

pakten nje set shtese 3 kubikesh per cdo 30 m³ shtese. Ne se mesatarja e proves se fortesise se kampionit per cdo porcion te punes bie poshte minimumit te lejueshem te fortesise se specifikuar, Mbikqyresi i Punimeve do te udhezoi nje ndryshim ne raportet ose permbajtjen e ujit ne beton, ose te dyja, ne menyre qe Punedhenesi te mos kete shtese kostoje. Sipermarresi duhet te percaktojte te gjitha kampionet qe kane te bejne me raportet e betonimit prej nga ku jane marre. Nese rezultatet e testeve te fortesise mbas kontrollit te specimentit tregojne se betoni i perftuar nuk i ploteson kerkesat e specifiuara ose kur ka prova te tjera qe tregojne se cilesia e betonit eshte nen nivelin e kerkesave te specifiuara, betoni ne vendin, qe perfaqeson kampioni do te refuzohet nga Mbikqyresi i Punimeve dhe Sipermarresi do ta levize dhe ta rivendose masen e kthyer te betonit mbrapsh me shpenzimet e veta. Sipermarresi do te mbuloje shpenzimet e te gjitha provave qe do te behen ne nje laborator qe eshte aprovuar Punedhenesit.

09. Transportimi i betonit

Betoni duhet te levizet nga vendi i pergatitjes ne vendin e vendosjes perfundimtare sa me shpejt ne menyre qe te pengohet ndarja ose humbja e ndonje perberesi.

Kur te jete e mundshme, betoni do te derdhet nga perzjeresi direkt ne nje paisje qe do te beje transportimin ne destinacionin perfundimtar dhe betoni do te shkarkohet ne menyre aq te mbledhur sa te jete e mundur ne vendin perfundimtar per te shmangur shperndarjen ose derdhjen e tij.

Ne se Sipermarresi propozon te perdore pompa per transportimin dhe vendosjen e betonit, ai duhet te paraqese detaje te plota per paisjet dhe tekniken e perdorimit qe ai propozon per te perdorur per tu miratuar tek Mbikqyresi i Punimeve.

Ne rastet kur betoni transportohet me rreshqitje apo me pompa, kantieri qe do te perdoret, duhet te projektohet per te siguruar rrjedhjen e vashdueshme dhe te panderprere ne rrepre apo gryke (hinke). Fundi i pjerresise ose i pompes se shperndarjes duhet te jete i mbushur me uje para dhe pas cdo periudhe pune dhe duhet te mbahet paster. Uji i perdorur per kete qellim, duhet te largohet (derdhet) nga cdo ambjent pune i perhershem.

10. Hedhja dhe ngjeshja e betonit

Sipermarresi duhet te kete aprovimin e Mbikqyresit te Punimeve per masat e propozuara perpara se te filloje betonimin.

Te gjitha vendet e hedhjes dhe te ngjeshjes se betonit, duhet te mbahen ne mbikqyrje te vazhdueshme nga pjesetaret perkates te ekipit te Sipermarresit. Sipermarresi duhet te ndjeke nga afer ngjeshjen e betonit, si nje pune me rendesi te madhe, objekt i te cilit do te jete prodhimi i nje betoni te papershushem nga uji me nje densitet dhe fortesi maximale.

Pasi të jete perzjere, betoni duhet të transportohet në vendin e tij të punës sa më shpejt që të jete e mundur, i ngjeshur mirë në vendin rreth perforcimit, i perzjere sic duhet me lopate me mjete të pershtatshme celiku për kallepe duke siguruar një sipërfaqe të mirë dhe beton të dendur, pa vrime, dhe i ngjeshur mirë për të sjelle ujë në sipërfaqe dhe për të ndaluar xhepat e ajrit. Armatura duhet të jete e hapur në mënyrë të tillë që të lejoje daljen e bulezave të ajrit, dhe betoni duhet të vibrohet me çdo kusht me mekanizma vibruese për të bërë atë të dendur, aty ku është e nevojshme. Betoni duhet të hidhet sa është i fresket dhe para se të kete fituar qëndrueshmëri fillestare, dhe në çdo rast jo më vonë se 30 minuta pas perzjerjes. Metoda e transportimit të betonit nga perzjerësi në vendin e tij të punës duhet të aprovohet nga Mbikqyresit i Punimeve.

Nuk do të lejohet asnjë metode që nxit ndarjen apo vecimin e pjeseve të trasha dhe të holla, apo që lejojnë derdhjen e betonit lirisht nga një lartësi më e madhe se 1.5m. Kur hedhja e betonit ndërpritet, betoni nuk duhet në asnjë mënyrë të lejohet të formoje skaje apo ane, por duhet të ndalohet dhe të forcohet mirë në një ndalesë të ndertuar posacerisht dhe të formuar mirë për të krijuar një bashkim konstruktiv efikas, që është në përgjithësi, në qoshet e djathta drejt armatimit kryesor. Pozicioni dhe projekti i fugave të tilla, duhet të aprohen nga Mbikqyresit i Punimeve. Menjëherë para se të hidhet betoni tjetër, sipërfaqet e të gjitha fugave duhet të kontrollohen, të pastrohen me furçe dhe të lahen me llaç të pastër. Është e këshillueshme që ashpersia e betonit të jete arritur kur ngjyra bëhet gri dhe të mos lihet derisa të forcohet.

Para se betoni të hidhet në ose kundrejt një germimi, ky germim duhet të jete i forcuar dhe pa ujë të rrjedhshëm apo të ndenjtur, vaj dhe lende të demshme. Balta e qullet dhe materialet e tjera dhe në rast germimi guresh, copesa dhe thërmija do të hiqen. Gropa duhet të jete e qullet por jo e lagur dhe duhet të ndërmerren masa paraprake për të parandaluar ujërat nënetokesore që të demtojnë betonin e pa hedhur ose të shkaktojnë levizjen e betonit.

Aty ku është e nevojshme apo e kërkuar nga Mbikqyresit i Punimeve, betoni duhet të vibrohet gjatë hedhjes me vibratore të brendshme, të afta për të prodhuar vibrime jo më pak se 5000 cikle për minutë. Sipërmarresi duhet të tregojë kujdes për të shmangur kontaktin midis vibratorëve dhe perforcimit, dhe të evitojë vecimin e inerteve nga vibrimi i tepert. Vibratorët duhet të vendosen vertikalisht në beton 500 mm larg dhe të terhiqen gradualisht kur fluckat e ajrit nuk dalin më në sipërfaqe. Nqs, në vazhdim, shtypja është aplikuar jashtë armatures, duhet të kihet kujdes i madh që të shmangët demtimi i betonarmesë.

Kur betoni vendoset në ndalesa horizontale ose të pjerreta të kalimit të ujit, kjo e fundit duhet të zhvendoset duke i lene vendin betonit që duhet të ngjeshet në një nivel pak më të lartë se fundi i ndalesës së ujit para se të leshohet uji për të siguruar ngjeshje të plote të betonit rreth ndalesës së ujit.

11. Betonim në kohë të nxehtë

Sipërmarresi duhet të tregojë kujdes gjatë motit të nxehtë për të parandaluar carjen apo plasaritjen e

betonit. Aty ku eshte e realizueshme, Sipermarresi duhet te marre masa qe betoni te hidhet ne mengjes ose naten vone.

Sipermarresi duhet te kete kujdes te vecante per kerkesat e specifiuara ketu per kujdesin.

Kallepet duhet te mbulohen nga ekspozimi direkt ne diell si para vendosjes se betonit, ashtu edhe gjate hedhjes dhe vendosjes. Sipermarresi duhet te marre masa te pershtatshme per te siguruar qe armimi dhe hedhja e mases per tu betonuar eshte mbajtur ne temperaturat me te uleta te zbatueshme.

12. Kujdesi për betonin

Vetem neqoftese eshte percaktuar apo urdheruar ndryshe nga Mbikqyresi i Punimeve, te gjitha betonet do te ndiqen me kujdes si me poshte:

1. Siperfaqe betoni horizontale: do te mbahet e laget vashdimisht per te pakten 7 dite pas hedhjes. Ato do te mbulohen me materiale uje mbajtes si thase kerpi, pelhure, rere e paster ose rrogos ose metoda te tjerra te miratuara nga Mbikqyresi i Punimeve.
2. Siperfaqe vertikale: do te kujdesen fillimisht duke lene armaturat ne vend pa levizur, duke varur pelhure ose thase kerpi mbi siperfaqen e perfunduar dhe duke e mbajtur vazhdimisht te laget ose duke e mbuluar me plasmas.

13. Forcimi i betonit

Me perfundimin e germimit dhe aty ku tregohet ne vizatimet ose urdherohet nga Mbikqyresi i Punimeve, nje shtrese forcuese betoni e kategorise D jo me pak se 75 mm e trashje ose e thelle do te vendoset per te parandaluar shperberjen e mases dhe per te formuar nje siperfaqe te paster pune per strukturen.

14. Hekuri i armimit

Shufrat e armimit duhet te kthehen sipas masave dhe dimensioneve te vizatimeve, dhe ne perputhje te plote me rregulloren e, rishikuar se fundi te ASTM, shenimi A615 me titullin "Specifikimet per shufrat e hekurit per betonarme". Ato duhet te perkulen ne perputhje me vizatimet e ASTM A-305, Celik 3 me sigma te rrjedhshmerise 250 kg/cm² .

Hekuri i armimit duhet te jete pa njolla, ndryshk, mbeturina te mullijve, bojera, vajra, graso, dherave ngjitese ose ndonje material tjetër qe mund te demtoje lidhjen midis betonit dhe armimit ose qe mund te shkaktoje korrozion te armimit ose shperberje te betonit. Çimento per suva nuk duhet te lejohet. As madhesia dhe as gjatesia e shufrave nuk duhet te jene me pak se madhesia ose gjatesia e treguar ne vizatime.

Shufrat duhet te perkulen gjithmone ne te ftohte. Shufrat e perkulura jo sic duhet do te perdoren vetem ne se mjetet e perdorura per drejtimin dhe riperkuljen te jene te tilla qe te mos demtoje materialin. Asnje armim nuk do te perkulet ne pozita pune pa aprovimin e Mbikqyresit te Punimeve, ne se eshte ngulur ne betonin e forcuar. Rrezja e brendeshme e perkuljeve nuk duhet te jete me e vogel se dyfishi i diametrit te

shufrave per hekur te bute dhe trefishi i diametrit te shufres per hekur shume elastik.

Armimi duhet te behet me shume kujdes dhe te mbahet nga paisjet e miratuara ne pozicionin e paraqitura ne skica. Shufrat qe jane parashikuar te jene ne kontakt duhet te lidhen se bashku me siguri te larte ne te gjitha pikat e kryqezimit me tel te kalitur hekuri te bute me diameter.No.16. Kordonat lidhes dhe te tjeret si keto duhet te lidhen fort me shufrat me te cilat jane parashikuar te jene ne kontakt dhe pervec kesaj duhet te lidhen ne menyre te sigurte me tel. Menjehere para betonimit, armimi duhet te kontrollohet per saktesi vendosjeje dhe pastertie dhe do te korigjohet ne se eshte e nevojshme.

Spesoret duhet te jene prej llaci me cemento dhe rere 1:2 ose materiale te tjera te miratuara nga Mbikqyresi i Punimeve.

Sipermarresi duhet te pershtase masa efektive per te siguruar qe perforcimi te qendroje i palevizur gjate forcimit te mases se hedhur dhe vendosjes se betonit. Ne soletat e dhena me dy ose me shume shtresa perforcimi, shtresat paralele te hekurit duhet te mbeshteten ne pozicion me ndihmen e mbajteseve prej hekuri. Spesoret vendosen ne cdo mbajtese per te mbeshtetur shtresat e armimit nga forcimi ose armatura. Pervec se kur tregohet ndryshe ne skica, gjatesia e nyjeve bashkuese duhet te jete jo me pak se 40 here e diametrit te shufres me diameter me te madh. Armimet e ndertuara kur shtrohen perbri seksioneve te tjera te armimit ose kur xhuntohen, duhet te kene nje minimum xhunti prej 300mm per shufrat kryesore dhe 150 mm per shufrat e terthorta. Perdorimi i mbeturinave te prera nuk do te lejohet. Pervec se kur eshte specifiuar apo treguar ndryshe ne skica, mbulimi i betonit ne perforcimin me te afert duke perjashtuar suvane ose punime te tjera dekorative dhe forcim betoni, do te jete si me poshte:

1. Per pune te jashtme dhe per pune ne siperfaqe toke dhe ne struktura ujembajtese -50mm

2. Per pune te brendeshme ne struktura joujembajtese:

a) per trare dhe kolona-50mm ne hekurin kryesor dhe ne asnje vend me pak se 40mm ne shufren me afer murit te jashtem

b) per forcimin e soletave-25mm per te gjitha shufrat ose diametri i shufres me te madhe, ciladoqofte me e madhja.

Prerja, perkulja dhe vendosja e armimit do te jete pjese e punes brenda cmimit njesi te vendosura ne Oferten e tenderit per armimin e hekurit te furnizuar dhe te vene ne pune.

Projektimi i armimit nga puna qe eshte duke u realizuar ose e realizuar tashme, nuk do te kthehet ne pozicionin e sakte vetem ne rast se eshte miratuar nga Mbikqyresi i Punimeve dhe do te mbrohet nga deformimi ose demtime te tjera. Saldimi i shufrave te perforcuara me perjashtim te rasteve te shufrave te fabrikuara me saldim nuk do te lejohet.

Shufrat e perforcuara te ekspozuara per shtesa te ardhshme, do te mbrohen nga korrozioni dhe rrezique te tjera.

15. Kallëpet ose armaturat

Armaturat ose kallepet duhet të jenë në përputhje me profilet, linjat dhe dimensionet e betonimit të përcaktuara në skica, të fiksuara apo të mbështetura me pyka apo mjete të ngjashme për të lejuar që ngarkimi të jetë i lehtë dhe format të levizën pa demtime dhe pa goditje në vendin e punës.

Kallepi duhet të ndërtohet me vija që mbyllën lehtësisht për largimin e ujit, materialeve të demshme dhe për qëllime inspektimi, si dhe me lidhësa për të lehtësuar shkeputjen pa demtuar betonin. Të gjitha mbështetëset vertikale duhet të jenë të vendosura në mënyrë të tillë që mund të ulen dhe kallepi të shkeputet lehtë në goditje apo shëputje. Kallepe për traret duhet të montohen me një pjesë ngritëse 6mm për çdo 3m shtrirje.

Metodat e fiksimit të kallepit faqe të ekspozuara të betonit nuk duhet të përfshijnë ndonjë lloj fiksusi në beton në mënyrë që të kemi sipërfaqe të sheshtë betoni. Asnjë bulon, tel apo ndonjë mjet tjetër përdorur për qëllime fiksimi të kallepeve apo armimit nuk duhet të përdoret në betonim i cili do të jetë i papërshtueshëm nga uji. Lidhjet e përhershme metalike dhe spesoret nuk duhet të kenë pjesë të tyre fiksive si të përhershme Brenda 50 mm të sipërfaqes së përfunduar të betonit, dhe ndonjë vrimë e lenë në faqet e betonit e paekspozuar duhet që të mbyllet përmes një suvatimi me llacimento të fortë 1:2.

Një tolerancë prej 3mm në rritje në nivel do të lejohet në ngritjen e kallepit i cili duhet të jetë i fortë, rigjidhë për kundërshtim të lagësive, vibrimeve dhe ngarkësive të ndërimit dhe duhet të mbetet në përputhje të plote me skicën dhe nivelin e pranuar përpara betonimit.

Ajo duhet të jetë siç duhet i papërshtueshëm nga uji që të sigurojë që nuk do të ndodhin "disekuilibra" ose largimin e llacit për në bashkimet, ose të lengut nga betoni. Të gjitha qoshtet e jashtme të betonit që nuk janë vendosur përgjithmone në tokë duhet të jepen 18mm kanal, përveç atyre ku tregohet ndryshe në vizatimet.

16. Ndërtimi dhe cilësia e armaturës

Armatura duhet të jetë mjaft rigjide dhe e fortë në mënyrë që t'i qëndrojë forcat së betonit dhe të çdo ngarkëse konstruktive dhe duhet të jetë e formës së kërkuar. Njeri nga të dy materialet mund të përdoret, druri ose metali. Cilido material të jetë përdorur, duhet të jetë i mberthyer në mënyrë gjatësore dhe tërthore, i përforcuar dhe gjithashtu për të sigurojë rigjiditetin duhet të jetë i papërshtueshëm nga uji në të gjitha rastet e paparashikuara.

Armatura e mirë duhet të përdoret për të prodhuar një punë përfundimtare me cilësi të lartë pa varesisht që gjurmët e shenjave të kallepit të armimit mbi sipërfaqen e betonit do të mbeten. Armatura duhet të jetë nga veshje me dërrase të thate, ose armature me sipërfaqe metalike të cilësive së lartë duhet të përdoren. Armatura e cilësive së ulët mund të përdoret për sipërfaqe që duhet të suvatohen ose ato të propozuara në tokë, dhe duhet të montohen nga dërrasa në formë pykash me qoshtet e lemuara dhe të sigurta ose nga

armatura celiku te aprovuara.

Pjesa e brendshme e te gjithë armaturave (perjashto ato per punimet qe do te mbarohen me suvatim) duhet te lyhen me vaj liri, nafte bruto, ose sapun cdo here qe ato te fiksohen.

Vaji duhet te aplikohet perpara se te jete vendosur perforcimi dhe nuk duhet lejuar qe lysterja te preke peforcimin. Vajosja etj, behen qe te parandaloje ngjitjen e betonit tek armatura.

Armatura duhet te goditet pa tronditur, vibruar ose demtuar betonin. Armatura qe do te riperdoret duhet te riparohet dhe pastrohet perpara se te rivendoset. Siperfaqet e brendshme te gjithë armaturave duhet te pastrohen komplet perpara vendosjes se betonit.

Kur armatura eshte prej lende drusore, siperfaqja e brendshme duhet te laget pikerisht perpara se te hidhet betoni per te shmangur keshtu absorbimin e lageshtires nga betoni.

Megjithate per ndonje armature momentale ose te propozuar duhet te merret miratimi i Mbikqyresit te Punimeve, dhe Sipermarresi duhet te mbaje pergjegjesi te plote per kapacitetin e tij dhe per permbushjen e kesaj klauzole si dhe per ndonje konsekuence te dukshme te nje pune te parakohshme ose te demshme. Ai duhet te heqe dhe rivendose ndonje ngritje te manget ose derdhje te betonit per te cilen armatura ka defekte ne zbatim te kesaj klauzole, ne nje mase te tille sic ndoshta kerkohet nga Mbikqyresi i Punimeve. Pasi te vendoset ne pozicion armatura duhet te mbrohet kundrejt te gjitha demtimeve dhe efekteve te motit dhe ndryshimeve te temperatures. Ne qofte se kjo eshte gjetur si e pazbatueshme per vendosjen e menjehereshme te betonit, armatura duhet te inspektohet perpara se betoni te hidhet per t'u siguruar qe bashkimet jane te puthitura, qe forma eshte sipas modelit dhe qe te gjitha papastertite jane rihequr perfshire ndonje veprim te ujit nga lageshtira e permendur me siper .

Vetem lidhjet dhe shtrengimet etj. te aprovuara nga Mbikqyresi i Punimeve duhet te perdoren. Terheqjet, konet, pajisjet larese ose te tjera mekanizma te cilat lene vrime ose depresione ne siperfaqen e betonit me diametra me te medha se 20 mm nuk do te lihen brenda formave.

17. Heqja e armaturës

Armatura nuk duhet te levizet derisa betoni te arrije fortesine e duhur per te siguruar nje qendrueshmeri te struktures dhe per te mbajtur ngarkesen ne keputje dhe cdo ngarkese konstruktive qe mund te veproje ne te. Betoni duhet te jete mjaft i forte dhe te parandalohet demtimi i siperfaqeve nepermjet perdorjes me kujdes te veglave ne heqjen e formave.

Armatura duhet te hiqet vetem me lejen e Mbikqyresit te Punimeve dhe puna e dukshme pas marrjes te nje lejeje te tille duhet te kryhet nen supervizionin personal te nje tekniku ndertimi kompetent. Kujdes i madh duhet te ushtrohet gjate levizjes se armatures per te shmangur tronditjet ose ne te kundert shtypjen ne beton Ne rastin kur Mbikqyresi i Punimeve e konsideron qe Sipermarresi duhet te vonoje heqjen e armatures ose per shkak te kohes ose per ndonje arsye tjeter ai mund te urdheroje Sipermarresin qe te vonoje te tilla levizje dhe Sipermarresi nuk duhet te ankohet per vonesa ne konsekuence te kesaj.

Pavaresisht nga kjo ndonje njoftim i lejuar ose aprovim i dhene nga Mbikqyresi i Punimeve, Sipermarresi duhet te jete pergjegjes per ndonje demtim per punen dhe cdo demtim per rrjedhim shkaktuar nga levizja ose qe rezulton nga levizja e armatures.

18. Tipet e strukturave

Betoni i varfer

Ky lloj betoni do te perdoret menjehere mbi shtresen e zhavorrit te ngjeshur. Klasa e tij do te jete C16/20 dhe ky do te sherbeje si bazament per vendosjen e shtreses hidroizoluese. Megjithese kjo shtrese ka nje shtrese gjeotekstili per mbrojtje eshte e domosdoshme qe siperfaqja e betonit duhet te jete sa me e lemuar.

04. HEKURI

01. Materialet

Përgatitja e çelikut për të gjitha strukturat e betonit dhe komponentët e metalit, që duhen prodhuar në kantiere, duke konsideruar çelikin që plotëson të gjitha kërkesat e projektit dhe pa prezencën e ndryshkut, në format dhe përmasat sipas vizatimeve dhe standarteve tekniko-legale për bashkimin, lidhjen dhe duke e shoqëruar me çertifikatën e prodhuesit për të verifikuar që çeliku plotëson kushtet e kërkuara që nevojiten për punë të tilla dhe duke përfshirë të gjitha kërkesat e tjera jo të specifikuar.

02. Depozitimi në kantiere

Depozitimi i hekurit në kantiere duhet të bëhet i tillë, që të mos dëmtohet (shtrëmbërohet, pasi kjo gjë do të shtonte procesin e punës së parandërsjes) si dhe të mos pengojë punimet ose materialet e tjera të ndërtimit.

03. Kthimi i hekurit

- a) Hekurat duhen kthyer sipas dimensioneve të treguara në projekt.
- b) Përveç pjesës së lejuar më poshtë, të gjitha shufrat duhen kthyer dhe kthimi duhet bërë ngadalë, drejt dhe pa ushtrim force. Bashkimet e nxehta nuk lejohen.

04. Vendosja dhe fiksimi

Hekurat do të pozicionohen siç janë paraqitur në projekt dhe do të ruajnë këtë pozicion edhe gjatë betonimeve. Për të siguruar pozicionin e projektit ata lidhen me tel 1,25 mm ose kapëse të përshtatshme.

05. Mbulimi i hekurit

Termi mbulimi në këtë rast do të thotë minimumin e pastër të shtresës mbrojtëse ndërmjet sipërfaqes së

hekurave dhe faqes së betonit. Mbulimi minimal do të bëhet sipas normave të KTZ.

06. Ngjitja e hekurave

Bashkimi i shufrave të hekurit do të bëhet vetëm sipas vizatimeve të treguara të aprovuara nga Investitori. Gjatësia e mbivendosjes në një lidhje, nuk duhet të jetë më e vogël se ajo e treguara në vizatimet e punës.

05. PUNIME HEKUR BETONI

01. F.V Konstruksione metalike te thjeshta, me ngjyre te bardhe

Struktura perbehet nga profile çeliku te zinkuar. Kolonat jane me profile dhe dimensione te ndryshme, per kete duhen pare vizatimet dhe specifikimet perkatese. Profilet sillen ne kantier dhe do behet saldimi i pjeseve sipas vizatimeve perkatese. Pas saldimit struktura do lyhet me antiruxho dy duar dhe me pas do behet bojatisja ne vend me pistolete. Kodi i bojës do te percaktohet nga arkitekti. Themeli do jete me plinta betonarme me seksion sipas projektit konstruktiv. Kolonat e celikut kane ne baze nje pllake celiku qe kapen me bulona 4*M18 ne themelin e betonit.

06. PUNIME MURATURE

01. Llaç për muret


për 1 m³ llaç realizohet me këto përbërje:

- a. Llaç bastar me rërë natyrale lumi (me lagështi, shtesë në volum 20% dhe porozitet 40 % e formuar me rërë në raporte 1: 0, 8 : 8. Gëlqere e shtuar në 110 lt, çimento 32.5 N/mm², 150 kg, rërë 1.29 m³.
- b. Llaç bastar marka 25 me rërë natyrale lumi (me lagështi, shtesë në volum 20% me çimento: gëlqere: rërë në raporte 1: 0,5: 5,5. Gëlqere e shuar 92 lt, çimento 32.5 N/mm², 212 kg, rërë 1,22 m³.
- c. Llaç bastar marka 15 me rërë të larë (porozitet 35%) e formuar me, çimento, gëlqere, rërë në raport 1: 0,8: 8. Gëlqere e shuar 105 lt, çimento 300, 144 kg, rërë 1,03 m³.
- d. Llaç bastar marka 25 me rërë të larë (porozitet 35%) e formuar me, çimento: gëlqere, rërë në raport 1: 0,5:5,5. Gëlqere e shuar 87 lt, çimento 32.5 N/mm², 206 kg, rërë 1,01 m³.
- e. Llaç çimento marka 1:2 me rërë të larë e formuar me çimento, rërë në raport 1:2. Çimento 42.5 N/mm², 527 kg, rërë 0,89 m³.

02. Specifikim i përgjithshëm për tullat

Tulla si element i ndërtimit duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme për ndërtimet antisizmike:

- Rezistencën në shtypje, e cila duhet të jetë: për tullën e plotë 75 kg/cm²; për tullat me vrima 80 kg/cm²; për sapet 150 kg/cm².
- Rezistencën në prerje, e cila duhet të jetë: për të gjitha tullat me brima 20 kg/cm².
- Përqindjen e boshllëqeve, e cila duhet të jetë: për tullën e plotë 0-25 %; dhe për të gjitha tullat me brima mbi 60 %
- Trashësia e mishit perimetral dhe të brendshëm për tullat e plota, të mos jetë më e vogël se 8 mm dhe për të gjitha tullat me brima, trashësia e mishit perimetral të mos jetë më e vogël se 8 mm dhe e mishit të brendshëm, jo më e vogël se 6 mm.
- Sipërfaqja e një brime të mos jetë më e madhe se 4.5 cm².
- Ujëthithja në përqindje duhet të jetë me e madhe se 14 %.

Brick shape	CERTIFICATE - CE - 1372
	11 1372-CPD-1460
	EN 771-1:2011+A1:2015

03. Mur me tulle me 10 vrima, t =10cm, h ≈ 3m, llac perzier M15

Muraturë me tulla me 10 brima, me trashësi 10 cm realizuar me llaç bastard m-15 me

përmbajtje për m³: tulla me 10 vrima 260 copë, llaç 0,15 m³, çimento R32.5 N/mm² dhe ujë, përfshirë çdo detaj e kërkesë për dhëmbët e lidhjes, qoshet, skelave të shërbimit ose skelerinë si dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj.

Menyra e ndërtimit

Ndërtohet njeri mur tulle deri në lartësi 1 meter dhe me pas ndërtohet brezi si në rastin e murit perimetral. Ndërtohet pjesa e mbetur e murit deri në lartësi e arkitraut të derës, ndërtohet arkitrau i derës duke vazhduar si brez në pjesën përtej derës. Hekurat e brezit do të jenë si në rastin e brezave të përdorur tek muri perimetral. Keto hekura do të ngjiten patjetër me kolonat e betonit. Pas ndërtimit të murit të parë, faqja nga brenda suvatohet me llaç bastar M25 1cm. Në nesermen fillon ndërtimi i faqes së dytë të tullës.

Sapo arrihet lartesia 1 meter nga soleta mbushet me pambuk mineral guror dhe derdhet brezi i pare. Ne kete menyre vazhdojme deri lart. Keto mure nga siper duhet te shtrengohen duke i vendosur tullat ne menyre te pjerret ne shtresen e fundit, ose shtrengohen me shkume poliuretanike mbasi rreshti i fundit eshte bere drejt. Mbas perfundimit te mureve te tulles behet suvatimi dhe patinimi. Patinimi behet me stuko patinimi.

04. Mur me tulla te plota zak, llaç perzier M 25

Muraturë me tulla të plota me trashësi sipas projektit dhe llaç bastard m-25 sipas pikës 1 me përmbajtje për m³: tulla të plota 424 copë, llaç 0.19 m³, çimento 400 dhe ujë.



05. Mur gipsi tualete

Mur gipsi me tek strukture me panele rezistente ndaj ujit (çimentato) ne te dyja krahet

Pershkrimi

Ne fillim vendosim profile UD ne solete dhe ne tavan. Pastaj bejme shperndarjen e profile CD 50mm, dhe i pickojme ata lart dhe poshte. Fillojme me vendosjen e pllakes çimentato nga njeri krah duke ngjitur me silikonin perkates te furnizuar nga e njejta firme qe furnizon edhe pllakat pllaken ne vazhdim. E leme silikonin te thahet per 24 ore, dhe mbushjen e fugave dhe te kokave te vidave i bejme me llaçin perkates kunder lageshtires. Pasi sigurohemi qe jane bere te gjitha instalimet vazhdojme me mbylljen e krahut tjetër, ne te njejten menyre si me pare.

Trashesia e murit arrin ne 75 mm.

07. PUNIME SHITESASH

01. Mbushje me cakell e gur gurore, me kokriza deri në 75 mm, h=15cm

Çakulli që do të përdoret si nënshtresë duhet të jetë me prejardhje mali, i përbërë me gurë të coptuar, deri në 100mm. Përbërja duhet të ketë argjilë dhe rërë nga kava. Si nënshtresë, në varësi të specifikimit në projekt, hidhet maksimalisht deri në 80cm dhe ngjishet me rul me vibrim duke u lagur në maksimalisht 15%. Pas ngjeshjes, mund të vazhdohet me shtresat e tjera të nënshtresës, sipas vizatimeve përkatëse.

02. Prishje trotuari

Prishja e trotuareve të çfarëdo lloji sipas projektit dhe prishje e elementeve që ndodhen poshtë, pastrim, larje, duke përfshirë largimin e materialeve jashtë ambientit të kantierit, si dhe çdo detyrim tjetër.

03. Nenshtrese zhavorri t=2cm



PËRSHKRIM

Një përkufizim gjeologjik i zhavorrit është "një material natyror që përbëhet nga materiale të transportuara nga uji dhe zakonisht ka një formë të rumbullakosur si rezultat i transportit të ujit". Një nga shkëmbinjtë më të gjithanshëm për ndërtim, guri gëlqeror mund të grimcohet lehtësisht duke e bërë atë një shkëmb parësor që përdoret në beton të gatshëm, ndërtim rrugësh dhe hekurudha. Është gjerësisht i disponueshëm në gurore në të gjithë vendin.

Zhavorri është një grumbullim i lirshëm i fragmenteve të vogla shkëmbi me madhësi të ndryshme. Ka një gamë të gjerë aplikimesh në industrinë e ndërtimit. Shpërthimi dhe erozioni i shkëmbinjve është procesi natyror me të cilin formohen depozitat e zhavorrit. Zhavorri mund të prodhohet gjithashtu në gurore të njohura si gropa zhavorri, ku shkëmbinjtë si ranor, gur gëlqeror dhe bazalt janë grimtuar në madhësi. Madhësitë e grimcave të zhavorrit variojnë nga 2 mm deri në mbi 60 mm dhe janë të disponueshme në një sërë ngjyrash, teksture dhe lloje gurësh. Zhavorri, së bashku me rërën, përdoret për prodhimin e betonit, si dhe për përzierjen me asfaltin si pjesë e ndërtimit të rrugëve. Mund të përdoret si shtresë bazë për rrugët përpara se të mbulohet me asfalt, dhe gjithashtu përdoret zakonisht për të

sipërfaqësuar rrugët, veçanërisht ato në zonat rurale dhe në kushte akulli. Mund të përdoret gjithashtu si pjesë e mbulesës së çatisë.

Zhavorri mund të përdoret së bashku me guralecët si një formë ngjyrosjeje e njohur si pebbledash e cila përdoret për muret e jashtme të një ndërtese në të cilën shtresa e sipërme është e teksturuar për të krijuar një përfundim të ashpër.

Zhavorri mund të përdoret në filtrimin e ujit, ku vepron si një filtër natyral që mban mbrapsht precipitatet të cilat mund të përmbajnë papastërti, si dhe grimca të tjera të madhësisë së rërës. Këndësia dhe fortësia e zhavorrit e bën atë rezistent ndaj erozionit të ujit.

Zhavorri përdoret zakonisht për aplikime të peizazhit, të tilla si në rrugë, vendkalime, ose si një mbushës dekorativ mbi tokë në vend të barit.

04. Stabilizant me kokrriza deri në 37 mm, h=10cm (per blloqe shtrimi me zgavra për rritjen e barit)

Bazamenti duhet të shtrohet me shtresa dhe të ngjitet në mënyrë mekanike (maksimumi i trashësisë së shtresave: 10 cm) për të formuar bazen për elemente të tjera. Nëse materialet janë të lagerta për shkak të ndryshme ato duhet të thahen sipas kërkesave para procesit të ngjeshjes.

Para ndertimit të themeleve, kontraktori do të vlerësojë kapacitetin mbajtës në nënshtresën me anë të pllakave. Matjet do të bëhen çdo 500 m², në pikat e kontrollit të përcaktuara nga bordi drejtues i ndertimit në terren. Minimumi i kapacitetit mbajtës do të jetë të paktën 110 Mpa. Për mbushjen, kapaciteti mbajtës do të provohet çdo 0.5 m (lartësi). Para aplikimit aktual, kontraktori duhet gjithashtu të sigurojë zonat për testim të të gjitha materialeve ngjeshëse (metodologjia ngjeshëse dhe performance për tu aprovuar nga bordi drejtues i terrenit).

05. Shtrese betoni C12/15

Materialet

Beton i klases C12/15

Mënyra e ndertimit

Pasi janë vendosur kuotat përfundimtare të këtij betoni dhe është kontrolluar lartësia e mbushjes së mëparshme me cakell në mënyrë që mos të kemi shumë mbushje me beton behet hedhja e kësaj shtrese. Betoni i kësaj shtrese është beton i varfer pasi kjo është një shtrese ndihmëse për projektin që shërben për krijimin e një sipërfaqeje sa më të rrafshet dhe të qëndrueshme për vendosjen e shtresës së hidroizolimit sipër saj. Ky beton furnizohet me pompe dhe automjete betoni dhe pasi hidhet në kuotën e përcaktuar në projekt të cilat fiskohen në hekura të ngulura në shtresën e cakellit rrafshohet dhe vibrohet me mastar vibrues. E rëndësishme është të krijohet një sipërfaqe sa më e drejtë dhe e lëmuar për vendosjen e shtresës së hidroizolimit.

06. Shtrim me pllaka gresporcelanate ne tualete, te bardha, mat

Shtrim me pllaka gres porcelanato, te tipit te zgjedhur, duke perfshire:

-ngjitja e pllakave realizohet me shtrese kolle,

-prerjen me prerres pllakash dhe ngulitjen e inkastrimeve ne mur, vendosjen ne veper ne menyre plotesisht te ngjeshur ndermjet tyre dhe te stukuara me bojake çimentoje ne fugatura,

- larjen dhe pastrimin,

- çdo detyrim tjetër për mbarimin e plote te dyshemese ne menyre perfekte.

Modeli i pllakes dhe menyra e shtrimit lihen ne preference te klientit.

07. Veshje me pllaka gresporcelanate ne tualete

Veshja me pllaka ne tualete realizohet ne mure me panele cimentato. Ato paraprakisht duhet te lyhen me prajmer qe sherben per nje ngjitje sa me te mire midis pllakave cimentato dhe kolles.

Ngjitja e pllakave me kollë, bëhet kur sipërfaqja e bazës mbajtëse është e drejtë. Kolli vendoset sipas nevojës me një trashësi prej 3 mm deri në 15 mm. Mbasi të thahet kolli, duhet që fugat e planifikuara, të mbushen me një material të posaçëm (bojak). Fugat nëpër qoshe dhe lidhje të mureve duhet të mbushen me ndonjë masë elastike (si psh silikon).

Për secilën sipërfaqe 30 m² të veshur me pllaka të ndryshme, është e nevojshme vendosja e fugave lëvizëse.

08. Shtrese lluster cemento 1:2 per te gjitha ambientet

Eurokodi

Sipas EN 197-1 dhe EN 206-1 dhe EN 10080

Përshkrimi

Shtresa me llustër është një shtresë e hollë materiali që vendoset sipër një dysHEMEJE betoni.

Zakonisht, Shtresa me llustër përbëhet nga çimento dhe rërë nga gur i thyer. Shtresa me llustër është

zakonisht një material çimento i bërë nga një raport 1:2. Qëllimi kryesor i shtresës me llustër është të japë një dysHEME të lëmuar dhe të niveluar mbi të cilën do të vendosni shtresen perfundimtare te dyshemese që keni zgjedhur.

Karakteristika

Karakteristikat teknike dhe të performancës së shtresës me llustër janë

- Trashësia e mjaftueshme: është sipas llojit të shtresës me llustër që planifikohet të vendoset,

trashësisë së dyshemesë dhe llojit të saj, si dhe intensitetit të trafikut të vlerësuar.

- Rezistenca mekanike: 20 MPa qëndrueshmëria duhet të jetë 30 MPa.
- Kompaktësia: Duhet të jetë kompakt dhe homogjen në të gjithë sipërfaqen dhe në të gjithë trashësinë. Nëse shtresa me llustër tregon që shtresa ka qëndrueshmëri më të ulët, kjo është një tregues i karakteristikave të dobëta mekanike që mund të rezultojnë në thyerje të dyshemesë.
- Shtresë me llustër pa çarje: shkaktohen për shkak të tkurrjes higrometrike dhe për shkak të pranisë së një sasive të madhe uji brenda përzierjes. Përzierja e aggregateve me sasi të tepërt çimentoje përfundon gjithashtu në çarje.
- Pastrimi: Sipërfaqja e shtresës me llustër duhet të bëhet e rregullt. Pluhuri, papastërtitë në sipërfaqen e shtresës me llustër duhet të hiqen përpara instalimit të dyshemesë. Sipërfaqet e papastra do të përfundojnë në parandalimin e ngjitjes midis shtreses perfunidmtare dhe shtresës me llustër.
- Tharje: Niveli i lagështisë së mbetur duhet të kontrollohet brenda sipërfaqes së shtresës me llustër. Për shtresat me llustër me anhidrit, sasia e lagështisë së mbetur duhet të jetë vetëm 0,5%.
- Rrafshimi: Sheshtësia e shtresës me llustër kontrollohet duke vendosur një skaj të drejtë (2 m të gjatë) në secilin nga drejtimet në sipërfaqen e mallës. Toleranca maksimale e pranueshme me këtë skaj të drejtë është specifikuar të jetë 2 mm.
- Aplikimi i produktit

Shtresa me llustër zakonisht aplikohet sipër pllakës së betonit dhe përdoret më së shpeshti si një shtresë përfundimi në dyshemetë e brendshme ose për të niveluar dyshemenë para mbulesës përfundimtare të dyshemesë, tapetit, pllakave, gurit natyror, linoleumit, dyshemeve prej druri, veshjeve me rrëshirë, etj. Në rast përforcimi, kjo do të jetë brenda një rrjete metalike, fibrash të cilat janë tradicionalisht polipropileni, ose një rrjetë xhami të imët. Shumica e tyre janë komponime anhidrite dhe mbështeten në një lidhës CaSO₄.

Ne nje siperfaqe te pastruar mire nga pluhurat, e cila mund te jete beton ose penobeton, pasi jane percaktuar kuotat behet hedhja e shtreses se llustres. Prane kuotave te hedhura, kryesisht ne kolona dhe fasada, 1 meter mbi kuoten perfunidmtare te llustres ndertohen tako me lluster gjysem te thate. Duke u nisur nga to ndertohen fasho me te njejten lluster. Keto fasho mund te jene 2-3 metra larg njera tjetres ne varesi te vendit dhe te mastarit qe do te perdoret per drejtimin e llustres. Llustra furnizohet ne kat me ane te pompes e cila pasi perzien perberjen e duhur ne raport rere-cimento 1:2 e dergon ate me ane te tubave ne katin perkates. Per 1m³ lluster duhet te perdoren 527kg cemento e zakonshme Portland dhe 1.1m³ rere. Pasi shprendahet ndermjet dy fashave ajo ngjeshet dhe terhiqet me mastar duke u kujdesur qe te perftohet nje siperfaqe sa me te rrafshet, ne menyre qe te kursehet sa me shume material ngjites qe do te perdoret per te vendosur shtresen perfundimtare.

Në rast përforcimi, kjo do të jetë brenda një rrjete metalike, fibrash të cilat janë tradicionalisht polipropileni, ose një rrjetë xhami të imët. Shumica e tyre janë komponime anhidrite dhe mbështeten në një

lidhës CaSO₄.

Ne nje siperfaqe te pastruar mire nga pluhurat, e cila mund te jete beton ose penobeton, pasi jane percaktuar kuotat behet hedhja e shtreses se llustres. Prane kuotave te hedhura, kryesisht ne kolona dhe fasada, 1 meter mbi kuoten perfundimtare te llustres ndertohen tako me lluster gjysem te thate. Duke u nisur nga to ndertohen fasho me te njejten lluster. Keto fasho mund te jene 2-3 metra larg njera tjetres ne varesi te vendit dhe te mastarit qe do te perdoret per drejtimin e llustres. Llustra furnizohet ne kat me ane te pompes e cila pasi perzien perberjen e duhur ne raport rere-cimento 1:2 e dergon ate me ane te tubave ne katin perkates. Per 1m³ lluster duhet te perdoren 527kg cimento e zakonshme Portland dhe 1.1m³ rere. Pasi shprendahet ndermjet dy fashave ajo ngjeshet dhe terhiqet me mastar duke u kujdesur qe te perftohet nje siperfaqe sa me te rrafshet, ne menyre qe te kursehet sa me shume material ngjites qe do te perdoret per te vendosur shtresen perfundimtare.

09. Veshje muri me gips me pambuk me mineral guror t=7cm

Eurocode

10 Sipas EN 13501-1m, Euroclass A1



PËRSHKRIM

Të lehta dhe të lehta për t'u trajtuar, shufrat e leshit të gurit janë të thjeshta për t'u instaluar dhe ofrojnë një përshtatje të ngushtë me tullat dhe bllokimet. Grupet gjysmë të ngurtë janë të padjegshëm dhe përmbajnë aditivë të papërshkueshëm nga uji, të cilët parandalojnë transmetimin e lagështirës midis gjethes së jashtme dhe të brendshme.

Shportat e zgavrës së leshit të gurit përdoren për izolimin termik të mureve të kavitetit të muraturës së jashtme dhe për izolimin termik dhe mbrojtjen akustike të mureve të partisë murature ndërmjet banesave. Lakurat janë të shpejta dhe të lehta për t'u prerë me saktësi dhe ofrojnë një përshtatje të shkëlqyer; duke reduktuar kohën e instalimit, duke shmangur boshllëqet dhe pikat e ftohta dhe duke maksimizuar performancën afatgjatë. Leshi i gurit Cavity Batts përdoren gjithashtu në muret e partisë së muraturës për të parandaluar efektin e anashkalimit termik, dhe kështu arrihet një vlerë U zero, duke siguruar gjithashtu mbrojtjen e kërkuar të zërit dhe rezistencën ndaj zjarrit.

VETITË

- Një izolim i jashtëzakonshëm termik, zjarri dhe akustik
- Vepron si një pengesë e zgavrës

- Një izolim i jashtëzakonshëm termik, zjarri dhe akustik
- Vepron si një pengesë e zgavrës
- Uji largues – parandalon transmetimin e ujit nga gjethet e jashtme në të brendshme
- E padjegshme - Euroklasa A1
- Përshtatje superiore kundër bllokimit
- Stabiliteti dimensional - pa rënie ose rënie

SPECIFIKIME

- Materiali: Pambuk mineral
- Gjatësia: 1200 mm
- Gjerësia: 455 mm
- Trashësia: 50 mm
- Mbulimi: 98.28m²
- Përçueshmëria termike: 0,037 W/mK
- Klasifikimi i zjarrit: A1 (EN13501-1)
- Pajtueshmëria: BS EN 13162, ISO 14001

08. PUNIME HIDROIZOLIMI

01. Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama

Pershkrimi:

Sistemet e hidroizolimit bituminoz janë krijuar për të mbrojtur ndërtesat e banimit dhe ato tregtare. Bitumi (asfalti ose katrani i qymyrit) është një substancë e përzier e përbërë nga lëngje organike që janë shumë ngjitëse, viskoze dhe të papërshkueshme nga uji. Këto sisteme përdoren për të ndërtuar çati, në formën e mbulimit të çatisë ose produkteve të mbështjelljes. Ë përdorura për dekada si mbulesa të papërshkueshme nga uji në çatitë e banesave dhe ato komerciale, këto membrana me përbërje bitumi përfshijnë dy shtresa. Membrana e parë polimer e poshtme përdoret si një sfond solid, shpesh i përforcuar me fibra qelqi. Granulat minerale përbëjnë shtresën e sipërme vetë-mbrojtëse, me një përzierje përfundimtare bituminoze që i përfshin të dyja. Përdorimet tipike të katramasë janë si një shtresë nëntokësore (mbyjtje) poshtë materialeve të tjera të ndërtimit, veçanërisht materialeve për çati dhe mur anësor, dhe është një lloj membrane që përdoret në çatitë e ndërtuara me asfalt . Aplikimi i shpejtë i shtresës së sipërme të çatisë mbron kuvertën e çatisë gjatë ndërtimit derisa të aplikohet materiali i çatisë dhe kërkohet për çatitë që kërkohen për të përmbushur vlerësimet e zjarrit të Laboratorit Underwriters (UL). Ndarja e mbulesës së çatisë nga kuverta e çatisë mbron mbulesën e çatisë nga rrëshirat në disa materiale mbështjellëse dhe mbulon pabarazitë dhe gozhdat e vjetra dhe copëzat në aplikimet e ri-mbulimit. Nënshtresa derdh gjithashtu ujë, i cili depërton në mbulesën e çatisë nga një rrjedhje e zakonshme, nga një rrjedhje nga shiu ose bora e nxitur nga era, dëmtimi i mbulesës së çatisë nga era ose digat akulli . Megjithatë, aplikimi i shtresave të poshtme mund të rrisë temperaturën e çatisë, e cila është shkaku kryesor i plakjes së herpesit të asfaltit .; dhe letra ndihet kur laget, gjë që mund të shfaqet (rrallë) përmes herpesit të asfaltit. Mos instalimi i një shtrese mund të anulohet garancinë e mbulesës së çatisë.

Perberja:

Përbërja kimike komplekse e bitumit e bën të vështirë identifikimin e përbërësve specifikë përgjegjës për efektet negative shëndetësore të vërejtura te punëtorët e ekspozuar. Kancerogjenë të njohur janë gjetur në tymrat e bitumit të krijuar në vendet e punës. Vëzhgimet e acarimit akut te punëtorët nga ekspozimi i ajrit dhe lëkurës ndaj tymrave dhe aerosoleve dhe potenciali për efekte kronike shëndetësore, duke përfshirë kancerin, garantojnë kujdes të vazhdueshëm në kontrollin e ekspozimeve.

Vetite:

- Mbron kuvertën e çatisë nga shiu përpara se të vendoset çatia.
- Siguron një pengesë shtesë të motit në rast të goditjeve ose depërtimit të ujit përmes çatisë ose ndezjeve.
- Mbron çatinë nga çdo rrëshirë që rrjedh nga mbështjellësi.
- Ndhmon në parandalimin e pabarazisë në mbështjellësin e çatisë nga telegrafimi nëpër herpes.
- Zakonisht kërkohet që të zbatohet vlerësimi i zjarrit .

Instalimi i produktit:

- CEI 20-13, CEI 20-11, CEI 20-29, IEC 60502-1, CEI UNEL 35375, CEI UNEL 35377 - Konstruksioni dhe kërkesat.
- CEI 20-22 II, CEI EN 60332-1-2 – Cilesi të larta antizjarr.
- CEI EN 50267-2-1 – Antikorroziv.

Ngarkesa e llogaritur për kabllot e mësipërm duhet të repektojë kushtin:

- Për kabllot 1-6mm² dëndësia mesatare e rrymës 4A/mm²;
- Për kabllot 6-16mm² dëndësia mesatare e rrymës 2-4Amm²;
- Për kabllot >16mm² dëndësia mesatare e rrymës 1-2Amm²;

Kablllo FTG10(O)M1:



Figura 14 : Kablllo multipolar te tipit FTG10(O)M1

Specifikime teknike per kabllot FTG10(O)M1 0.6/1kV:

Percjellesi: Percjellesi bakri fleksibel ne baze te standartit IEC 60228

Izolimi : gome, tipi G10

Mbeshtjellja e jashtme: johalogjen, blu RAL 5012

Tensioni nominal: 0.6/1kV

Diapazoni i temperaturave: -25°C deri ne +90°C

Mbeshtetur ne standartet:

- EN 50266 / IEC 60332-3-24 / CEI 20-22III
- EN 50267-2-1 / IEC 60754-1 / DIN VDE 0482 part.267-2-1
- IEC 60331 / EN 50200

Markat e kablllove do të jene të tipit FG16OR16, per linjat e fuqise dhe ndricuesve normal dhe te emergjences me durueshmeri kundra zjarrit prej 3 oresh me izolacion PVC. Dejet e kablllove do të jene me ngjyra të veçanta dhe standarde (percjellesi i nulit me ngjyre blu, percjellesi i tokezimit ngjyre verdhe-jeshile). Në kabllot trefazore duhet të jene të dallueshme edhe ngjyrat e fazave si edhe toka.

Duke zbatuar këto kushte për ngarkesat në sistemin e fuqisë kabllot do të shfrytëzohen për kohë të gjatë dhe instalimi i tyre do të ketë garancinë dhe jetëgjatësinë e kërkuar. Rrjeti shpërdarës do të përbëhet nga paneli kryesor i cili duhet të vendoset në dhomën teknike dhe nga panelet e kateve. Në secilin panel

elektrik do të vendosen pajisje mbrojtëse, pajisjet matëse dhe ato komutuese, të cilat do të bëjnë mbrojtjen, matjen dhe komutimin e konsumatorit.

Kudo që do të shtrihen ura kabllore apo kanalino, kabllot do shtrihen brenda tyre. Atje ku mungojnë urat apo kanalinet murale apo nene dysheme, shtrirja e kabllave të rrjetit shpërndarës do të behet me tuba TVC pesante veteshues të tipit me përbërje dielektrike RK15.

4.8 Seksioni i percjellesit te Nulit

Percjellesat e nulit duhet të kenë seksion më të vogël se seksioni i fazave. Për kabllot me seksion $> 16 \text{ mm}^2$, seksioni i nulit sipas CEI mund të reduktohet deri në gjysmen e seksionit të fazave. Sipas VDE seksioni i nulit duhet gjithmonë (pavarësisht nga seksioni i fazave) i njëllojte me atë të fazave.

5. SISTEMI I RRJETIT TE FUQISË

Persa i perket sistemit te prizave te fuqise ato jane vendosur ne vizatime mbeshtetur ne planimetrite dhe arredimin e brendshem te ambienteve. Ato duhet te kene montim rafsh dhe duhet te kene nje ngjyre qe te shkoje me kapaket e çelesave te ndriçimit. Ky sistem është vendosur ne te gjitha ambientin e objekteve.

Te gjitha prizat jane 230V, 16A, me tokëzim, industriale, per montim jashte murit IP55. Instalimi nga kuadrat e shperndarjes deri tek kutia shperndarese te prizave do te behet me kabell FG16OR16 me $S=3 \times 2.5 \text{ mm}^2$ te futur ne tubo metalik $d=20 \text{ mm}$. Instalimet elektrike te fuqise dhe sinjalizimit qe kalojne ne dysheme behen me tub te rende, kurse ato qe kalojne ne mure dhe tavane jane te serise se lehte.

Tubat e dyshemesë jane vendosur nen shtresat e dyshemesë dhe ne mure brenda suvase dhe behen para se muret te suvatohen. Tubat duhet te jene te gjithë te pa djegeshme. Projekti parashikon mbrojtjen diferenciale me rele diferenciale 30mA. $R_t < 3 \Omega$ dhe mbrojtjen nga LSH me automat termoelektromagnetik.

Linjat e furnizimit jane me tre percjelles dhe karakteristikat e automateve duhet te zbatohen rigorozisht sipas klasit A. B. C. D. (karakteristika termike e momentit te inercise) per te garantuar selektivitet. Percjellesit qe do te perdoren do te jene fleksibel antifiam.

Instalimi i elementeve do te behet si me poshte:

- Lartesia e çelsave do te jete 110 cm nga dyshemeja.
- Lartesia e kutive shperndarese 25 cm nga dyshemeja.
- Lartesia e prizave do te jete 40cm nga dyshemeja.

Persa i perket sistemit te prizave te fuqise ato jane vendosur ne vizatime mbeshtetur ne planimetrite dhe arredimin e brendshem te magazines. Te gjitha prizat jane te tipit shuko dhe te pajisura me tokezim.

6. SISTEMI I NDRICIMIT NORMAL

Pavaresisht ambientit i cili do të ndricohet llogaritja e ndricimit është bërë sipas normes UNI EN 12464 duke krijuar një sipërfaqje uniforme të ndricuar mirë në çdo pjesë të saj dhe të qetë për punën e personelit dhe të gjithë njerëzve. Ndricimi është projektuar sipas tipologjisë së ambienteve duke plotësuar kushtet dhe normat mbi llojin e ndricimit, niveleve të ndricimit dhe rezikshmërinë e instalimit të ndricimit.

Sipas standartit evropian të ndricimit EN 12464, është respektuar me rigorozitet fuqia e ndricimit sipas ambienteve si më poshtë:

▪ Ambientet e zyrave	500lux
▪ Dhoma e sallës së mbledhjeve	500lux
▪ Ambienti Teknik	200lux
▪ Korridoret	200 lux
▪ Tualete	150 lux
▪ Shkallet	150lux

Për ndricimin e objektit është projektuar i gjithë rrjeti i ndricimit dhe sipas tipologjisë së ambienteve janë vendosur këto tipe ndricuesisht :

- a. Tipi i ndricuesit të përdorur në ambientet e klasave



Figura 15 : Ndricues LED 36W, 60x60cm

Specifikimet teknike të ndricuesit Panel Led 36W, 60x60cm, IP40:

▪ Montimi:	Inkaso i instaluar në tavan
▪ Burimi i dritës :	LED;
▪ Sistemi optik :	difuzor opal;
▪ Sistemi i ndricimit:	Direkt;
▪ Instalimi :	me kitin e transformatorit AC/DC;
▪ Ushqimi :	220-240 V, 50-60 Hz;
▪ Fuqia Instaluar :	1x36W;
▪ Fluksi i ndricimit	3600lm;
▪ Shkalla e mbrojtjes :	IP 20;
▪ Klasa mbrojtjes mek:	IK 07;
▪ Pesha ndricuesit :	8.1kg;
▪ Dim. (LxWxH) :	(605x605x101)mm ;
▪ Sipërperfunduar:	White RAL 9003 (W03);
▪ Sistemi Efikasitetit:	100lm/W
▪ Indeksi I ngjyres :	CRI(Ra) 80+
▪ Ngjyra e tempera:	4000K
▪ Kendi i rrezes:	60°
▪ Temp. Punes:	-20°C në +35°C
▪ Jetegjatesia:	50,000 ore pune, me efikasitet të lartë.

b. Ndricues industrial LED, 1x43W, IP65



Figura 16 : Ndricues industrial LED 1x43W, IP-65

Specifikime teknike te ndricuesit:

- **Montimi:** I montuar jashte tavanit
- **Burimi i drites :** LED;
- **Ushqimi :** 220-240 V, 50-60 Hz;
- **Fuqia Instaluar :** 1x43W;
- **Fluksi i ndricimit** 4100lm;
- **Shkalla e mbrojtjes :** IP 65;
- **Dim. (LxWxH) :** 1215mm
- **Siperf.perfunduar:** White RAL 9003 (W03);
- **Indeksi i ngjyres :** 80 Ra
- **Ngjyra e tempera:** 4000K
- **Jetegjatesia:** 50,000 ore pune, me eficence te larte.

c. Ndricules mural LED, 19W, IP65



Figura 17: Ndricules mural LED 19W, IP65

Karakteristikat teknike:

- Reference:	EN60598-1; EN 62471;
- Modeli:	Mural;
- Montimi:	Montuar ne sipërfaqe te murit;
- Burimi I drites:	Ndricim LED ;
- Sistemi optikal:	Difuzor opal;
- Shperndarja e drites:	Direkt;
- Materiale:	Alumin i bardhe;
- Ngjyra e jashtme:	E bardhe RAL 9003 (W03);
- Burim Tensioni	220-240 [V];
- Frekuenca:	50 [Hz];
- Faktori I Fuqise (cos (fi):	0.95;
- Fuqia e Ndriculesit:	19[W];
- Fluksi I Ndriculesit [lm]:	1500 [lm];
- Ngjyra e Temperatures:	4000 [K]
- Temp e punës :	(-20 ÷ 40) [°C]
- EEC:	A++ / A+ / A
- Klasa e mbrojties:	I
- Grada e mbrojties IP:	IP20
- Dimensioni:	30x10x7 mm
- Pesha :	1.574 kg
- Jetëgjatësia :	30,000 h

d. Ndricules tavanor LED, 18W, IP20



Figura 18: Ndricules LED 18W, IP20

Karakteristikat teknike:

- Reference:	EN60598-1; EN 62471;
- Modeli:	Tavanor;
- Montimi:	Montuar ne sipërfaqe te tavanit;
- Burimi I drites:	Ndricim LED ;
- Sistemi optikal:	Difuzor opal;
- Shperndarja e drites:	Direkt;
- Materiale:	Hekur dhe akrilik i bardhe;
- Ngjyra e jashtme:	E bardhe RAL 9003 (W03);
- Burim Tensioni	220-240 [V];
- Frekuenca:	50 [Hz];
- Faktori I Fuqise (cos (fi):	0.95;
- Fuqia e Ndriculesit:	18 [W];
- Fluksi I Ndriculesit [lm]:	1550 [lm];
- Ngjyra e Temperatures:	3000 [K]
- Temp e punës :	(-20 ÷ 40) [°C]
- EEC:	A++ / A+ / A
- Klasa e mbrojties:	I
- Grada e mbrojties IP:	IP20
- Dimensioni:	Ø =10cm,
- Pesha :	1.05 kg
- Jetëgjatësia :	30,000 h
- Zonat e aplikimit:	Tualete.

e. Ndricules track light LED 3m





Figura 19: Ndricules LED Track Light me 4 spote te orientueshem

Karakteristikat teknike:

- Modeli:	Tavanor;
- Montimi:	Montuar ne sipërfaqe te tavanit;
- Burimi I drites:	Ndricim LED ;
- Shperndarja e drites:	Direkt;
- Materiale:	Alumin
- Ngjyra e jashtme:	e zeze
- Burim Tensioni	220-240 [V];
- Frekuenca:	50 [Hz];
- Faktori I Fuqise (cos (fi):	0.95;
- Fuqia e Ndriculesit:	22 [W];
- Fluksi I Ndriculesit [lm]:	1550 [lm];
- Ngjyra e Temperatures:	3000 [K]
- Temp e punës :	(-20 ÷ 40) [°C]
- EEC:	A++ / A+ / A
- Klasa e mbrojties:	I
- Grada e mbrojties IP:	IP20
- Dimensioni:	L=3m,

f. Ndricules i Jashtëm 30W

	
Fuqia	30W / Led
Fluksi	4200 lm
Tensioni i punës	220 - 240 V
Frekuenca e punës	50 - 60 Hz
Lloji i ndriçimit	4000 K
Klasa e energjisë (EEC)	A++
Eficienca e ndriçuesit	140lm/W
Shkalla e mbrojtjes	IP66
Shkalla e mbrojtjes mekanike	IK08
Jetëgjatësia (L80)	100 000 orë
Temperatura e punës	-40 °C – +50 °C
Indeksi i vlerësimit të ngjyrave (CRI) [Ra]	>70
Certifikimet	CE
Garancia	2 vjet

6.1 Sensorët e levizjes

Sensorët e lëvizjes shërbejnë për komandime të ndryshme duke reaguar ndaj çdo lëvizje që ndodh në zonën e mbulimit të tyre. Për komandimin e ndriçuesave ata vendosen afër tyre dhe ju dhënë atyre sinjal për ndezje ose fikje.

Parametrat e sensorit duhet të jenë të rregullueshme.



Figura 20 : Sensorë lëvizje

Specifikimet teknike te sensoreve te levizjeve per komandimin e rrjetit te ndricimit :

- **Zona maksimale e mbulimit:** ≥ 6 metra;
- **Kendi mbulimit:** 360 grade;
- **Shkalla e mbrojtjes** sipas kerkeses ne funksion te ambientit ku do perdoret, por jo me pak se IP 20;
- **Tensioni:** 230V, 50 Hz;
- **Rryma e kontakteve** sipas kerkeses (2A, 10A, 16A);
- **Koha** e regullueshme;
- **Infrared** i regullueshem.

I gjithë rrjeti i ndricimit do të behet me kablllo FG16OR16 me seksion $S=3 \times 1.5 \text{mm}^2$. Te gjitha urat lidhese ndermjet ndricuesve do të realizohen me kabell FG16OR16 me seksion $S=3 \times 1.5 \text{mm}^2$. Vendodhja e çelesave të ndriçimit tregohet sipas projektit elektrik projektues. Ne pergjithesi çelesat e ndriçimit gjate gjithë ndertesës duhet të jene te pershtatshme per montim te rrafshet (nen suvatim). Te gjithë çelesat duhet te kene nje shkalle minimale prej 10-16A.

7. SISTEMI I NDRICIMIT TE EVAKUIMIT

a) Parametrat e projektimit

Sipas standarteve europiane:

- Rrugët e daljes sipas DIN EN 1838
- Sistemi i baterise qendrore sipas DIN EN 50171, DIN EN 50172,
- Ndricimi emergjent sipas EN 60598-1, EN 60598-2-22

b) Pershkrimi funksional

Parkimi do te jete e pajisur me sistemin e ndricimit emergjent sipas standarteve ne fuqi. Te gjitha produktet duhet te jene te pajisur me shenjen CE dhe furnizuar nga kompanite e certifikuara sipas ISO 9001. Sipas DIN EN 1838 minimumi i vazhdueshem i nivelit te ndricimit ne rruget e ikjes do te sigurohet qe te jete 1 lux. Fushat e meposhtme jane respektuar ne projektimin e sistemit te ndricimit emergjent:

- Rrugët e daljes (korridoret, shkallet, rruge kalimet e parkimit etj.) dhe tabelat e daljes, ku duhet te arrihet ndricim prej 1 lux pergjate rruges se daljes;
- Zonat e hapura $> 60 \text{m}^2$ kerkojne ndricim anti-paniku me nje ndricim minimal prej 0.5 lux
- Shkallet duhet te marrin drite te drejtperdrejte nga ndricuesit emergjent, ne menyre qe ndricimi minimal te jete 1 lux
- Ne cdo ndryshim te drejtimit duhet te jete i instaluar ndricim emergjent.



Figura 21 : Ndricues evakuimi EXIT (Exiway SmartEXIT)

Specifikimet teknike te ndricuesit te evakuimit 2.8W:

- **Montimi:** Instaluar ne tavan / instaluar ne mur;
- **Standarti:** sipas IEC 60598-2-22;
- **Monitorimi:** i pavarur stand alone;
- **Burimi i drites:** LED;
- **Sistemi optik :** difuzor peciklas;
- **Sistemi i ndricimit:** Direkt;
- **Instalimi :** me kitin e baterise Ni-Cd (Mbrojtje e baterise nga mbingarkesa dhe Shkarkimet, tregues karikimi LED);
- **Ushqimi :** 220-240 V, 50-60 Hz;
- **Fuqia Instaluar :** 1x2.8W;
- **Fluksi i ndricimit** 30lm;
- **Shkalla e mbrojtjes:** IP 42;
- **Klasa mbrojtjes mek:** IK 07;
- **Pesha ndricuesit :** 0.875kg;
- **Dim.diameter:** 187 x 165 x 10 ;
- **Autonomia:** 3 ore;
- **Jetegjatesia:** 100,000 ore pune, me eficence te larte.
- **Certifikim:** ENEC

Ndricuesit e emergjences dhe evaulimit me sinjalistike exit, janë te lidhur me panelin elektik te katit. Vendorsja e tyre do të behet në mënyrë të tille që të sigurohet një shkalle ndriçimi prej 5lux, kurse pavarësia e funksionimit të tyre për ndërprerjen e rrjetit duhet të jete të paktën 3ore. Ndriçimi i sigurisë (shenjat e shkalleve, drejtimet e daljeve) do të jene me llamba LED 2.8W per ndriçuesit e evakuimit EXIT dhe ndricues LED 7.5W per ndriçuesit e emergjences.

Linja e ndricimit te emergjences dhe evakuimit behet me kablllo multipolar bakri $U_n=0.6/1kV$, tip FTG100MI me seksion $S=3 \times 1.5mm^2$. kablli niset nga paneli elektrik instaluar ne kanalinen metalike te fuqise, dhe degezimet behet me kuti shperndarese dhe tubo PVC rigid te drejte te kapur me grapeta.

8. SISTEMI I DETEKTIMIT TE ZJARRIT

Sistemi Fire alarm ose mbrojtjes kundër zjarrit është një sistem që paralajmëron personelin për praninë e zjarrit ose të tymit në objekt. Me poshtë jepen referencat e standardeve që janë marrë në konsideratë gjatë hartimit të projektit të sistemit të detektimit të zjarrit.

Këto i referohen:

- *Ligjet dhe normat e aplikuara ne Shqipëri*
- *Normat evropiane*

EN 54	Sistemi i detektimit dhe alarmit të zjarrit
ISO 7240	Sistemi i detektimit dhe alarmit të zjarrit, kërkesat e sigurisë
ISO 8421-3	Mbrojtja ndaj zjarrit
BS 5839	Sistemi i detektimit dhe alarmit të zjarrit për ndërtesat

Ky sistem perbehet nga:

- Centrali i alarmit te zjarrit;
- Dedektoret e tymit;
- Pulsantet manual te thirjes se zjarrit;
- Sirenat e brendeshme;

- Kabllot e lidhes te loop-eve te detektoreve dhe sirenave;

Pajisjet e kontrollit. Kontraktori duhet te mbuloje, instalimin, testin, lidhjen dhe garanton nje cilesi te larte te veprimit te pajisjes sinjalizuese te zjarrit dhe sistemit te alarmit duke perfshire dhe autoparlantet, ndriçuesit, pajisjet e alarmit, kontaktet e thyerjes se xhamit, panelet e alarmit te zjarrit, karikuesin e baterise, dhe releve te shoqeruar, do sigurohen dhe lidhen ne perputhje me specifikimet, sipas pozicioneve te treguara ne vizatime.

Sistemi i sinjalizimit te zjarrit për te gjithë ambientet e godines eshte projektuar ne perputhje te plote me kerkesat e standardit BS 5891-1, (British Standart-Standarti Britanik i projektimit te sistemeve te sinjalizimit te zjarrit) ku:

- Centrali i alarmit te zjarrit (C.A.Z) eshte me 3 loop-e digital, me 128 elemente per loop, i tipit inteligjent i adresueshem, kategoria Lz, me modul komunikimi RS-232, me porte interneti, karte konfigurimi, me regjistrim ngjarjesh, i programueshem dhe me bateri per 72 ore pavaresi dhe duhet te jete i pajisur me ekran LCD.

Në figurën e mëposhtme tregohet një central anti-zjarr.



Figura 22 : Central alarmi zjarrit, digjital, tip inteligjent i adresueshem sipas EN54

- Detektorët e tymit do te instalohen te tipit multi-sensitive inteligjente te adresueshem, me modul komunikimi.



Figura 23 : Detektore tymi/ multisensitive te adresuar

- Pulsantët manual te alarmit te zjarrit jane tipit inteligjent te adresueshem, te vendosur ne lartesine $H=+1.4m$ nga dyshemeja. Pulsant per aktivizimin direkt te alarmit te cilat gjithashtu do te jene analog te adresueshme dhe te resetueshme ne raste alarmi. Pulsantët duhet te jene IP44 per ambiente te brendshme.



Figura 24 : Pulsant manual zharri dhe llambe sinjalizuese

- Sirenat e alarmit të zjarrit, me ndricues me llambe vezulluese janë të tipit inteligjent të adresueshëm, me intensitet 120 dB. Sirenat e alarmit të zjarrit në ambientet e brendshme vendosen në lartësi $H=+2.1\text{m}$ nga dyshemeja.



Figura 25 : Sirena alarmi zjarri

Sirenat e brendshme do të jenë analoge të adresueshme ndërsa të jashtmet duhet të jenë konvencional të cialt do të lidhen në sistemin analog të Loop me një modul që konverton linjen analoge në konvencionale. Ky sistem duhet të përdor kabell kundër zjarrit E30, i kuq me seksion $2 \times 1.5\text{mm}^2$ dhe duhet të përdoren tuba rigide në raste instalimesh të jashtme ose tuba fleksibël të rende për ato instalime që janë të brendshme në mure.

Sinjalizuesit e tymit. Keto do të veprojnë në mënyrë që të mbajnë ekuilibrin ndërmjet dhomës së hapur dhe të mbyllur, kështu kur tymi deperton në dhomën e hapur ai do të ketë kontakt me qarkun dhe do të aktivizojë sinjalin. Çdo sinjalizues do të projektohet në mënyrë që të mbulojë një zonë prej 100 m². Të gjithë sinjalizuesit e tymit, të jenë instaluar të tilla që të mund të nderrohen me zëvendësues.

Detektorët automatik. Veprimi i detektorit ose i pikës së thirrjes, do të fillojë si më poshtë:

- Koha e pajisjes së alarmit ose e pikës së thirrjes do të jetë e ndriçuar;
- Adresa e mjeteve, numrat e zonave dhe përshkrimi i çdo vendi do të jepet në njësinë e kontrollit

Veprimi i detektorit ose pikës së thirrjes do të fillojë si më poshtë:

- Koha e pajisjes së alarmit ose e pikës së thirrjes do të jetë e ndriçuar;
- Adresa e mjeteve, numrat e zonave dhe përshkrimi i çdo vendi do të jepet në njësinë e kontrollit;
- Alarmi do të transmetohet në brigadën e zjarrit ;
- Autoparlantet e tokës do të tingellojnë në vazhdimësi;
- Autoparlantet në të gjitha zonat e tjera do të pulsojnë.

Zilet e alarmit. Sirenat e alarmit do të vendosen në ambientet e korridorit. Vendndodhja do të caktohet për të siguruar:

- Minimumin e nivelit të tingullit prej 120 dB (A) është i pranishëm në çdo klasë;
- Defekti i një ajre të mos ndikojë në nivelin e përgjithshëm të sinjalizimit;
- Të paktën një zile për çdo zonë zjarri, të jetë e aktivizuar;
- Zilet e alarmit do të sinkronizohen nga një motor;
- Zilet e alarmit do të prodhojnë një nivel tingulli prej 120B dB (a);
- Zilet e alarmit do të shkruhen me të kuq dhe do të shkruajnë qartë "Zjarr";

9. SISTEMI I VEZHIMIT ME KAMERA CCTV

Sistemi i vëzhgimit me kamera si një element i rëndësishëm për sigurinë e objekteve duhet të sigurojë jo vetëm cilësinë në shërbimin që ofron por edhe vazhdimësinë dhe sigurinë në punë. Kjo cilësi realizohet nëpërmjet "Integrated Camera System".

Ky sistem perbehet nga:

1. N.V.R (Network Video Regjistratori) 16kanale, per cdo objekt.
2. 1 x Monitori 32" LED :
3. Kamerat e brendshme 5-Mpx
4. Kamerat e jashtme 5Mpx-IP66
5. 2x6 TBHDD Hard Disku per ruajtjen e te dhenave
6. Switch manaxhimi me 24porta POE
7. Kabllimi me kabllo rrjeti FTP Cat 6A, 500MHz, LSZH, flame reterdant.

Sistemi i vëzhgimit CCTV :

1. NVR 16 kanale, H.264/H.265/Ultra H.265, 64ch H.264/H.265/Ultra H.265, 320Mbps, Up to 8 SATA drives, 4 SATA Interfaces, 2U case,19



Figura 26: NVR 16 kanale

- Dimensionet : (482Wx89Hx495Dmm) 2U-19" per instalim ne rack
- Pesha : 18 kg (48.2 lbs.) with 4 HDDs @ 1TB each
- Burimi i ushqimit : modul ushqimi 300 W
- Konsumi i energjise : 135W
- Paisja ftohese : 4ventilator

2. Switch i menaxhueshem me 24 Porta Gigabit Smart POE per asenblimin e te gjithe linjave te kamera IP, i pershtatshem per instalim ne RACK.
3. Switch i menaxhueshem me 16 Porta Gigabit Smart POE per asenblimin e te gjithe linjave te kamera IP, i pershtatshem per instalim ne RACK.
4. Kamera te brendshme– IP 12MPx, 360 grade
5. Kamera te brendshme – 5mpx, 30 metra IR Exir Dome Outdoor IR30 metra, 2048x1536: 12.5fps(P)/15fps(N), 2.8mm/F2.0 lens (4mm, 6mm optional)
6. Kamera te jashtme 5-MPX resolution, Low illumination, lens: 4mm 3D DNR & DWDR & BLC, System Compatibility: ONVIF, PSIA, CGI, ISAPI, IP66 rating, Image Sensor:1/3" Progressive Scan CMOS, IR range: up to 50m
7. 2 cope, HDD 6TB 3,5 inch. Kapaciteti 6000GB, Sata. Purple HDD (i dizenuar vecanerisht per Security, per te punuar 7dite ne Jave, 24 ore. Si edhe me jetegjatesi me te gjate se nje HDD i zakonshem kompjuteri ndaj ofron me shume garanci ne sherbim)1 x Monitor 32" LED, per monitorimin e kamerave
8. Aksesore montimi per kamera te brendshme dhe te jashteme

Kamerat per monitorimin e ambienteve te brendshme jane vendosur ambientet e korridoreve te kateve, ne hyrjen kryesore te hollit te nderteses dhe ne ambientet e arkives.

Në këtë sistem modern të kontrollit dhe vëzhgimit, në pjesët përbërëse të cilët përfshihen kamerat High Resolution, Wide Dinamic Range dhe Day and Night realizohen pamje të qarta dhe të qëndrueshme për

24 orë me radhë shtatë ditë në javë. Nëpërmjet teknologjise CCTV, këto kamera arrijnë një shpejtësi fotografimi deri 30 imazhe për sekondë me një rezolucion deri 5 dhe 12 megapixel.

Ne te gjithë ndertesën janë instaluar kamera me dalje IP kamerave të cilat nëpërmjet rrjetit LAN me kablo FTP CAT.6A apo edhe nëpërmjet internetit arrijnë kontrollin dhe monitorimin e tyre online. Kontrolli me kamera do të realizohet si kontroll në ambient të brendshëm dhe kontroll në ambient e jashtëm. Është zgjedhur një video regjistrator rrjeti NVR 36 kanale. Furnizimi i kamerave është bere me Kabell FTP CAT.6A (qe është dhe për sinjal dhe furnizim). I gjithë informacioni video dhe imazh nëpërmjet NVR digitale, mund të përpunohet nga personeli i specializuar sipas kohës së ruajtjes dhe parametrave të përcaktuar më parë.

Network storage manager jep mundësinë e ruajtjes së informacionit për kohë të gjatë. I zgjerueshëm deri 24TB është praktikisht i pakufizuar në kohë dhe hapësirë. I gjithë informacioni i mbledhur për një kohë të caktuar grumbullohet dhe ruhet në storage duke siguruar përpunimin e tij dhe përmirësuar shërbimin sigurisë. I gjithë sistemi do të jetë i licensuar me normat e Komunitetit European.

Karakteristikat e Switch-it POE me 24 porta:

Tipi:	Switch i menaxhueshëm 24 porta
Porta PoE 10/100/1000Mbps RJ45 (Auto Negocim /Auto MDI/MDIX):	24 porta
Porta uplink (bakër/fibër) 100/1000Mbps SFP Slots :	min. 2 Combo Opsionale
Porta Combo:	Opsionale
Porta Console:	RJ-45/RS232 : 1
Tensioni nominal:	100~240 VAC
Frekuenca:	50/60Hz
Bandwidth/Backplan:	>=48Gbps
Tabele te Adresave MAC :	16k
Fan:	Opsionale

Mbeshtetur ne Standartet: IEE 802.3 10Base - T > | IEE 802.3u - 100 Base-T | IEE 802.3ab – 1000Base-T | IEE 802.3z – 1000Base-X | IEE 802.3af- PoE, etj.

10. SISTEMI TOKËZIMIT DHE EKUIPOTENCIALIZIMIT

Sistemi i tokëzimit përbëhet nga:

1. Shpërndarsit
2. Përcjellësi i tokëzimit
3. Kolektori kryesor ose nyja kryesore e tokëzimit
4. Përcjellësit e ekuipotencializimit

Të gjithë panelet elektrike janë të lidhura me sistemin e tokëzimit me anë të një përcjellësi me seksion jo më të vogël se përcjellësi i fazës. Brenda çdo paneli elektrik ka një zbarrë tokëzimi në të cilin janë lidhur përcjellësit mbrojtës (PE) të linjave të ndryshme. Të gjitha masat e tokës, prizat dhe ndriçuesit do të jenë të lidhura me rrjetin e tokëzimit, nëpërmjet përcjellësve mbrojtës PE. Është parashikuar që të realizohen lidhjet e atyre pajisjeve të përcaktuara si "pikë tokëzimi" të gjitha tubat metalik të rrjetit të ujit, çdo sistem ngrohje etj, me sistemin e tokëzimit. Rrjeti i tokëzimit do të përbëhet nga elektroda tokëzimi (bakri/hekur i zinkuar) të lidhura paralelisht dhe të lidhura në kolektorin kryesor (zbarrën ekuipotenciale).

10.1 Ndërtimi i Rrjetit të Tokëzimit

Rrjeti i tokëzimit do të përbëhet nga elektroda hekuri të zinkuara, me një madhësi minimale prej 50x50x5 dhe një gjatësi jo më të vogël se 1.5 m.

Paraqitja rrjetit të tokëzimit dhe pushtave të inspektimit tregohen në vizatimet e këtij projekti. Hekurat e themeleve dhe plintave duhet të lidhen me disa pika në rrjetin e tokëzimit me anë të një lidhjeje të veçantë në përputhje me rregullat e përcaktuara në SSH EN 50522. Në këtë mënyrë, ata do të bëhen pjesë integrale e sistemit të tokëzimit duke përmirësuar performancën e këtij sistemi. Është e këshillueshme të mbrohen përcjellsat e tokëzimit për rreth 30 cm mbi dhe nën sipërfaqen e tokës duke u izoluar me nastro bituminoze ose tub termoshtrengues. Sepse në këtë pjesë, përcjellsit i tokëzimit është veçanërisht i ekspozuar ndaj korrozionit.

Elementi horizontale i sistemit të sipërpërmendur (shiriti i tokëzimit), duhet të vendoset brenda një gjermimi me një thellësi shtrimi prej të paktën 0.5 m nga sipërfaqja e tokës. Shirit mund të mbulohet me tokë, baltë, humus, beton dhe jo me zhavorr ose guralecë. Lidhjet ndërmjet elementëve të ndryshëm, nëse është e nevojshme, duhet të bëhen me terminale të përshtatshme ose me saldim të fortë në aluminotermik dhe duhet të minimizohen në minimumin e nevojshëm.

Duhet të mbahet mend se në mënyrë që të kufizohen rreziqet e lokalizuara të korrozionit në sipërfaqet e kontaktit të kryqëzimit, zgjidhjet mund të shmangen duke shmangur kontaktin me mjedisin e lagësht duke mbrojtur lidhjet me nastro vullkanike, nastro bituminoze ose shmangie të lidhjeve elektrokimike duke përdorur materiale homogjene për nyje kur lidhin përcjellsit e të njëjtit metal (p.sh Cu-Cu-Cu).

Prandaj, sistemi i tokëzimit duhet të projektohet në mënyrë që të ketë një koordinim optimal mes vlerës së rezistencës së tokëzimit dhe pajisjeve mbrojtëse të pranishme në qark. Përveç kësaj, duhen marr të gjitha masat për të siguruar qëndrueshmërinë e vlerës së rezistencës së tokës.

10.2 Tokëzimi i Neutrit

Lidhja e neutrit të me tokën do të bëhet 3 m distancë nga kabina duke përdorur tokëzim të veçantë. Lidhja e neutrit me tokëzimin e kabinës vetem nëqoftëse $U_E < 500$ V. Për hyrjet e linjave TU ajrore duhet të merret parasysh edhe rreziku i mbtensioneve për shkak të shkarkimeve atmosferike, të cilat mund të sjellin tënsione të rrezikshme në neutër.

10.3 Përcjellsat e Rrjetit të Tokëzimit

Përcjellsit i tokëzimit siguron lidhjen e nyjes ekuipotencializuese të tokëzimit me rrjetin e tokëzimit. Përcjellsit do të jenë të izoluar dhe me ngjyrë verdhë-gjelbër FS17. Seksionet për lidhjet ekuipotencializuese nuk duhet të jene më të vegjël se 16 mm² ose me përcjells bakri të zhveshur jo më pak se 35 mm². Seksionet dhe tipologjitë e miratuara tregohen në projekt.

Zbarrat e tokëzimit do të përbëhen nga një shufër bakri të parapërgatitur montuar në izolator mbështetëse. Aty do të lidhen:

- Përcjellësit e tokëzimit;
- Përcjellësit mbrojtës (PE);
- Përcjellësit kryesor (EQP dhe EQPS);
- Shkarkuesit e mbitesionit (SPD) për mbrojtje nga mbitesionet atmosferike dhe të rrjetit elektrik;
- Ekranizimet e kabllave koaksiale aty ku janë të pranishme.

Përcjellësit e tokëzimit ndjekin të njëjtën rrugë si kabllot e energjisë për furnizimin me energji elektrike.

10.4 Lidhjet Ekuipotencializuese

Brenda ndërtesës lidhjet equipotential sigurojnë barazimin potencial kundrejt tokës e mundshëm me anë të lidhjeve me rrjetin e tokëzimit dhe themelt duke lidhur në të të gjithë elementët (tuba metalike të sistemit të ujit, ngrohjes dhe gazit).

Lidhjet do të kryhen sipas SSH HD 60364 dhe SSH EN 62305 si vijon:

1. Kabllo fleksibël të verdhë-gjelbër PVC bakrit izoluar tipi FS17 me një minimum seksioni prej 6 mm² për lidhjet kryesore equipotential dhe 4 mm² për lidhjet dytësore equipotential. Përcjellësit do të jenë instaluar brenda tubave të ngurtë PVC apo fleksibël në varësi të kushteve. Kablli do të çohet në kutinë shperndarse pa xhuntime gjatë rrugës. Në pikën e lidhjes do të përdoren terminale të përshtatshme me shtrëngim.
2. Llojet e lidhjes së tipit:
 - Terminaleve aliazh të pajisur me terminalin vidë për përcjellsin equipotential lidhjes;
 - Celiku të galvanizuar ose terminale kadmium-kromuar e pajisur me terminal vidë për përcjellsin equipotential lidhjes.

Terminalet do të vihen në punë në mënyrë të tillë që shkëputen, të mundësohet inspektimi i lidhjes midis përcjellsit equipotencializues dhe lidhjes dhe terminalit, apo në ndonjë mënyrë tjetër të barazvlefshëm. Zonat nën terminalet duhet të jenë të pastra në mënyrë adekuate.

11. SISTEMI TOKËZIMIT DHE MBROJTJES NGA SHKARKIMET ATMOSFERIKE

Ne perputhje te plote me kerkesat e detyres se projektimit dhe mbeshetur plotesisht mbi standartet IEC 62305. Eshte realizuar projekti i sitemit te tokezimit mbrojtjes dhe mbrojtjes se nderteses nga shkarkimet atmosferike. Sistemi i mbrojtjes atmosferike eshte shume i domosdoshem, per vete kushtet atmosferike dhe vendodhjen gjeografike ne te cilat ndodhet vendi yne.

Sipas standardit nderkombetar IEC 62305, percakton kater klasa sistemesh mbrojtjeje (I, II, III, IV), qe iu korrespondojne nje sere rregullash ndertimi dhe lidhen me kater nivele mbrojtjesh (I, II, III, IV). Nga veshtrimi i pare nje efektshmeri mbrojtje globale respektive 98% (niveli I), 95% (niveli II), 90% (niveli III), 80% (niveli IV).

Cdo klase mbrojtjeje i caktohet nje grup nje grup vlerash minimale dhe maksimale te parametrave qe lidhen me amplitudat e rrymave te rrufeve per secilin prej niveleve te mbrojtjes. Vlerat maksimale te amplitudave te rrymave te rrufeve jane percaktuar respektivisht si 200 kA (99% e rrufeve) niveli I i mbrojtjes, 150 kA (97% e rrufeve) niveli II i mbrojtjes, 100 kA (91% e rrufeve) niveli III & IV i mbrojtjes.

Vlerat minimale te amplitudave te rrufeve lidhen me aplikimin e metodes se sferes rrotulluese ne dizenjimin e sistemeve te mbrojtjes nga rrufete ato jane fiksuar:

- 3kA niveli I (99% e rrufeve, R=20m);
- 5kA niveli II (97% e rrufeve, R=30m);
- 5kA niveli III (91% e rrufeve, R=45m);
- 5kA niveli IV (84% e rrufeve, R=60m);

Mbrojtja e nderteses nga shkarkimet atmosferike do të behet mbrojtja nga goditjet direkte dhe ato indirekte (efektet e dyta: induksionet elektromagnetike). Mbrojtja e nderteses nga shkarkimet atmosferike do të realizohet nepermjet nje rrjete ekuipotenciale ne taracen e objektit me shufer hekuri te zinguar 30x3.5mm dhe zbritjeve sic jane treguar ne projekt per ne elektrodas te vendosura nen planin e themeleve, me qellim shkarkimin e sigurte te mbitensioneve atmosferike te shkaktuara nga shkarkime te mundsheme atmosferike.

Mbrojtja nga efektet e dyta të linjave elektrike dhe atyre të telefonisë do të behet, përveçmasave të tjera që përshkruhen në normat VDE, edhe me anën e shkarkuesve të përshtatshëm:

- Rrjeti i tokezimit nen themele ndertohet me shirit zingato 30x3.5mm. Ne kryqezime, degezime dhe bashkime te shiritave te tokezimit perdoren morseteri lidhese te shiritave te tokezimit.
- Ne themelet e katit nentoke -2 eshte projektuar rrjeta e tokezimit 30x3.5mm me shirit zingato, e futur brenda ne strukturen e beton-arme te themeleve te objektit. Kjo rrjetet lidhet me elektrodas te tokezimit te cilat vendosen jashte perimetrin te themeleve te nderteses. Elektrodas te tokezimit jane te tipit profil zingato e bakerizuar 50x50x5mm, L=2.0m.
- Cdo 2m shtrirje horizontale dhe vertikale te shiritave tokezimit, keto te fundit kapen me hekurat e kollonave dhe armatures se themeleve , me ane te morseterive qe jane prodhuar per kete qellim.
- Jane vendosur puseta elektrike kontrolli 40x40x40cm me kapak gize te rende, si pika inspektimi, me shkeputes per matjen e rezistences elektrike te tokezimit, ne kuoten +0.00m te objektit.
- Ne ambientet teknike, te kabines elektrike dhe dhomes elektrike te paneleve do te vendosen shperndare ekuipotenciale per tokezimin e te gjitha pajisjet elektrike si edhe cdo pjese metalike. Keto zbara ekuipotenciale sherbejne per tokezimin e paneleve elektrike, si edhe per rrjetin ekuipotencial ne te gjithe objekin.

- Rrjeta rrufepritese mbi tarrace ndertohet me percjelles $D=10\text{mm}$. Ky percjelles i rrjetes se rrufepritesit fiksohet ne kubike betoni me veshje PVC cdo 1m shtrirje.
- Ne soleten e ashensorit dhe kafazit te shkalleve do te instalohet nje rrjete do te lidhet me rrjeten e soletes dhe prej aty do te kemi percjelles zbrates qe do te lidhet me rrjeten e mbrojtjes atmosferike ne kuoten e tarraces.
- Me kete percjelles tokezimi do te tokezohen te gjitha paisjet mekanike, elektrike, si dhe panelet elektrike te TU. Rezistenca e tokezimit pas matjes nuk duhet te rezultoje me e madhe se 1Ω . Ne qofte se pas matjeve rezistenca e tokezimit eshte me e madhe se 1Ω , atehere duhet te shtohet numeri i elektrodave te tokezimit, derisa ky kusht te plotesohet.



Figura 27 : Detaje konstruktive te sistemi te tokezimit dhe rrufepritesave

Te gjitha komponentet me te larta se siperfaqja e taraces jane rruajtur ne menyre direkte nga shtizat e pritjes se goditjeve atmosferike.

Te gjitha paisjet metalike, panelet elektrike, kanalinat dhe cdo pjese tjeter e sistemit e cila normalisht nuk eshte ne tension, por qe rastesisht mund te bjere ne tension nga shkaqe te ndryshme, duhet te tokezohen (dhe lidhen) me kete rrjet ekuipotencial.

SPECIFIKIME TEKNIKE ARKITEKTURA

PROJEKT:

“Rrugët e Shijes: Mollaj, Boboshtice, Drenove,
Qatrom”, Bashkia Korçë

Shkolla_Sheshi: Qatrom

Faza: Projekt Zbatimi

Hartoi:

ARCHISPACE + iRI + CMA

TETOR, 2024

Tabele permbajtje

01. SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME 7

01.	Të përgjithshme	7
02.	Programi i punimeve	7
03.	Rradha e punimeve	7
04.	Njësitet e matjeve	7
05.	Shpimet eksploruese dhe testet	7
06.	Grafiku i punimeve	8
07.	Punime të gabuara	8
08.	Zëvendësimet	8
09.	Tabela njoftuese	8
10.	Hyrja në sheshin e ndërtimit	9
11.	Ruajtja e pronës	9
12.	Dokumentat dhe vizatimet	9
13.	Dorëzimi te supervizori	10
14.	Furnizimi me ujë	10
15.	Furnizimi me energji elektrike	10
16.	Piketimi i punimeve	11
17.	Fotografitë e sheshit të ndërtimit	11
18.	Bashkëpunimi në zonë	11
19.	Mbrojtja e punës dhe e publikut	12
20.	Mbrojtja e ambientit	12
21.	Transporti dhe magazinimi i materialeve	12
22.	Ripunimi i vizatimeve (Vizatimet siç është zbatuar)	13
23.	Pastrimi përfundimtar i zonës	13
24.	Provat	123
25.	Çertifikatat e cilësisë	14

02. PUNIMET E PRISHJEVE DHE GËRMIMET NË OBJEKT 15

01.	Qëllimi	15
02.	Gërmimi	15
03.	Gërmimet me krahë	16
04.	Trajtimi/Ngjeshja e Zonave të Gërmuara	16
05.	Pastrimi i sheshit	16

06.	Gërmimi për Strukturat	17	
07.	Gërmimi struktural për kanalizimet dhe strukturat mikse	17	
08.	Përforcimi i ndërtesave	17	
09.	Largimi i ujërave nga punimet e gërmimit	18	
10.	Heqja e materialeve të tepërta nga gërmimi	18	
11.	Skeleritë	18	
12.	Gërmimet me makineri	19	
13.	Metoda e prishjes	19	
14.	Prishje e elementeve konstruktiv beton-arme	20	
15.	Prishja, çmontimi dhe largimi elementeve ose strukturave metalike	20	20
16.	Prishja e mureve brenda	20	
17.	Prishje shtresave me pllaka gres porcelanate	21	
18.	Prishje suvatimi	21	
19.	Prishje shtrese lluster cimento	21	
20.	Transport materiale të ndryshme deri në 1.0 km	22	
21.	Prishja dhe heqja e instalimeve elektrike	22	
22.	Prishja dhe heqja e instalimeve hidraulike	22	
03.	PUNIME BETONI DHE BETON ARME	23	
01.	Të përgjithshme	23	
02.	Kontrolli i cilësisë	23	
03.	Puna përgatitore dhe inspektimi	24	
04.	Materialet	24	
05.	Kërkesat për përzierjen e betonit	28	
06.	Matja e materialeve	30	
07.	Metodat e përzierjes	30	
08.	Provat e fortësisë gjatë punës	30	
09.	Transportimi i betonit	31	
10.	Hedhja dhe ngjeshja e betonit	31	
11.	Betonim në kohë të nxehtë	32	
12.	Kujdesi për betonin	33	
13.	Forcimi i betonit	33	
14.	Hekuri i armimit	33	
15.	Kallëpet ose armaturat	35	
16.	Ndërtimi dhe cilësia e armaturës	35	
17.	Heqja e armaturës	36	

18.	Tipet e strukturave	37
04.	HEKURI	37
01.	Materialet	37
02.	Depozitimi në kantier	37
03.	Kthimi i hekurit	37
04.	Vendosja dhe fiksimi	37
05.	Mbulimi i hekurit	37
06.	Ngjitja e hekurave	37
05.	PUNIME HEKUR BETONI	38
01.	F.V Konstruksione metalike te thjeshta	38
06.	PUNIME MURATURE	38
01.	Materialet llac per muret	38
02.	Specifikime te pergjithshme per tullat	39
03.	Mur me tulle me 10 vrima, $t = 10\text{cm}$, $h \approx 3\text{m}$, llac perzier M15	39
04.	Mur me tulla te plota zak, llac perzier M 25	40
05.	Mur gipsi tualete	40
06.	F.V Mure ndarese me xham	41
07.	PUNIME SHTRRESASH	42
01.	Shtrese stabilizanti $t=10\text{ cm}$	42
05.	Shtrese betoni C12/15	44
06.	Shtrim me pllaka gresporcelanate ne tualete	44
07.	Veshje me pllaka gresporcelanate ne tualete	45
08.	Shtrese lluster cemento 1:2	45
08.	PUNIME HIDROIZOLIMI	48
01.	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama	48
02.	Gjeotekstil me gramature 280g/m ²	50
09.	PUNIME SISTEMIMI	50
01.	Shtrim me pllaka guri roze $h=6\text{ cm}$	50
03.	Punime gjelberimi	52
10.	PUNIME TAVANI DHE SUVATIME	61
01.	Suva brenda mur tulle $h \sim 4\text{m}$ me krah, llac perzier M 25	61
11.	PUNIME BOJATISJE	62
01.	Lyerje muri dhe tavani me boje hidromat 2 duar, importi e cilesise se pare	62

12. PUNIME DYER, DRITARE, VETRATE 64

01.	Heqje e dritareve dhe dyerve ekzistuese	64
02.	Dritare/ informacion i pergjithshem	64
03.	F.V Dritare druri dopio xham binari	64
04.	Dyer informacion i pergjithshem	65
05.	F.V Dyer druri	65
06.	Dyer metalike	66
07.	Dyer metalike tualeti	67
08.	F.V Dere e jashtme druri	68
09.	Vetrate vertikale e hapshme	69

13. PUNIME RESTAURIMI 69

01.	Pastrim dhe lysterje parapete ekzistuese betoni	69
02.	Heqje dhe rivendosje e fugave te llacit ne xokolin e objektit	70
03.	Pastrimi fasadës	70
04.	Pastrimi i pllakave ekzistuese të fasadës	70
05.	Shtrim i dysHEMEVE me pllake grez importi	71
06.	Shtrese me pllaka mermeri t=3cm bazamake per shkallet	72

14. PUNIME TE NDRYSHME 72

01.	Kosh mbeturinash	72
02.	Mbulese me mushama te gomuar 3m gjeresi	73
03.	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat diameter 100	73
04.	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm	74
05.	Mbulim oxhakesh	74
06.	Davancal me mermer 3cm	75
07.	Riparim catie	75
08.	Mbulim catie me panele sandwich	75
09.	Shtylla, tabela dhe kosha basketbolli	76

01. SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

01. Të përgjithshme

Punët e specifikuara në këtë kontratë do të përfshijnë të gjitha punët e nevojshme për zbatimin, duke përfshirë prishjen dhe heqjen e elementeve ekzistuese dhe ndërtimin e kanaleve të reja dhe të gjitha materialeve të çdo lloji, të nevojshëm për ekzekutimin, përfundimin dhe mirëmbajtjen e projektit me qëllimin dhe kuptimin e vizatimeve dhe këtyre Specifikimeve. Te gjithë materialet dhe elementet e përdorur nga zbatuesi duhet të kontrollohen dhe aprovohen nga grupi i projektimit. Nëse materialet dhe elementet nuk janë të aprovuar nga grupi i projektimit zbatuesi rrezikon zëvendësimin e tyre me ato të aprovuara.

02. Programi i punimeve

Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Supervizorit një Program të Plotësuar plotësisht të detajuar në përputhje me dispozitën e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës.

03. Rradha e punimeve

Kontraktuesi do të ekzekutojë punët në mënyrë logjike dhe praktike në mënyrë që ato të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar në kontratë dhe të kryhen në mënyrë të kënaqshme për mbikëqyrësit.

04. Njësia e matjeve

Njësia e matjes do të jetë ajo e deklaruar për secilin artikull në Metodën Standarde të Matjes.

05. Shpimet eksploruese dhe testet

Kur mbikëqyrësi urdhëron që disa vende dhe teste eksploruese të kryhen në vendin e punimeve dhe rezultatet e caktuara të marra janë të paraqitura në vizatime ose sigurohen ndryshe, çdo konkluzion që Kontraktuesi mund të nxjerrë nga ky informacion, do të përdoret nga ai përgjegjësi i përcaktuar, klasifikimeve dhe karakteristikave të shtresave për çfarëdo qëllimi të projektimit të themeleve dhe strukturave që janë deklaruar në kontratë si përgjegjësi i tij. Kontraktuesi do të përmbush hetimet e tij dhe do përdorë përvojën e tij në lidhje me shtresat dhe kushtet e tokës që ndodhen aktualisht dhe duhet të lejohet të tilla normat dhe çmime dhe të rregullojë metodat e tij të punës për të marrë parasysh këto shtresa dhe çdo ndryshim natyral ose artificial që mund të ndodhë.

06. Grafiku i punimeve

- kontraktuesi
- supervizori

Kontraktuesi duhet t'i japë supervizorit një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet në ndërtim deri në mbarim të punës duke ndjekur grafikun e punimeve.

Informacioni që kontrollon supervizori duhet të përfshijë: vizatime që tregojnë rregullimin gjeneral të ambienteve të godinës dhe të ndërtimeve apo strukture tjetër të përkohshme, të cilat ai i propozon për përdorim; detaje të vendosjes konstruksionale dhe punëve të përkohshme; plane të tjera që ai propozon t'i adaptojë për ndërtim dhe përfundimin e të gjitha punëve, si dhe në vijim, detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe jo të kualifikuar si dhe supervizionin e punimeve.

07. Punime të gabuara

- mosperputhje
- riparime

Çdo punë, që nuk është në përputhje me këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit.

08. Zëvendësimet

Zëvendësimi i materjaleve të specifikuara në Dokumentin e Kontrates do të behen vetëm me aprovimin e Mbikqyresit të Punimeve nëse materiali i propozuar për të zëvendësuar është i njëjti ose më i mirë se materialet e specifikuara; ose nëse materialet e specifikuara nuk mund të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të përfunduar punimet e Kontrates për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Sipërmarrjes. Që kjo të merret në konsideratë, kërkesa për zëvendësim do të shoqërohet me një dokument dëshmi të cilesisë, në formën e kuotimit të certifikuar dhe të datës së garancisë të dorëzimit nga furnizuesit e të dy materjaleve, si të materialit të specifikuar ashtu edhe të atij që propozohet të ndryshohet.

09. Tabela njoftuese

- vendosja
- specifikimet

Asnjë tabelë njoftuese nuk duhet vendosur, përveç:

Kontraktori do të ndërtojë dy tabela, që përmbajnë informacion të dhënë nga Supervizori dhe vendosen në vendet e caktuara nga ai. Fjalët duhen shkruar në mënyrë të tillë, që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 50 m.

10. Hyrja në sheshin e ndërtimit

Sipërmarresi duhet të organizojë punën për ndërtimin, mirembajtjen dhe me pas të spostoje dhe ta rivendosë çdo rrugë hyrje që do të duhet të lidhë me zbatimin e punimeve. Zhvendosja do të përfshijë përshtatjen e zonës me çdo rrugë hyrje dhe së paku me shkallë sigurie, qendrueshmëri dhe të kullimit të ujërave sipërfaqësore të njëjta me ato që ekzistonte përpara se Sipërmarresi të hynte në Shesh.

11. Ruajtja e pronës

- komunikimi me shkrim
- dorëzimi tek supervizori
- moçrat
- librezat e masave

Para fillimit, Kontraktuesi do të kryejë një studim dhe inventarizim të ndërtesave, objekteve ekzistuese dhe strukturave të tjera pranë Punimeve siç është udhëzuar nga Mbikëqyrësi. Objektet ekzistuese të cilat janë caktuar ose lejohen të qëndrojnë do të mbrohen nga dëmtimi. Pajisjet që janë dëmtuar ose shkatërruar si rezultat i operacioneve të Kontraktorëve duhet të riparohen ose zëvendësohen nga Kontraktuesi me shpenzimet e veta. Kontraktuesi gjithashtu duhet të kryejë një studim të gjendjes së trotuareve të rrugëve ekzistuese që do të përdoren si akses për punët në praninë e mbikëqyrësit.

12. Dokumentat dhe vizatimet

Sipërmarresi do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasitë dhe detajet të treguar në Vizatimet, Grafiket, ose të dhëna të tjera dhe Punedhësi nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë mangësi ose mosperputhje të gjetur në to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mosperputhjeve nuk do të lehtësojë Sipërmarresin nga përgjegjësia për punë të pakenaqeshme. Sipërmarresi do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në berjen e llogaritjeve të madhësive, llojeve dhe sasive të materialeve dhe pajisjeve të përfshira në punën që duhet të bëhet sipas Kontrates. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonjë gabim ose mosperputhje, ndërsa një udhëzim i plote do të jepet nga Punedhësi nëse gabime të tilla ose mosperputhje do të zbulohen.

13. Dorëzimi te supervizori

- komunikimi me shkrim
- dorëzimi tek supervizorii
- mostrat
- librezat e masave

“Komunikimet me shkrim” do t’i referohen çdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga Supervizori të dërguara kontraktuesit që përmbajnë instruksione, udhëzime ose orientime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë ekzekutimin e kësaj kontrate. Kontraktori duhet t’i dorëzojë Supervizorit për çdo punim të aprovuar prej tij shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Supervizori. Kontraktori duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, materiale, certifikata testi, kurdo që të kërkohen nga Supervizori. Supervizori do të pranojë për shqyrtim çdo dorëzim dhe nëse janë të përshtatshme do t’i përgjigjet kontraktorit në përputhje me çdo klauzolë përkatëse të kushteve të kontratës. Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Supervizorin dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Supervizorit për të bërë këto pranime. Kontraktori duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve, aksesoreve dhe tema të tjera që mund të kërkohen me të drejtë nga Supervizori për inspektim. Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Supervizorit. Kontraktori do t’i përgatisë dhe dorëzojë Supervizorit tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Supervizori, si dhe librezat e masave për çdo volum pune.

14. Furnizimi me ujë

Uji, që nevojitet për zbatimin e punimeve, do të merret nga rrjeti kryesor nepermjet nje matesi ne piken me te afert te mundeshme. Sipermarresi do te shtriye rrjetin e vet te perkoheshem te tubacioneve. Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot per kete do te paguhen nga Sipermarresi. Ne rastet kur nuk ka mundesi lidhje me rrjetin kryesor, Sipermarresi duhet te beje vete perpjekjet per furnizimin me uje higjenikisht te paster dhe te pijshem per punetoret dhe punimet.

15. Furnizimi me energji elektrike

Sipermarresi do te beje perpjekjet dhe me shpenzimet e tij per furnizimin me energji elektrike ne kantjer, si me kontraktim me OSHEE, kur lidhjet me rrjetin kryesor lokal jane te mundura, ose duke parashikuar

gjeneratorin e vet për të përmbushur kërkesat.

16. Piktimi i punimeve

Sipërmarresi, me shpenzimet e tij duhet të bëjë ndërtimin e modinave dhe të piketave siç kërkohet, në përputhje me informacionin bazë të Punedhësit, dhe do të jetë përgjegjës i vetëm për përpikërimet. Sipërmarresi do të jetë përgjegjës për të kontrolluar dhe verifikuar informacionin bazë që i është dhënë dhe në asnjë mënyrë nuk do të lehtësohet nga përgjegjësia e tij nëse një informacion i tillë është i mangët, jo autentik ose jo korrekt. Ai ndërkohe do të jetë subjekti që do të kontrollohet dhe rishikohet nga Punedhësi, dhe në asnjë rast nuk i jepet e drejta të bëjë ndryshime në vizatimet e kontratës, për asnjë lloj kompensimi për korigjimet e gabimeve ose të mangësive. Sipërmarresi do të furnizojë dhe mirëmbaje me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale të tjera të tilla dhe të japë asistencë nëpërmjet një stafi të kualifikuar siç mund të kërkohet nga Punedhësi për kontrollin e modinave dhe piketave. Sipërmarresi do të ruajë të gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, të bërë ose të vendosura gjatë punës, të mbulojë koston e rivendosjes së tyre nëse ato demtohen dhe të mbulojë të gjitha shpenzimet për ndreqjen e punës së bërë jo mirë për shkak të mosmirëmbajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim të këtyre pikave të vendosura, modinave dhe piketave.

Përpara çdo aktiviteti ndërtimor, Sipërmarresi do të ketë linjat e furnizimit me ujë dhe energji elektrike të vendosura në terren, të drejtën e kalimit të qartë dhe të sheshuar, gati për fillimin e punimeve. Çdo punë e bërë jashtë akseve, kuotave dhe kufijve të treguara në vizatime ose të mosmiratuara nga Punedhësi nuk do të paguhet, dhe Sipërmarresi do të mbulojë me shpenzimet e tij gërmimet shtesë gjithmone nën drejtimin e Mbikqyresit të Punimeve.

17. Fotografitë e sheshit të ndërtimit

Sipërmarresi duhet të bëjë fotografi me ngjyra sipas udhëzimeve të Mbikqyresit të Punimeve në vendet e punës për të demonstruar kushtet e sheshit përpara fillimit, progresin gjatë punës së ndërtimit dhe mbas përfundimit të punimeve. Nuk do të behen pagesa për fotografimin e kantierit të punimeve pasi këto shpenzime janë parashikuar të mbulohen nën koston administrativë të Sipërmarresit.

18. Bashkëpunimi në zonë

Ndërtimi do të behet në zonë të kufizuara. Sipërmarresi duhet të ketë vecanerisht kujdes në:

prezencën e mundshme të kontraktoreve të tjerë në zonë me të cilët do të koordinohet puna

E gjithë puna, do të bëhet në një mënyrë të tillë, që të lejojë hyrjen dhe perballimin e të gjithë pajisjeve të mundshme për ndonjë Kontraktor tjetër dhe punëtorëve të tij, stafin e Punëdhënësit si edhe të çdo punënjësi që mund të punësohet në zbatim dhe/ose punimet në zonë ose pranë saj për çdo objekt që ka lidhje me Kontraten ose çdo gjë tjetër.

Në përgatitjen e programit të tij të punës, Sipermarresi gjatë gjithë kohës do të bëjë llogari të plote dhe do të koeporojë me programin e punës së Kontraktoreve të tjerë, në mënyrë që të shkaktojë një minimum ndërference me ta dhe me publikun.

19. Mbrojtja e punës dhe e publikut

Sipermarresi do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punëtorëve të punësuar dhe të jetes publike si edhe të pasurive në dhe rreth sheshit të ndërtimit. Masat e sigurimit paraprak të ligjeve të aplikueshme, kodeve të ndërtësive dhe të ndërtimit do të respektohen. Makinerite, pajisjet dhe çdo rrezik do të këqyren ose eliminohen në përputhje me masat paraprake të sigurimit.

Gjatë zbatimit të punimeve Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet të vendosi dhe të mirëmbajë gjatë natës pengesa të tilla dhe drita të cilat do të parandalojnë në mënyrë efektive aksidentet. Sipermarresi duhet të sigurojë pengesa të pershtatëshme, shenja me drite të kuqe "rrezik" ose "kujdes" dhe vrojtues në të gjitha vendet ku punimet mund të shkaktojnë crregullime të trafikut normal ose që përbejnë në ndonjë mënyrë rrezik për publikun

20. Mbrojtja e ambientit

Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet të ndermarre të gjithë veprimet e mundshme për të siguruar që ambienti lokal i sheshit të ruhet dhe që linjat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera. Mos plotësimi i kësaj klauzole në bazë të evidentimit nga Mbikqyresi i Punimeve, mund të çojë në ndërprerjen e kontratës.

21. Transporti dhe magazinimi i materialeve

Transporti i çdo materiali nga Sipermarresi do të bëhet me kamione të cilët kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Kamionet që nuk plotësojnë këto kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqen nga kantjeri. Të gjitha materialet që sillen nga Sipermarresi, duhet të stivohen ose të magazinohen në mënyrë të pershtatëshme për të mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dispozicion, për tu kontrolluar nga Mbikqyresi i Punimeve në çdo kohë.

22. Ripunimi i vizatimeve (Vizatimet siç është zbatuar)

Sipermarresi duhet të përgatisë vizatimet për të gjitha punimet "siç janë faktikisht zbatuar" në terren.

Vizatimet do të bëhen në një standart të ngjashëm me ato të vizatimeve të Kontrates.

Gjatë zbatimit të punimeve në kantiër, Sipermarresi do të ruajë të gjithë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e "Vizatimeve siç është zbatuar". Do të shënojë në mënyrë të qartë vizatimet dhe të gjitha dokumentat e tjera të cilat mbulojnë punën e vazhdueshme të përfunduar, material i cili do të jetë i disponueshëm në çdo kohë gjatë zbatimit për Menaxherin e Projektit. Këto vizatime do të azhurnohen në mënyrë të vazhdueshme dhe do t'i dorëzohen Mbikqyresit të Punimeve çdo muaj për aprovim, pasi Punimet të kenë përfunduar, sëbashku me kopjen përfundimtare. Materiali mujor do të dorëzohet në kopje leter. Vizatimet e riprodhuara do të përfshijnë pozicionin dhe shtrirjen e të gjithë konstruksioneve mbajtëse të lena gjatë germimeve dhe vendosjen e këzakteve të të gjitha shërbimeve që janë ndeshur gjatë ndërtimit. Sipermarresi gjithashtu duhet të përgatisë seksionet e profilit gjatësor të rishikuar, pajisur me shënimet që tregojnë shtresat e tokës që hasen gjatë të gjitha punimeve të germimit. Si përfundim, kopjet e riprodhuara të Vizatimeve "siç është zbatuar" do t'i dorëzohen Mbikqyresit të Punimeve për aprovim. Vizatimet "siç është zbatuar", të aprovuara, do të bëhen prone e Punedhënesit. Nuk do të bëhen pagesa për bërjen e Vizatimeve "siç është zbatuar" dhe Manualeve, pasi kosto e tyre është parashikuar të mbulohet nga shpenzimet administrative të Sipermarresit.

23. Pastrimi përfundimtar i zonës

Në përfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme Sipermarresi, me shpenzimet e tij, duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skelerite dhe ndërtimet e perkoheshme të çdo lloji dhe të lere sheshin e tere dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme. Pagesa përfundimtare e Kontrates do të mbahet deri sa kjo të realizohet dhe pasi të jepet miratimi nga Mbikqyresi i Punimeve.

24. Provat

Ky seksion përfaqëson procedurat e kryerjes së provave për materialjet me qëllim që të sigurojë dhe përputhje me kërkesat e Specifikimeve.

Tipi dhe Zbatimi i Provave

Do te kryhen provat e meposhtme:

- Permbajtja e Ujit
- Densiteti Specifik
- Indeksi i Plasticitetit
- Densiteti ne gjendje te thate (Metoda e Zevendesimit me Rere)
- Shperndarja Sipas Madhësisë së Grimcave (Sitja)
- Proktori i Modifikuar dhe Normal
- CBR (California Bearing Ratio)
- Provat e Bitumit
- Provat e Betonit (Thermimi i Kampioneve)

Standartet per Kryerjen e Provave

Te gjitha provat do te behen ne perputhje me metodat standarte shqiptare ose me te tjera nderkombetare te aprovuara.

Marrja e Kampioneve edhe Numri i Provave

Metoda e marrjes se kampioneve do te jete sic eshte specifikuar ne metodat e aplikueshme te marrjes se kampioneve dhe te kryerjes se provave ose sic udhezohet nga Mbikqyresit te Punimeve.

Frekuenca e kryerjes se provave do te perputhet me treguesit ne Specifikimet Teknike dhe nese nuk gjendet atje, do te jepet nga Mbikqyresit te Punimeve. Marrja e ndonje kampioni shtese mund te udhezohet nga Mbikqyresit te Punimeve.

Marrja, transportimi e sjellja e tyre ne laborator do te behet nga Sipermarresi.

Nderprerja e Punimeve

Nderprerja e punimeve per arsye te marrjes se kampioneve do te perfshihet ne grafikun e punimeve te Sipermarresit. Nuk do te pranohet asnje ankese nga nderprerja e punimeve, per shkak te marrjes se kampioneve. Provat ne laborator, do te behen ne nje kohe te pershtatshme me metoden e pershkruar.

25. Certifikatat e cilësisë

- ISO 9001-2000

- CE
- OHSAS 18001:2007

Është përgjegjësi e Kontraktuesit për të marrë të gjitha masat për të siguruar cilësinë e nevojshme për të gjitha produktet që do të prodhohen apo montohen në kantiere.

Produktet e përdorura duhet të përmbushin parametrat e certifikuar të cilësisë ISO - 9001 : 2000 si dhe të jenë standartit CE.

Certifikata ISO 9001:2000, ajo e sistemeve të menaxhimit të cilësisë, specifikon nevojat e produktit lidhur me cilësinë që ofron prodhuesi i produktit si në përmbushjen e kërkesave të klientit ashtu edhe në aplikimin efektiv të produktit në kantiere.

Ndërkaq certifikimi CE siguron që produkti të përmbushë standartet konform shëndetit, sigurisë, dhe mbrojtjes së mjedisit për produktet e tregtuara brenda Bashkimit Europian. Gjithashtu do të duhet të përmbushet edhe standarti i cilësisë OHSAS 18001:2007. punimet e prishjeve dhe gërmimet në objekt

02. PUNIMET E PRISHJEVE DHE GËRMIMET NË OBJEKT

01. Qëllimi

Ky seksion përmban përcaktimet e përgjithshme dhe kërkesat për punimet e gërmimeve në tokë (në vëllim dhe/ose me shtresë) dhe gërmimet për struktura në kanale, përfshirë gërmim nën ujë. Me tej ajo mbulon të gjitha punimet që lidhen me konstruksionin e prerjeve, largimin e materialeve të papershtatshme në hedhurina, dhe rifiniturat e shpatit të prerjes.

02. Gërmimi

- gërmimet
- mbushjet

Kontraktuesi, sapo vendi apo pjesa e tij është dorëzuar para se të fillojë pastrimi apo gërmimi, do të studiojë së bashku me mbikëqyrësin tërë vendin. Përgatitja e formacioneve përfshin këto punë:

-Njohja dhe saktësimi i rrjeteve të instalimeve nën tokë si p.sh.: tuba të furnizimit të ujësjellësit, tuba të shkarkimit, kabllot elektrike dhe telefonie etj

-Matja e terrenit

a) Gërmimi duhet të kryhet në përputhje me nivelet dhe vijat e prerjeve siç tregohet në Vizatime. Çdo thellësi më e madhe e gërmuar në nivelin e formacionit, brenda tolerancës së lejuar, duhet të

behet mire me mbushje me materiale te pranueshme me karakteristika te ngjashme nga Sipermarresi me shpenzimet e tij.

b) Kujdes i vecante duhet te ushtrohet kur germohen prerje per te mos hequr material pertej vijes se specifikuar te prerjes dhe me pas duke shkaktuar rrezikshmeri per qendrueshmerine strukturore te pjerrsesise ose duke shkaktuar erozion ose disintegrimin e pjeseve te ngjeshura.

c) Permasat e prerjeve duhet te jene ne perputhje me detajet e seksione terthore tip sic tregohen ne Vizatime.

03. Gërmimet me krahë

- lloji i gërmimit

Germime dheu për punime të ndryshme nëntokësore, në truall të çfaredo natyre të thatë ose të lagur (argjilë edhe n.q.s. është kompakte, rërë, zhavorr, gurë etj,) duke përfshirë prerjen dhe heqjen e rrënjëve, trungjeve, gurëve ku mund te përdoren mjete pune krahu.

04. Trajtimi/Ngjeshja e Zonave të Gërmuara

a) Zonat dhe pjerrsesite e prerjeve duhet te jene konform me Vizatimet dhe duhet te rregullohen sipas nje vije te paster te standartit, per nje tip te dhene materiali.

b) Te gjitha zonat horizontale te germuara, duhet te ngjeshen me nje minimum dendesie te thate prej 95% per dhera te shkrifet dhe 90% per dhera te lidhur.

05. Pastrimi i sheshit

Te gjitha sheshet ku do te germohet, do te pastrohen nga te gjitha shkurret, bimet, ferrat, rrenjet e medha, plehrat dhe materiale te tjera siperfaqesore. Te gjitha strukturat ekzistuese te identifikuar per tu prishur do te largohen sipas udhezimeve te Mbikqyresit te Punimeve. Kjo do te perfshije dhe prishjen e themeleve te ndertimeve qe mund te ndeshen.

Sipermarresi do te marre te gjitha masat e nevojeshme per mbrojtjen e vijave ekzistuese te ujit, rrethimeve dhe sherbimeve qe do te mbeten ne sheshin e ndertimit. Te gjitha materialet qe nuk jane toke natyrale do te hiqen dhe transportohenne vendin e grumbullimit te mbeturinave te qytetit.

06. Gërmimi për Strukturat

Kjo punë do të përbëhet nga të gjitha gërmimet për themelet e çdo strukture, duke përfshirë kutite e betonit të forcuara për kanalizimet, pjesen ballore të daljes së kanalizimit, muret anesore mbajtëse, mbështetëset e sjenjave dhe muret mbajtëse, me përjashtim të gërmimeve të përgjithshme të kryera në vijën bregdetare. Kjo punë do të përfshijë shtrimin, drenazhimin, pompimin, copëtimin e nevojshëm, ndërtimin e domosdoshëm të zonave për të larguar perkoheishtë ujin ose brinjëve anesore të kësaj strukture, si dhe heqjen e tyre të mëvonshme dhe mbushjen për ta risjelle terrenin në gjendjen fillestare. Kjo punë përfshin hedhjen e të gjithë materialeve të nxjerra nga gërmimi dhe mbushja e papërshtatshme në nivelin e terrenit origjinal. Ai do të përfshijë pajisjen dhe vendosjen e materialit për të mbushur të bazën, të miratuar për të zëvendësuar materialin e papërshtatshëm që haset nën ngritjen e themeleve të strukturave.

Kontraktuesi do të vizitojë vendin dhe do të vlerësojë përbërjen gjeologjike të zonës për vete dhe do të bazojë çmimet e ofertës vetëm në përcaktimin e tij të kushteve gjeologjike. Variacionet në vëllimin ose karakterin aktual të sasive të gërmimeve strukturore nuk do të jenë bazë për kërkesën për para shtesë ose për rishikimin e çmimit të ofertës nga Kontraktuesi. Asnjë lejim nuk do të bëhet për klasifikimin e materialeve pavarësisht nga pronat e tyre fizike.

07. Gërmimi struktural për kanalizimet dhe strukturat mikse

Gërmimet për kanalizimet dhe struktura të ndryshme duhet të kryhen në kufijtë e kërkuar për ndërtim dhe në thellësinë e kërkuar për materialin e shtratit ose largimin e materialeve të papërshtatshme.

Kur materialet e papërshtatshme ndeshen nën lartësi themeli për strukturat e kutive të betonit të armuar ose tubacionet prej betoni të kanalizimeve, Kontraktuesi, në drejtimin e mbikëqyrësit, do të gërmojë material të tillë të papërshtatshëm dhe do të zëvendësohet me materiale të përshtatshme dhe të qëndrueshme.

Stabilizimi i themelit, duke përfshirë shkallën e paqëndrueshmërisë së materialit ekzistues, thellësinë e nevojshme të gërmimit dhe përshtatshmërinë e materialit të mbushjes së propozuar, miratohet nga Mbikëqyrësi para fillimit të gërmimit.

Nëse nuk kërkohet një shtrim i posaçëm, themeli për tubat e parafabrikuar të betonit për kanalizimet dhe duhet të prodhohet duke ndjekur formën e kanalizimeve, duke përfshirë të gjitha zgjatimet. Forma duhet të shtrihet në njëzet e pesë përqind (25%) të lartësisë normale të kanaleve.

08. Përforcimi i ndërtesave

Si pjesë e punës në zërat e gërmimit Sipermarresi, do të forcojë të gjithë ndërtimet, muret si edhe

strukturat e tjera qendrushmeria e te cilave duhet te garantoje mosrrezikimin gjate zbatimit te punimeve dhe do te jete teresisht pergjegjes per te gjitha demtimet e personave ose te pasurive qe do te rezultojne nga aksidentet e ndonje prej ketyre ndertimeve, mureve ose strukturave te tjera. Neqofte ndonje nga keto pasuri, struktura, instalime ose sherbime do te rrezikohen ose demtohen si rezultat i veprimeve te Sipermarresit, ai menjehere duhet te raportoje per keto rreziqe ose demtime Menaxherin e Projektit si dhe autoritetet qe kane lidhje me te dhe menjehere te mare masa per ndreqjen, gjithmone sipas pelqimit te Mbikqyresit te Punimeve ose te autoriteteve perkatese.

09. Largimi i ujërave nga punimet e gërmimit

Si pjese e punes ne zerat e gërmimit dhe jo me kosto plus per Punedhënesin, Sipermarresi do te ndertoje te gjitha drenazhimet dhe do te realizoje kullimin me kanale kulluese ,me pompim si edhe te gjithë punet e tjera te nevojshme per te mbajtur pjesen e germuar te paster nga ujerat e zeza dhe nga ujera te jashme gjate avancimit te punes dhe deri sa puna e perfunduar te jete e siguruar nga demtimet. Sipermarresi duhet te siguroje te gjitha pajisjet e pompimit per punimet e tharjes se ujit si edhe personelin operativ, energjine e te tjera, dhe te gjitha keto pa kosto shtese per Punedhënesin. I gjithë uji i pompuar ose i drenazhuar nga vepra duhet te hiqet ne nje menyre te aprovueshme prej Mbikqyresit te Punimeve. Duhet te meren masa paraprake te nevojshme kunder permbytjeve.

10. Heqja e materialeve të tepërta nga gërmimi

I gjithë materiali i tepert i germuar nga Sipermarresi do te largohet ne vendet e aprovuara. Kur eshte e nevojshme te transportohet material mbi rruget ose vende te shtruara Sipermarresi duhet ta siguroje kete material nga derdhja ne rruge ose ato vende te shtruara.

11. Skeleritë

- siguria teknike
- standartet
- llojet e skelerive

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kontraktori duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar skelatorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar.

Duhen marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.

Në rastet e kryerjes së punimeve në anë të rrugës ku ka kalim si të kalimtarëve, ashtu edhe të makinave, duhet të merren masa që të bëhet një rrethim I objektit, si dhe veshja e të gjithë skelerisë me rrjete mbrojtëse për të eliminuar rënien e materialeve dhe duke përfshirë shenjat sinjalizuese sipas kushteve të sigurimit teknik.

Skeleri çeliku të tipit këmbalëc, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parmakë vertikalë, më lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.

Skeleri çeliku me kornize dhe e lidhur, konform KTZ dhe STASH duke përfshirë për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parmakë vertikalë, me lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.

12. Germimet me makineri

Gërmime dheu për punime të ndryshme nëntokësore, në truall të çfaredo natyre të thatë ose të lagur (argjilë edhe n.q.s. është kompakte, rërë, zhavorr, gurë etj.) kur nuk mund të bëhen me krahë por duhet të përdoren makineri.

13. Metoda e prishjes

- stakimi nga rrjeti elektrik dhe rrjetet e tjera
- zbrasia nga ngarkesat e tepërta të strukturës
- metoda

Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të jenë shkëputur energjia elektrike dhe rrjetet e tjera të instalimeve ekzistuese të objektit. Metodatat e prishjes së pjesëshme, duhet të jenë të tilla që pjesa e strukturës që ka mbetur të sigurojë qëndrueshmërinë e ndërtesës dhe të pjesëve që mbeten. Kur prishja e ndërtesës ose e elementeve të saj nuk mund të bëhet pa probleme e ndarë nga pjesa e strukturës do të përdoret një metodë pune e përshtatshme. Elementë çeliku dhe struktura betoni të forcuar do të ulen në tokë ose do të prihen për së gjati sipas gjerësisë dhe përmasave në menyre që të mos bien. Elementët e drurit mund të hidhen nga lart, vetëm kur ato nuk paraqesin rrezik për pjesën tjetër të strukturës. Kur prishen elementët, duhen marrë masa për të mos rrezikuar elementët e tjerë konstruktive mbajtës, si dhe mos dëmtohen elementët e tjerë. Në përgjithësi, puna e shkatërrimit duhet të fillojë duke hequr sa më shumë ngarkesa të panevojshme, pa ndërhyrë në elementët bazë struktural. Punë të kujdesshme do të bëhen për

të hequr ngarkesat kryesore nën kushtet më të vështira. Seksionet të tjera që do të prishen do të transportohen me vinç ose nga krik hidraulik të lëvizshëm.

14. Prishje e elementeve konstruktiv beton-arme

- metoda

Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të jenë hequr sa më shumë ngarkesa të panevojshme.

Për prishjen e elementeve beton-arme duhen marrë masa paraprake mbrojtëse. Për të siguruar strukturën duhet të ngrihen skeleri dhe puntela sipas nevojës dhe rastit. Pasi të jenë bërë përgatitjet dhe sigurimet e nevojshme do të behet thyerja e elementeve beton-arme me çfarëdolloj mjeti të nevojshëm (mekanizma si matrapik, vegla). Elementet metalik do të prihen me gurë fleksibel dhe kur është nevoja do të lihet gjatësia e nevojshme e elementeve për strukturat e reja. Prishje të çfarëdo lloji duhet ndjekur me pastrim, larje, duke përfshirë largimin e materialeve jashtë ambientit të kantierit, si dhe çdo detyrim tjetër.

15. Prishja, çmontimi dhe largimi elementeve ose strukturave metalike

- sigurimi teknik
- metoda
- largimi i elementeve dhe mbetjeve

Puna për prishjen ose çmontimin e elementeve ose strukturave metalike do të fillojë vetëm pasi të sigurohen kushtet që të mos demtohen elementë të tjerë konstruktiv. Skelera e nevojshme do të ngrihet për të bërë më të lehtë punën e prishejve. Kur është e nevojshme do të kryhen pajantime të elementeve të strukturave metalike dhe vendosja puntelave për të siguruar një çmontim ose prishje të sigurt. Në raste kur është e mundur do të behet çmontimi i elementeve. Kur kjo nuk është e mundur do të bëhet prerja e elementeve me gur fleksibel. Largimi i sigurt i elementeve nga objekti mund të bëhet me vinç ose me krik hidraulik të lëvizshëm. Në rastet kur largimi i elementeve është i vështirë ose i pamundur, elementet mund të priten në pjesë më të vogla për të lehtësuar procesin. Prishje të çfarëdo lloji duhet ndjekur me pastrim, larje, duke përfshirë largimin e materialeve jashtë ambientit të kantierit, si dhe çdo detyrim tjetër.

16. Prishja e mureve brenda

- metoda
- largimi i elementeve dhe mbetjeve

Në përgjithësi, puna e shkatërrimit duhet të fillojë duke hequr sa më shumë ngarkesa tëpanevojshme, pa ndërhyrë në elementët bazë struktural. Punë të kujdesshme do të bëhen përtë hequr ngarkesat kryesore nën kushtet më të vështira. Seksionet të tjera që do të prishen do të transportohen me vinç ose nga krik hidraulik të lëvizshëm. Prishje e muraturës me tulla të plota ose me vrima, e çfarëdo lloji dhe dimensionit, edhe e suvatuar ose e veshur me majolikë, që realizohet me çfarëdolloj mjete dhe e çfarëdo lartësie ose thellësie, përfshirë skelën e shërbimit ose skelerinë, armaturat e mundshme për të mbështetur ose mbrojtur strukturat ose ndërtesat përreth, riparimi për dëmet e shkaktuara ndaj të tretëve për ndërprerjet dhe restaurimin normal të tubacioneve publike dhe private (kanalet e ujrave të zeza, ujë, dritat etj.), si dhe vënien mënjane dhe pastrimin e gurëve për përdorim, duke bërë sistemimin brenda ambientit të kantierit. Gjithashtu, edhe çdo detyrim tjetër që siguron plotësisht prishjen.

Ne venciati ne qendren e artit do te kete prishje muresh ne disa raste, mund te permendim ketu prishjet e mureve ekzistuese prej kartonxhesi, prishjet e mureve te tulles neper tualete, hapje dyersh ne mure tulle ekzistues.

17. Prishje shtresave me pllaka gres porcelanate

- metoda
- largimi i elementeve dhe mbetjeve

Prishje e veshjeve të çfarëdo lloji dhe prishje e llaçit që ndodhet poshtë, pastrim, larje, duke përfshirë largimin e materialeve jashtë ambientit të kantierit, si dhe çdo detyrim tjetër.

18. Prishje suvatimi

- metoda
- largimi i elementeve dhe mbetjeve

Goditje e të gjithë sipërfaqes së dëmtuar të suvatimit dhe gjetja e pjesëve të mufatura dhe të plasaritura nëpërmjet tingullit, prishjen e këtyre pjesëve deri në daljen e muraturës, në mure dhe tavane, larje e sipërfaqeve të prishura me ujë me presjon, duke përfshirë skelat e shërbimit ose skelerinë, spostimin e materialit që rezulton brenda ambientit të kantierit si dhe çdo detyrim tjetër për të dhënë plotësisht fund heqjes së suvasë. Matrapiku jo me shume se 9kg per te mos demtuar tullat dhe per mundesi perdorimi nga punetori

19. Prishje shtrese lluster cemento

- metoda

- largimi i elementeve dhe mbetjeve

Per prishjen e kesaj shtrese do te perdoret matrapik dore deri ne 16kg, per te evituar dridhjet e teperta ne soleten e poshtme. Thyerja e saj fillon ne ane te kundert dhe perfundon ne drejtim te deres hyerese. Materiali grumbullohet dhe nxirret jashte ne vendin e grumbullimit me karroce dore. Me vone hiqet me makineri ne drejtim te landfillit.

20. Transport materiale te ndryshme deri ne 1.0 km

Kontraktori duhet të heqë me kujdes vetëm ato ndërtime, gardhe, ose struktura të tjera të drejtuara nga Supervizori. Komponentët duhen çmontuar, pastruar dhe ndarë në grumbuj. Komponentët të cilët sipas Supervizorit nuk janë të përshtatshëm për ripërdorim, duhen larguar, punë kjo që kryhet nga kontraktuesi. Materialet që janë të ripërdorshme do të mbeten në pronësi të investitorit dhe do të ruhen në vende të veçanta nga kontraktori, derisa të lëvizin prej tij deri në përfundim të kontratës. Kontraktori, duhet të paguajë çdo dëmtim të bërë gjatë transportit të materialeve me vlerë, të rrethimeve dhe strukturave të tjera dhe nëse është e nevojshme duhet të paguajë kompensim.

21. Prishja dhe heqja e instalimeve elektrike

- sigurimi teknik
- metoda
- largimi i elementëve dhe mbetjeve

Puna per prishjen dhe heqjen e instalimeve elektrike do të fillojë pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese. Komponentët dhe elementet e instalimeve duhen çmontuar, pastruar dhe ndarë në grumbuj.

Materialet që janë të ripërdorshme do të mbeten në pronësi të investitorit dhe do të ruhen në vende të veçanta nga kontraktori, derisa të lëvizin prej tij deri në përfundim të kontratës.

Pas çdo prishje duhet bërë pastrim, larje, duke përfshirë largimin e materialeve jashtë ambientit të kantierit, si dhe çdo detyrim tjetër.

22. Prishja dhe heqja e instalimeve hidraulike

- sigurimi teknik
- metoda

- largimi i elementeve dhe mbetjeve

Puna për prishjen dhe heqjen e instalimeve hidraulike do të fillojë pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese. Komponentët dhe elementet e instalimeve duhen çmontuar, pastruar dhe ndarë në grumbuj.

Materialet që janë të ripërdorshme do të mbeten në pronësi të investitorit dhe do të ruhen në vende të veçanta nga kontraktori, derisa të lëvizin prej tij deri në përfundim të kontratës.

Pas çdo prishje duhet bërë pastrim, larje, duke përfshirë largimin e materialeve jashtë ambientit të kantierit, si dhe çdo detyrim tjetër.

03. PUNIME BETONI DHE BETON ARME

01. Të përgjithshme

Puna e mbuluar nga ky seksion i specifikimeve konsiston në furnizimin e gjithë kantierit, punën, pajisjet, veglat dhe materialet, dhe kryerjen e të gjitha punimeve, në lidhje me hedhjen, kujdesin, përfundimin e punës së betonit dhe hekurin e armimit në përputhje rigoroze me këtë kapitull të specifikimeve dhe projekt zbatimin. Në fillim të Kontrates Sipermarresi duhet të paraqesë për miratim tek Mbikqyesi i Punimeve një njoftim për metodat duke detajuar, në lidhje me kërkesat e këtyre Specifikimeve, propozimet e tij për organizimin e aktiviteteve të betonimit në shesh (terren). Njoftimi i metodave do të përfshijë çështjet e mëposhtme:

1. Njesia e prodhimit e propozuar
2. Vendosja dhe shtrirja e paisjeve të prodhimit të betonit
3. Metodatat e propozuara për organizimin e paisjeve të prodhimit të betonit
4. Procedurat e kontrollit të cilësisë së betonit dhe materialeve të betonit
5. Transporti dhe hedhja e betonit
6. Detaje të punës së berjes së kallepeve duke përfshirë kohën e heqjes së kallepeve dhe procedurat për mbështetjen e perkohshme të trareve dhe të soletave.

02. Kontrolli i cilësisë

Sipermarresi do të punesoje inxhinier të kualifikuar, të specializuar dhe me eksperiencë, i cili do të jetë përgjegjës për kontrollin e cilësisë të të gjithë betonit. Materialet dhe mjeshteria e përdorur në punimet e betonit duhet të jetë e një cilësie sa më të lartë që të jetë e mundur, prandaj vetëm personel me eksperiencë

dhe aftesi te plote ne kete kategori punimesh do te punohesohet per punen qe perfshin ky seksion specifikimesh.

03. Puna përgatitore dhe inspektimi

Perpara se te jete kryer ndonje proces i pergatitjes se llacit ose betonit, zona brenda armaturave (ose siperfaqe te tjera sipas zbatimit) duhet te jete pastruar shume mire me uje ose me ajer te komprimuar. Cfaredo qe ka te beje me kete proces duhet te pergatitet sic eshte specifikuar. Asnje proces betonimi nuk duhet te kryhet derisa Mbikqyresi i Punimeve te kete inspektuar dhe aprovuar (ne se eshte e mundur) germimin, masat e marra per mbrojtjen nga kushtet atmosferike, masat per shperndarjen e ujit per freskim dhe staxhionim, armaturat, ndalimin e ujit, fugat ndertimore dhe fiksimin e fundeve dhe masa te tjera, armimin dhe ceshtje te tjera qe duhet te fiksohen, si dhe te gjitha materialet e tjera per betonimin dhe masa te tjera ne pergjithesi. Sipermarresi duhet t'i jape Mbikqyresit te Punimeve njoftime te arsyeshme per te bere te mundur qe ky inspektim te kryhet.

04. Materialet

- Cimento
- Inertet
- Inertet e imta
- Inertet e trasha
- Raportet inertet e imta me te trasha
- Shperndarja
- Ruajtja e materialit te betonit
- Uji per cimento

Cimento

a. Çimento Portland e Zakonshme do te perdoret me BS 12 ose ASTM C-150 Tipi II- te ose Tipi V-te. Kjo do te perdoret aty ku betoni nuk eshte ne kontakt me ujera te zeza, tub gazi ose ujerat nentokesore.

b. Çimento Portland Sulfate e Rezistueshme do te perdoret me BS 4027. Kjo do te perdoret per strukturat e betoneve duke perfshire pusetat dhe te gjitha perkatesite e tjera ne kontakt me ujerat e zeza, tubin e gazit ose ujerat nentokesore. Çimento duhet te shperndahet ne paketa origjinale te shenuara te pa demtuara direkt nga fabrika dhe duhet te ruhet ne nje depo, dyshemeja e te cilit duhet te jete e ngritur te pakten 150mm nga toka. Nje sasi e mjaftueshme duhet mbajtur rezerve per te siguruar nje furnizim te vazhdueshem ne pune, ne menyre qe te sigurohet qe dergesat e ndryshme jane perdorur ne ate menyre sic

jane shperndare. Çimentoja nuk duhet ruajtur ne kantier per me shume se tre muaj pa lejen e Mbikqyresit te Punimeve. Çdo lloj tjetër cimento, pervec asaj qe eshte e parashikuar per perdorimin ne pune nuk duhet ruajtur ne depo te tilla. E gjithë cimentoja duhet mbajtur e ajrosur mire dhe cdo lloj cimento, e cila ka filluar te ngurtesohet, ose ndryshe e demtuar apo e keqesuar nuk duhet te perdoret. Fletet e analizave te fabrikave duhet te shoqerrojne cdo dergese duke vertetuar qe cimentoja, e cila shperndahet ne shesh ka qene e testuar dhe i ka plotesuar kerkesat e permendura me lart. Me te mberitur, certifikatat e provave te tilla duhen ti kalohen per t'i aprovuar Mbikqyresit te Punimeve. Çimentoja e perfituar nga pastrimi i thaseve te çimentos ose nga pastrimi i dyshemese nuk do te perdoret. Kur udhezohet nga Mbikqyresi i Punimeve, çimento e dyshimte duhet te riestohet per humbjen e fortesise ne ngjeshje.

Inertet

Te pergjithshme

Me perjashtim te asaj qe eshte modifikuar ketu, inertet (te imta dhe te trasha) per te gjitha tipet e betonit duhet te perdoren duke respektuar STASH-512-78 (Standarti Shqiptar) ose ne perputhje me ASTM C 33 "Inertet e betonit nga burime natyrale". Ato duhet te jene te forte dhe te qendrueshem dhe nuk duhet te permbajne materiale te demshme qe veprojne kunder fortesise ose qendrueshmerise se betonit ose, ne rast te betonarmese mund te shkaterroje kte perforcim. Materialet e perdorura si inerte duhet te perftohen nga burimet te njohura per te arritur rezultate te kenaqshme per klasa te ndryshme te betonit. Nuk do te lejohet perdorimi i inerteve nga burime, te cilat nuk jane te aprovuara nga Mbikqyresi i Punimeve.

Inertet e imta

Inertet e imta per kategorite e betonit A, B dhe C (respektivisht M100, M200, M2500) konform STASH 512-78, do te jene prej rere natyrale, gure te shoshitur, ose materiale te tjera inerte me te njejtat karakteristika apo kombinim te tyre. E gjitha kjo duhet te jete pastruar shume mire, pa masa te mpiksura, cifla te buta e te vecanta, vajra distilimi, alkale, lende organike, argjile dhe sasi te substancave demtuese. Permbajtja maksimale e lejueshme e lymit dhe substancave te tjera demtuese eshte 5%. Materialet e marra nga gure te papershtashem per inerte te trasha nuk duhet te perdoren si inerte te imta. Inertet e imta te marra nga guret e shoshitur duhet te jene te mprehte, kubike, te forte, te dendur dhe te durueshem dhe duhet te grumbullohen ne nje platforme per te patur nje mbrojtje te mjaftueshme nga pluhurat dhe perzierjet e tjera. Shkalla e shperndarjes per inertet e imeta te specifikuara si me lart, duhet te jene brenda kufijve te meposhtem, te percakuara nga Mbikqyresi i Punimeve.

10.00mm	100
5.00mm	89 ne 100
2.36mm	60 ne 100
1.18mm	30 ne 100
0.60mm (600 um)	15 ne 100
0.30mm (300 um)	5 ne 70
0.15mm (150 um)	0 ne 15

Inertet e imeta per kategorine D te betonit duhet te jene te nje cilesie te mire nga rera e brigjeve. Ajo duhet te jete pastruar nga materialet natyrale e klasifikuar nga me e holla deri tek me e trasha, pa copeza, nga argjila, zgjyra, hirera, plehra dhe cifla te tjera. Nuk duhet te permbaje me shume se 10% te materialit me te holle se 0.10mm (100um) te hapesires ne rrjete, jo me shume se 5% te pjeses se mbetur ne 2.36mm site; i gjithë materiali duhet te kaloje neper nje rrjete 10mm.

Inertet e trasha

Inertet e trasha per kategorite e betonit A, B dhe C do te perbehen nga materiale guri te thyer apo te nxjere ose nje kombinim i tyre, me nje mase jo me shume se 20 mm, dhe do te jene te paster, te forte, te qendrueshem, kubik dhe te formuar mire, pa lende te buta apo te thermueshme, ose copeza te holla te stergjatura, alkale, lende organike ose masa apo substanca te tjera te demshme. Lendet demtuese ne inerte nuk duhet te kalojne me shume se 3 %. Klasifikimi per inertet e trasha te specifikuara sa me siper duhet te jete brenda kufijve te meposhtem:

Masa e sites	Perqindja e kalimit (ne peshe te thate)
50.0 mm	100
37.5 mm	90 ne 100
20.0 mm	35 ne 70
10.0 mm	10 ne 40
5.0 mm	0 ne 5

Inertet e trasha per kategorine D te betonit duhet te jene tulla te thyera te prodhuara prej tullave te cilesise se pare ose grumbulli i tyre, ose nga tulla te mbipjekura. Nuk do te thyhen per perdorim per inerte te imta as tullat e papjekura apo grumbulli i tyre dhe as ato qe jane bere porose gjate procesit te pjekjes. Agregati me tulla te thyera nuk duhet te permbaje gjethe, kashte dhe, rere ose materiale te tjera te huaja dhe ose

mbeturina te tjera. Inertet prej tullave te thyera duhet te jene te nje diametri 25-40 mm dhe nuk duhet te permbajne asgje qe te kaloje nepermjet sites 2.36 mm.

Raportet e inerteve te trasha dhe te imta

Raporti me i pershtatshem i volumit te inerteve te trasha ne volumen e inerteve te imta duhet te vendoset nga prova e ngjeshjes se kubikeve te betonit, por Mbikqyresi i Punimeve mund te urdheroje qe keto raporte te ndryshojne lehtesisht sipas klasifikimit te inerteve ose sipas peshes ne se do te jete e nevojshme, ne menyre qe te prodhohen klasifikimet e duhura per perzjerjet e inerteve te trasha dhe te holla. Sipermarresi duhet te beje disa prova ne kubiket e marre si kampione dhe te shenoje inertet dhe fraksionimin e tyre, perzjerjen e betonit ne fillim te punes dhe kur ka ndonje ndryshim ne inertet e imeta apo te trasha ose ne burimin e tyre te furnizimit. Keta kubike duhet te testohen ne laborator ne kushte te njejta, pervec rasteve te ndryshimeve te vogla ne raportet perkatese te inerteve te imta dhe te trasha (lart apo poshte) nga raporti me i mire i arritur nga analizat e sites. Kubiket duhet te testohen nga 7 deri 28 dite.

Nga rezultatet e ketyre provave (testeve) Mbikqyresi i Punimeve mund te vendose per raportet e trashesise se inerteve te imta qe duhet te perdoren per cdo perzjerje te mevoneshme gjate zhvillimit te punes ose deri sa te kete ndonje ndryshim ne inerte.

Shperndarja

Ne kantier nuk do te sillen inerte per tu perdorur derisa Mbikqyresi i Punimeve te kete aprovuar inertet per tu perdorur dhe masat per larjen, etj. Me tej nga Sipermarresi do te merren kampione ne cdo 75m³ nen mbikqyrjen e Mbikqyresit te Punimeve, per cdo tip inertit te shperndare ne kantier (terren) dhe te dorezuar perfaqesuesit te Mbikqyresit te Punimeve per provat e kontrolleve te zakonshme. Kosto e te gjitha testeve do te mbulohet nga Sipermarresi.

Ruajtja e materialit te betonit

Çimento dhe inertet duhet te mbrohen ne cdo kohe nga demtuesit dhe ndotjet. Sipermarresi duhet te siguroje nje kontenier apo ndertese per ruajtjen e cimentos ne shesh. Ndertesa ose kontenieri duhet te jete e thate dhe me ventilim te pershtatshem. Ne se do te perdoret me shume se nje lloj cimentoje ne punime, kontenieri apo ndertesa duhet te jete e ndare ne nendarje te pershtatshme sipas kerkesave te Mbikqyresit te Punimeve si dhe duhet ushtruar kujdes i madh qe tipe te ndryshme cimentoje te mos jene ne kontakt me njera tjetren. Thaset e cimentos nuk duhet te lihen direkt mbi dysheme, por mbi shtresa druri apo pjese te ngritur trotuari per te lejuar keshtu qarkullimin efektiv te ajrit rreth e qark thaseve. Çimentoja nuk duhet te

mbahet ne nje magazine te perkohshme, pervec rasteve kur eshte e nevojshme per organizimin efektiv te perzjerjes dhe vetem kur eshte marre aprovimi i meparshem i Mbikqyresit te Punimeve. Agregati duhet te ruhen ne kantier ne hambare ose platforma betoni te padeptueshme te pergatitura posacerisht, ne menyre qe fraksione te ndryshme inertesh te mbahen te ndara per gjithë kohen ne menyre qe perzierja e tyre te ulet ne minimum. Sipermarresit mund t'i kerkohet te kryeje ne kantier procese shtese dhe/ose larje efektive te inerteve atehere kur sipas Mbikqyresit te Punimeve ky veprim eshte i nevojshem per te siguruar qe te gjitha inertet plotesojne kerkesat e specifikimeve ne kohen kur materialet e betonit jane perzjere. Mbikqyresi i Punimeve do te aprovoje metodat e perdorura per pergatitjen dhe larjen e inerteve.

Uji per cemento

Uji i perdorur per beton duhet te jete i paster, i fresket dhe pa balte, papasteri organike vegjetale dhe pa kripera dhe substanca te tjera qe nderhyjne ose demtojne forcen apo durueshmerine e betonit. Uji duhet te sigurohet mundesisht nga furnizime publike. dhe mund te merret nga burime te tjera vetem nese aprovohet nga Mbikqyresi i Punimeve. Nuk duhet te perdoret asnjehere uje nga germimet, kullimet siperfaqesore apo kanalet e vaditjes. Vetem uje i aprovuar nga ana cilesore duhet te perdoret per larjen e pastrimin e armaturave, kujdesin e betonit si dhe per qellime te ngjashme.

05. Kërkesat për përzjerjen e betonit

- Fortesia
- Klasa e betonit

Fortesia

Klasifikimet i referohen raporteve te cementos, inertve te imta dhe inerteve te trasha. Kerkesat per perzjerjen e betonit duhet te konsistojne ne ndarjen propocionale dhe perzjerjen per fortesite e meposhtme kur behen testet e kubikeve;

Klasa e betonit	Fortesia ne shtypje ne N/mm2 (NEWTON/mm2) 7 dite 28 dite
Klasa A&A (M100) (s)1:1,5: 3	17.00 25.50
Klasa B&B (M200) (s)1:2:4	14.00 21.00

Klasa C&C (M250) (s)1:3:6	6.50 10.00
Klasa D&D (M300) (s)1:6:12	Me pelqimin e Menaxherit te Projektit

Shenim. (s) = Çimento sulfate e rezistueshme.

Raporti uje-cimento

Raporti uje-cimento eshte raport i peshes se cimentos ne te. Permbajtja e ujit duhet te jete efikase per te prodhuar nje perzjerje te punueshme te fortesise se specifikuar, por permbajtja totale e ujit duhet te percaktohet nga tabela e meposhtme:

Klasa e betonit	Max. i ujit te lire/raporti cimento
Klasa A&A (M100) (s)1:1,5: 3	0.5
Klasa B&B (M200) (s)1:2:4	0.6
Klasa C&C (M250) (s)1:3:6	0.65
Klasa D&D (M300) (s)1:6:12	Me pelqimin e Menaxherit te Projektit

Shenim. (s) = Çimento sulfate e rezistueshme.

Qendrueshmeria

Raportet e perberesve duhet te jene te ndryshem per te siguruar qendrueshmerine e deshiruar te betonit kur provohet (testohet), ne pershtatje me kerkesat e meposhtme ose sipas urdherave te Mbikqyresit te Punimeve.

Perdorimet e betonit	Min&Max (mm)
Seksionet normale te perforcuara te ngjeshura me vibrime, ngjeshja me dore e mases se betonit	25 ne 75
Seksione prej betonarmeje te renda	50 ne 100 te

ngjeshura me vibracion, beton i ngjeshur
me dore ne pllaka te perforcuara normalisht,
trare, kollona dhe mure.

Ne te gjitha rastet, raportet e agregatit ne beton duhet te jene te tilla qe te prodhohen perzjerje te cilat do futen neper qoshe edhe cepa te formave si dhe perreth perforcimit pa lejuar ndarjen e materialeve.

06. Matja e materialeve

Inertet e imeta dhe te trasha do te peshohen ose te maten me kujdes ne pershtatje me kerkesat e Manaxheri te Projektit. Ato nuk do te maten ne asnje rast me lopata apo karroca dore. Cemento do te matet me thase 50 kg dhe masa e perzjerjes do te jete e tille qe grumbulli i materialeve te pershtatet per nje ose me shume thase.

07. Metodat e përzjerjes

Betoni duhet te perzjehet ne perzjeresa mekanike te miratuar qe me pare. Perzjersi, hinka dhe pjesa perpunuese e tij duhet te jene te mbrojtura nga shiu dhe era. Inertet dhe cemento duhet te perzjehen se bashku para se te shtohet uje derisa persjerja te fitoje ngjyren dhe fortesine e duhur. Duhet te largohen papastertirat dhe substancat e tjera te padeshirueshme. Uji nuk duhet te shtohet nga zorra apo rezervuare ne menyre te pakujdesshme. i gjithe betoni duhet te perzihet uniformisht ne fabrika moderne perzjerjeje per prodhimin maximal te betonit te nevojshem per plotesimin e punes brenda kohes se percaktuar pa zvogeluar kohen e nevojshme per perzjerje. Betoni duhet te perzjehet ne perzjeresa betoni per kohezgjatjen e kerkuar per shperndarjen uniforme te perberesve per te prodhuar nje mase homogjene me ngjyre dhe fortesi por jo me pak se 1- 1/2 minute. Perzjersi duhet te perdoret nga punetore te specializuar qe kane eksperience te meparshme ne drejtimin e perdorimin e pezjeresit te betonit. Me mbarimin e kohes se perzjerjes, perzjersi dhe te gjitha mjetet e perdorura do te pastrohen mire perpara se betoni i mbetur ne to te kete kohe te forcohet. Ne asnje menyre nuk duhet qe betoni te perzjehet me dore pa miratimin e Mbikqyresit te Punimeve, miratim ky qe do te jepet vetem per sasi te vogla ne kushte te vecanta.

08. Provat e fortësisë gjatë punës

Sipermarresi duhet te siguroje per qellimet e provave nje set 3 kubikesh per cdo strukture betoni, perfshire derdhje betoni nga 1-15 m³. Per derdhje betoni me shume se 15 m³, Sipermarresi duhet te siguroje te

pakten nje set shtese 3 kubikesh per cdo 30 m³ shtese. Ne se mesatarja e proves se fortesise se kampionit per cdo porcion te punes bie poshte minimumit te lejueshem te fortesise se specifikuar, Mbikqyresi i Punimeve do te udhezaje nje ndryshim ne raportet ose permbajtjen e ujit ne beton, ose te dyja, ne menyre qe Punedhenesi te mos kete shtese kostoje. Sipermarresi duhet te percaktoje te gjitha kampionet qe kane te bejne me raportet e betonimit prej nga ku jane marre. Nese rezultatet e testeve te fortesise mbas kontrollit te specimentit tregojne se betoni i perftuar nuk i ploteson kerkesat e specifikuara ose kur ka prova te tjera qe tregojne se cilesia e betonit eshte nen nivelin e kerkesave te specifiuara, betoni ne vendin, qe perfaqeson kampioni do te refuzohet nga Mbikqyresi i Punimeve dhe Sipermarresi do ta levize dhe ta rivendose masen e kthyer te betonit mbrapsh me shpenzimet e veta. Sipermarresi do te mbuloje shpenzimet e te gjitha provave qe do te behen ne nje laborator qe eshte aprovuar Punedhenesit.

09. Transportimi i betonit

Betoni duhet te levizet nga vendi i pergatitjes ne vendin e vendosjes perfundimtare sa me shpejt ne menyre qe te pengohet ndarja ose humbja e ndonje perberesi.

Kur te jete e mundshme, betoni do te derdhet nga perzjeresi direkt ne nje paisje qe do te beje transportimin ne destinacionin perfundimtar dhe betoni do te shkarkohet ne menyre aq te mbledhur sa te jete e mundur ne vendin perfundimtar per te shmangur shperndarjen ose derdhjen e tij.

Ne se Sipermarresi propozon te perdore pompa per transportimin dhe vendosjen e betonit, ai duhet te paraqese detaje te plota per paisjet dhe tekniken e perdorimit qe ai propozon per te perdorur per tu miratuar tek Mbikqyresi i Punimeve.

Ne rastet kur betoni transportohet me rreshqitje apo me pompa, kantieri qe do te perdoret, duhet te projektohet per te siguruar rrjedhjen e vashdueshme dhe te panderprere ne rrepre apo gryke (hinke). Fundi i pjerresise ose i pompes se shperndarjes duhet te jete i mbushur me uje para dhe pas cdo periudhe pune dhe duhet te mbahet paster. Uji i perdorur per kete qellim, duhet te largohet (derdhet) nga cdo ambjent pune i perhershem.

10. Hedhja dhe ngjeshja e betonit

Sipermarresi duhet te kete aprovimin e Mbikqyresit te Punimeve per masat e propozuara perpara se te filloje betonimin.

Te gjitha vendet e hedhjes dhe te ngjeshjes se betonit, duhet te mbahen ne mbikqyrje te vazhdueshme nga pjesetaret perkates te ekipit te Sipermarresit. Sipermarresi duhet te ndjeke nga afer ngjeshjen e betonit, si nje pune me rendesi te madhe, objekt i te cilit do te jete prodhimi i nje betoni te papershushem nga uji me nje densitet dhe fortesi maximale.

Pasi të jete perzjere, betoni duhet të transportohet në vendin e tij të punës sa më shpejt që të jete e mundur, i ngjeshur mirë në vendin rreth perforcimit, i perzjere sic duhet me lopate me mjete të pershtatshme celiku për kallepe duke siguruar një sipërfaqe të mirë dhe beton të dendur, pa vrime, dhe i ngjeshur mirë për të sjelle ujë në sipërfaqe dhe për të ndaluar xhepat e ajrit. Armatura duhet të jete e hapur në mënyrë të tillë që të lejoje daljen e bulezave të ajrit, dhe betoni duhet të vibrohet me çdo kusht me mekanizma vibruese për ta bërë atë të dendur, aty ku është e nevojshme. Betoni duhet të hidhet sa është i fresket dhe para se të kete fituar qëndrueshmëri fillestare, dhe në çdo rast jo më vonë se 30 minuta pas perzjerjes. Metoda e transportimit të betonit nga perzjerësi në vendin e tij të punës duhet të aprovohet nga Mbikqyresit i Punimeve.

Nuk do të lejohet asnjë metode që nxit ndarjen apo vecimin e pjeseve të trasha dhe të holla, apo që lejojnë derdhjen e betonit lirisht nga një lartësi më e madhe se 1.5m. Kur hedhja e betonit ndërpritet, betoni nuk duhet në asnjë mënyrë të lejohet të formoje skaje apo ane, por duhet të ndalohet dhe të forcohet mirë në një ndalesë të ndertuar posacerisht dhe të formuar mirë për të krijuar një bashkim konstruktiv efikas, që është në përgjithësi, në qoshet e djathta drejt armatimit kryesor. Pozicioni dhe projekti i fugave të tilla, duhet të aprovohen nga Mbikqyresit i Punimeve. Menjëherë para se të hidhet betoni tjetër, sipërfaqet e të gjitha fugave duhet të kontrollohen, të pastrohen me furçe dhe të lahen me llaç të pastër. Është e këshillueshme që ashpersia e betonit të jete arritur kur ngjyra bëhet gri dhe të mos lihet derisa të forcohet.

Para se betoni të hidhet në ose kundërsht një germimi, ky germim duhet të jete i forcuar dhe pa ujë të rrjedhshëm apo të ndenjtur, vaj dhe lende të demshme. Balta e qullet dhe materialet e tjera dhe në rast germimi guresh, copesa dhe thërmija do të hiqen. Gropa duhet të jete e qullet por jo e lagur dhe duhet të ndërmerren masa paraprake për të parandaluar ujërat nënetokësore që të demtojnë betonin e pa hedhur ose të shkaktojnë levizjen e betonit.

Aty ku është e nevojshme apo e kërkuar nga Mbikqyresit i Punimeve, betoni duhet të vibrohet gjatë hedhjes me vibratore të brendshme, të afta për të prodhuar vibrime jo më pak se 5000 cikle për minutë. Sipërmarresi duhet të tregojë kujdes për të shmangur kontaktin midis vibratorëve dhe perforcimit, dhe të evitojë vecimin e inerteve nga vibrimi i tepert. Vibratorët duhet të vendosen vertikalisht në beton 500 mm larg dhe të terhiqen gradualisht kur fluckat e ajrit nuk dalin më në sipërfaqe. Nqs, në vazhdim, shtypja është aplikuar jashtë armatures, duhet të kihet kujdes i madh që të shmangët demtimi i betonarmesë.

Kur betoni vendoset në ndalesa horizontale ose të pjerreta të kalimit të ujit, kjo e fundit duhet të zhvendoset duke i lene vendin betonit që duhet të ngjeshet në një nivel pak më të lartë se fundi i ndalesës së ujit para se të leshohet uji për të siguruar ngjeshje të plote të betonit rreth ndalesës së ujit.

11. Betonim në kohë të nxehtë

Sipërmarresi duhet të tregojë kujdes gjatë motit të nxehtë për të parandaluar carjen apo plasaritjen e

betonit. Aty ku eshte e realizueshme, Sipermarresi duhet te marre masa qe betoni te hidhet ne mengjes ose naten vone.

Sipermarresi duhet te kete kujdes te veçante per kerkesat e specifiuara ketu per kujdesin.

Kallepet duhet te mbulohen nga ekspozimi direkt ne diell si para vendosjes se betonit, ashtu edhe gjate hedhjes dhe vendosjes. Sipermarresi duhet te marre masa te pershtatshme per te siguruar qe armimi dhe hedhja e mases per tu betonuar eshte mbajtur ne temperaturat me te uleta te zbatueshme.

12. Kujdesi për betonin

Vetem neqoftese eshte percaktuar apo urdheruar ndryshe nga Mbikqyesi i Punimeve, te gjitha betonet do te ndiqen me kujdes si me poshte:

1. Siperfaqe betoni horizontale: do te mbahet e laget vashdimisht per te pakten 7 dite pas hedhjes. Ato do te mbulohen me materiale uje mbajtes si thase kerpi, pelhure, rere e paster ose rrogos ose metoda te tjerra te miratuara nga Mbikqyesi i Punimeve.
2. Siperfaqe vertikale: do te kujdesen fillimisht duke lene armaturat ne vend pa levizur, duke varur pelhure ose thase kerpi mbi siperfaqen e perfunduar dhe duke e mbajtur vazhdimisht te laget ose duke e mbuluar me plasmas.

13. Forcimi i betonit

Në sipërfaqet natyrore:

Vrimat për pemë duhet të jenë së paku 1500 mm katrore nga 1000 mm të thella;

Në sipërfaqet artificiale:

Pemët duhet të mbillen brenda rasteve mbrojtëse të pemëve, siç tregohet nga vizatimet në vrimat e tokës së përgatitur për pemët me të paktën 2000 mm katrorë me thellësi 1500 mm;

Brenda vrimave të përgatitura të tokës, vrimat për pemë duhet të jenë së paku 1500 mm katrore me thellësi 1000 mm

Vrimat për bimët duhet të rimbushen me sipërfaqe të përzgjedhur dhe të miratuar tërësisht të përzier me plehun organik ose përzierje plehrash (një lopatë e shtuar plotësisht në çdo vrimë bimësh) dhe, në varësi të raporteve të provës së tokës, sasinë dhe llojin e plehrave të kërkuar.

Vrimat duhet të ujiten plotësisht para se të mbillen bimët.

b. MIRËBAJTJA

Gjatë periudhës së mirëmbajtjes, e cila do të jetë dymbëdhjetë muaj pas përfundimit të mbjelljes aktuale të pemëve dhe shkurreve, ose nga data e përfundimit, cilado qoftë më vonë, Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për ujitje të pemëve dhe shkurreve dhe mbajtjen e bimëve të pastër nga barërat e këqija dhe dëmtuesit.

Çdo pemë ose shkurre, e cila nuk është e shëndetshme ose që tregon rritje të pakënaqshme, do të zëvendësohet nga Kontraktuesi me shpenzim nga vetja, brenda një muaji pasi të jetë njoftuar me shkrim nga Mbikëqyrësi. Nëse numri i konsiderueshëm ndikohet kaq shumë, periudha e mirëmbajtjes për atë zonë duhet të zgjasë për një vit nga data e zëvendësimit, nëse data e zëvendësimit ndodh pas datës së përfundimit.

04. Peme Qershie

Bigaro Burlat



Karakteristika:

Zona : Evropa Jugperendimore

Lloji : Gjethore

Gjetherenes / jogjetherenes : Gjetherenese

Ritmi i rritjes: e shpejte

Madhesia e pemes : 5-10m

Forma e kurores: kurorë e rrumbullakët, e çrregullt, e errët, e dendur

Karakteristika identifikuese:

Gjethet: e gjelbërt e errët, e zgjatur, të dhëmbëzuara, 7-14 cm

Lulet: në ngjyrë të bardhe, të gjatë 2-5 cm, pranvere, aromatike

Fruti: Frut sferik, 1-2cm në diametër në ngjyrë lejla të errët, fruta të ngrëshëm

Lëvorja/trungu: gri-kafe

Jetegjatesia:100-150 vjet

Habitati natyror :

Dheu: rërë, argjile

Lagështia e dheut: e thatë ose e lagësht

Preferenca e dritës: diell të plotë

Shtrim rruge: nuk toleron shtrime

Tolerante ndaj: thatësirave, erërave, acarit

Mirembajtja :

Mirëmbajtje e ulët.

Durone nero di Vignolo



Karakteristika:

Zona : Evropa Juglindore

Lloji : Gjethore

Gjetherenes / jogjetherenes : Gjetherenese

Ritmi i rritjes: e shpejte

Madhesia e pemes : 6 - 8 m

Forma e kurores: kurorë e rumbullakët, e çregullt, e errët, e dendur

Karakteristika identifikuese:

Gjethet: e gjelbërt, e zgjatur, të dhëmbëzuara, 7-14 cm

Lulet: në ngjyrë të bardhe, të gjatë 2-5 cm, pranvere, aromatike

Fruti: Frut sferik, 1-2cm ne diameter ne ngjyre lejla te erret, fruta të ngrëshëm

Lëvorja/trungu: gri-kafe

Jetegjatesia:100-150 vjet

Habitati natyror :

Dheu: rërë, argjile

Lagështia e dheut: e thatë ose e lagësht

Preferenca e dritës: diell të plotë

Shtrim rruge: nuk toleron shtrime

Tolerante ndaj: thatësirave, erërave, acarit

Prunus cerasus



Karakteristika:

Zona : Evropa Juglindore

Lloji : Gjethore

Gjetherenes / jogjetherenes : Gjetherenese

Ritmi i rritjes: e shpejte

Madhesia e pemes : 4-10 m

Forma e kurores: kurorë e rrumbullakët, e çrregullt,e dendur

Karakteristika identifikuese:

Gjethet: e gjelbërt, e zgjatur, të dhëmbëzuara, 5-8cm

Lulet: në ngjyrë të bardhe, të gjatë 2-5 cm, pranvere, aromatike

Fruti: Frut sferik, 1-2cm ne diameter ne ngjyre te kuqe te erret, fruta të ngrënshëm

Lëvorja/trungu: gri-kafe

Jetegjatesia:20-60 vjet



Castanea Sativa

Karakteristika:

Zona : Evropa Juglindore

Lloji : Gjethore

Gjetherenes / jogjetherenes : Jo gjetherenese

Ritmi i rritjes: mesatare

Madhesia e pemes : 20 - 30 m

Diametri i trungut : 200 cm

Forma e kurores: kurorë e rrumbullakët, e çrregullt, e errët, e dendur

Karakteristika identifikuese:

Gjethet: e gjelbërt e errët, e zgjatur, të dhëmbëzuara, 10 - 25 cm

Lulet: në ngjyrë krem, të gjatë 8-13 cm, Qershor / Korrik, aromatike

Fruti: lëvore me aromë me 2 - 3 arra (gështenja), fruta të ngrënshëm

Lëvorja/trungu: gri-kafe, më vonë me 'kanale' të thella gjatësore

Jetegjatesia: 700 vjet

Habitati natyror :

Dheu: rërë, argjile

Lagështia e dheut: e thatë ose e lagësht

Preferenca e dritës: diell të plotë

Shtrim rruge: nuk toleron shtrime

Tolerante ndaj: thatësirave, erërave, acarit

Mirembajtja :

Mirëmbajtje e ulët.



Karakteristika:

Zona : Evropa, Azia perëndimore dhe Afrika e Veriut

Lloji : Gjethore

Gjetherenes / jogjetherenes : Gjetherenese

Ritmi i rritjes: i shpejte

Madhesia e pemes : 15 - 25 m

Diametri i trungut : 100 cm

Forma e kurores : kurorë ovale, e errët, e dendur,
rritje kapricioze

Acer Campestre (Field Mapple)

Karakteristika identifikuese:

Gjethet: me 3-5 lobe, jeshile e erret, 6-10 (12) cm

Lulet: të vogla, verdhë-jeshile, Maj

Fruti: arrë me krahë me një farë të vetme, të çiftuar gjithmonë

Lëvorja/trungu: lëvore gri me çarje të dukshme

Jetegjatesia: 250 - 350 vjet

Habitati natyror :

Dheu: çdo tokë, përveç tokës së thatë jopjellore me rërë

Lageshtia e dheut : e lagësht, i reziston përmytjeve të shkurtra

Preferenca e dritës : diell të plotë / hije të pjesshme

Shtrim rruge : toleron shtrime të pjesshme

Tolerante ndaj : erërave, acarit

Mirembajtja :

Ka nevojë për krasitje, por vetëm në periudhën nga fundi i vjeshtës deri në mes dimër.

10. PUNIME TAVANI DHE SUVATIME

01. Suvatim i jashtëm

Stukim dhe sistemim i sipërfaqeve ku është e nevojshme, për suvatime për nivelimet e parregullive, me anë të mbushjes me llaç bastard me më shumë shtresa dhe copa tullash n.q.s është e nevojshme, edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin.

Përpara se të hidhet sprucimi duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë.

Sprucim i mureve dhe tavaneve për muraturë të pastruar me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me dozim për m²: rërë e larë 0,005 m³; llaç bastard 0.03 m³; çimento 400, 7.7 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shiritit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

02. Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25

Suva në ambjentet e brendshme ka vetëm në muret ndares mes apartamenteve. Ky suvatim përdoret në anën e brendshme të murit që ndertohet i pari. Ky suvatim do të bëhet deri në dorën e dytë të mbushjes dhe do të rrafshohet vetëm me mastar e malle, kjo sepse nuk është i dukshëm dhe shërben vetëm për rritur performancën e zë izolimit.



11. PUNIME BOJATISJE

01. Lyerje muri dhe tavani me boje hidromat 2 duar, importi e cilesise se pare, e bardhe

Aplikimi

Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës hidromat të lëngët e cila është e paketuar në kuti 5 – 15 litërshe. Lëngu I bojës hollohet me ujë në masën 20-30 %. Kësaj përzierje I hidhet pigmenti deri sa të merret ngjyra e dëshiruar dhe e aprovuar nga Supervizori I punimeve dhe pastaj bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar.

Norma e përdorimit është 1 litër bojë hidromat I holluar duhet të përdoret për 2.7 – 3 m2 sipërfaqe. Kjo normë varet nga ashpërsia e sipërfaqes dhe lloji I bojës së mëparshme. Në ndërtime të reja para lyerjes duhet të bëhet pastrimi I sipërfaqes që do të lyhet nga pluhurat dhe të shikohen dëmtimet e vogla të saj, të bëhet mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të stukimit me material sintetik dhe bërja gati për lyerje.

Para lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse. Në fillim të procesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me gëlqere të holluar (Astari). Në fillim bëhet përgatitja e astarit duke përzier 1 kg gëlqere me 1 litër ujë. Me përzierjen epërgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë. Norma e përdorimit është 1 litër gëlqere e holluar duhet të përdoret për 2 m2 sipërfaqe.

Më pas vazhdohet me lyerjen me bojë si më poshtë:

-Bëhet përgatitja e përzierjes së bojës hidromat të lëngshëm me ujë. Lëngu I bojës hollohet me ujë në masën 20 – 30%. Kësaj përzierje I hidhet pigment derisa të merret ngjyra e dëshiruar.

- Bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit është 1 litër bojë hidromat I holluar në 2.7

– 3 m2 sipërfaqe (në varësi të ashpërsisë së sipërfaqes së lyer).

02. Lyerje me bojë hidroplastike i sipërfaqeve të jashtme, me ngjyre te bardhe.

Norma e përdorimit është 1 litër bojë plastike e holluar duhet të përdoret për 4-5 m2 sipërfaqe.

Kjo normë varet ashpërsia e sipërfaqes së lyer.

Para lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen. (dyer, dritare etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

Në fillim të procesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me vinovil të holluar (Astar

plastik). Në fillim bëhet përgatitja e astarit duke bërë përzierjen e 1 kg vinovil të holluar me 3 litër ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë.

Norma e përdorimit është 1 litër vinovil i holluar që duhet të përdoret për 20m² sipërfaqe.

Më pas vazhdohet me lyerjen me bojë akrelidik. Kjo bojë ndryshon nga boja plastike sepse ka në përbërjen e saj vajra të ndryshme, të cilat e bëjnë bojën rezistente ndaj rrezeve të diellit, ndaj lagështirës së shirave, etj.

Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës akrelidik me ujë. Lëngu I bojës hollohet me ujë në masën 20-30 %.

Kësaj përzierje I hidhet pigmenti deri sa të merret ngjyra e dëshiruar. Pastaj, bëhet lyerja e sipërfaqes.

Lyerja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit është 1 litër bojë akrelidik I holluar në 4-5 m² sipërfaqe (në varësi të ashpërsisë së sipërfaqes së lyer).

Personeli, që do të kryejë lyerjen duhet të jetë me eksperiencë në këtë fushë dhe duhet të zbatojë të gjitha kushtet teknike të lyerjes të KTZ dhe STASH.

12. PUNIME DYER DRITARE VETRARE

01. Heqje e dritareve dhe dyerve ekzistuese

Fillimisht duhet bere çmontimi i dyerve/dritareve/grilave ekzistuese. Pas çmontimit behet grumbullimi i tyre dhe transporti ne largimin e tyre prej sheshit te ndertimit ne vendin e aprovuar.

02. Dritare/ informacion i pergjithshem

Dritaret janë pjesë e rëndësishme arkitektonike dhe funksionale e ndërteses. Ato sigurojnë ndriçimin për pjesët e sipërfaqes së brendshme të tyre. Madhësia (kupto dimensionet) e tyre variojnë, varet nga kompozimi arkitektonik, nga madhësia e sipërfaqes së brendshme dhe kërkesat e tjera të projektuesit. Dritaret duhet të jenë në kuotë 80-90 cm mbi nivelin e dyshemesë, kjo varet dhe nga kërkesat e rojektuesit. Dritaret mund të jenë të prodhuara me dru, alumin ose PVC. Pjesët kryesore të dritareve janë: Kasa e dritares që fiksohet në mur me elemente prej hekuri përpara suvatimit. Korniza e dritares do të vidhohet me kasën e saj mbas suvatimit dhe bojatisjes. Në bazë të vizatimit të dritares së treguar në vizatimin teknik, korniza do të pajiset në kasë me mentesha dhe bllokues të tipeve të ndryshme të instaluara në te. Kanate me xhama të hapshëm, të pajisur me mentesha, doreza të fiksuara dhe me ngjitës transparent silikoni, si he me kanata fikse.

03. F.V Dritare druri dopio xham binari

Dritare prej druri, të trajtuara me mbulese mbrojtëse të drunjtë do të përbëhen nga:

- një kasë druri që fiksohet në mur me anë të kunjave prej çeliku përpara suvatimit (gjerësia e kornizës është 4 cm kurse madhësia sipas kasës së dritares)
- një kornizë druri (seksion 7x4cm) që do të vidhohet te kasa e drurit të dhënë më sipër mbas suvatimit dhe bojatisjes të mureve. Për dritaret e dhëna në vizatimet teknike, korniza do të jetë me mentesha dhe bllokues të ankoruar në të për, dritare me kanate, dritare me kornizë, dritare për papafingo, dritare për ndriçim.
- kanate me dopio xham te mbushur me gaz, të hapshëm të pajisur me mentesha, doreza të fiksuar, panele xhami, (4 mm të trashë kur janë transparent, 6 mm kur janë të përforcuar me rrjet teli), të fiksuara me listela të plotë druri dhe ngjitës transparent silikoni, bllokues dritaresh me zinxhir ose kompas.
- shirita druri të plotë rreth perimetrit të brendshëm të dritares, kur realizohen me paturë nga brenda dhe jashtë në mungesë të paturës.
- Bojatisje me boje vaji ose llak



04. Dyer informacion i pergjithshem

Dyert janë një pjesë e rëndësishme e ndërtesave. Ato duhet të sigurojnë hyrjen në pjesët e brendshme të tyre. Në varësi të funksionit që kanë, dyert mund të jenë të brendshme ose të jashtme. Madhësite (kupto dimensionet) e tyre janë të ndryshme në varësi të kompozimit arkitektonik, kërkesave të projektit dhe të Investitorit. Dyert mund të jenë të prodhuara me dru, MDF, metalike, duralumini, plastike etj.

05. F.V Dyer druri

Furnizimi dhe instalimi i dyerve të brendshme me zemer tamburat dhe e veshur me materiali MDF dimensionet e të cilave jepen nga Porositësi, përbëhet nga:

- një kasë e bërë me dru tamburate (me trashësi 4 cm) e trajtuar me një mbulesë mbrojtëse të drunjtë, e dimensionuar sipas gjerësisë së murit, (duke marrë parasysh edhe rritjen prej mbulesës së murit) mbërthehet fuqishëm në mur me vida hekuri (çdo një metër) dhe me llaç çimento;
- Një kornizë e kasës së drurit që fiksohet, tek kasa e drurit e dhënë me sipër, pas suvatimit dhe lyerjes. Për dyert e dhëna në Vizatimet Teknike, korniza do të sigurohet me mentesha dhe ankerat e çelësit për të gjitha llojet e dyerve (Dyer me kasë, dyer pa kasë, me dritë në pjesën e sipërme, etj).
- Kanatet hapëse të dyerve të bëra me material MDF te nje cilesie te lartë dhe shirita ndërmjet druri të fortë të siguruar nga një bravë sigurie. Dy panelet e melamisë do të jenë 8 mm të trasha dhe të gjitha kufijtë e derës do të mbrohen nga një shirit druri i fortë. Trashësia totale e dyerve do të jetë 4,5 cm minimalisht dhe duhet te varen të paktën nga 3 mentesha me gjerësi minimale 16 cm.

- Një bravë metalike dhe tre kopje çelesash tip sekrete, doreza dyersh dhe doreze shtytëse të derës
- Mbyllja bëhet me shirita solide druri, të cilat vendosen përreth perimetrit të derës me anë të thumbave, pune që duhet të bëhet me cilësi, sipas të gjitha kërkesave të duhura teknike që duhen për kompletimin e kësaj pune.

Një shembull i zërave të mësipërm të propozuar duhet ti jepet supervizorit ne bashkepunim me arkitektin për aprovim paraprak



06. Dyer metalike per tualete, te bardha

- Dyer metalike- nje flete - metalike -doreze inoxi
- metoda e punimit: ne fabrike dhe objekt
- process: kunder kasa vendoset ne mure kasa

e deres-montimi i deres

- alumin

Profilat dhe panelet qe do te perdoren ne kete derye jane te prera mbi baze te te dhenave te parapercaktuara.

Pasi jan prere profilet dhe panelet behet kontrollet me nje katror metal. Te gjitha pjeset e struktures duhet

te jene pingul me njera tjetren. Ne hapsiren ku do je tej dera vendoset kunderkasa. Ne qofte se te gjitha dimensionet korrespondojne me vizatimin e deres kunderkasa eshte ngjitur plotesisht. Pas tyre vendoset kasa e deres e cila fiksohet mire dhe ne fund vendosim deren e cila do te kete vetem nje flete metalike e cila do te jete e perbere nga dy shtresa alumin i vazhduar dhe tamburato. Per kete dere eshte parashikuar qe edhe doreza e hapjes te jete prej inoksi. Ngjyra e perzgjedhur per kete dere do te jet ene bashkpunim me supervizorin dhe arkitektin.



08. F.V Dere e jashtme druri, me teksturen e materialit

Dyert e jashtme prej druri të fortë pishë, të trajtuara me mbulesë mbrojtëse të drunjtë

do të përbëhen nga:

- një kasë druri që fiksohet në mur me anë të ganxhave në formë thike prej çeliku përpara suvatimit. (Gjerësia e kasës është 3 cm kurse gjerësia e saj sipas madhësisë së murit).
- Kasa binare për dyer me dhëmbë kur dyer janë me dhëmbë, me përmasa 7 x 5 cm, që mbërthehet në mur me ganxha dhe me llaç çimentoje.
- Një kornizë e kasës së drurit që fiksohet tek kasa e drurit e dhënë me sipër pas suvatimit dhe lyerjes. Për dyert e dhëna në Vizatimet Teknike, korniza do të sigurohet me mentesha dhe ankerat e çelësit gjatë instalimit të pjesëve hapëse të derës.
- Kanatat hapëse me kornizë të drunjtë (tamburate) janë me përmasa minimalisht 10 x 3 cm, pjesë horizontale dhe vertikale me të njëjtin seksion dhe me një lartësi të fundit prej 25 cm e cila është e ndarë me panele prej druri të trajtuara me mbulesë mbrojtëse të drunjtë. Ajo është e kompletuar me mentesha (të paktën 3 për çdo pjesë hapëse).
- Dy mbulesa të drunjta me trashësi 2-3 mm (një nga çdo anë). Përmasat do të jenë në varësi të madhësisë së derës së përcaktuar në projekt. Mbulesat mund të jenë të rrafshta ose me gdhendje.
- Bravat e sigurisë së lartë së bashku me tre kopje çelësi tip sekret si dhe aksesoret e nevojshëm për instalimin e tyre. Bravat duhet të jenë tip Cilindrike, me shasi prej çeliku dhe kasë të fishekut të kyçjes në platë zinku, me cilindra tip kunjash. Bravat duhet të jenë të kyçshme në grup dhe të zbatueshme për çelësat sipas standartit.
- Menteshat (të paktën 3 për çdo pjesë hapëse) në tre pika ankorimi.
- Dorezat përkatëse, me butonin shtytës në dorezën e brendshme që kyç dorezën e jashtme. Dorezat duhet të jenë plotësisht të kthyeshme nga ana e djathtë ose e majte e derës. Doreza e jashtme duhet të jetë gjithmonë aktive, ndërsa kthimi i dorezës së brendshme ose çelësit të bëjë ç'kyçjen e fishekut.


09. Vetrat vertikale e hapshme, kasa te bardha

- Reflektimi: i ulet
- Ngjyra e laminatit: e celet

Xhamat vertikale të hapshem ndodhen përgjate fasadave të strukturave të reja. Ato mbyllin sipërfaqe vertikale dhe janë të hapshme. Xhami i jashtëm do të jetë i temperuar. Xhami i brendshëm do të përbehet nga 1 fletë xhami e temperuar. Xhami i përbërë nga dy shtresa xhami të mbajtura në vend nga një ndërlidhës, zakonisht prej polivinil butiral (PVB). Ndërlidhësi mban shtresat e qelqit të lidhura edhe kur goditet, në mënyrë që të mos copetohet. Xhami do të bllokojë 99% të rrezeve UV të diellit, duke krijuar mbrojtje ndaj këtyre rrezatimeve të rrezikshme. Reflekton me pak se 12% të rrezatimit duke minimizuar efektin pasqyre të reflektimit. Ndërsa transmeton 98% të dritës duke ndihmuar në krijimin e një ambienti të ndricuar. Xhami ka mbulesa optike në të dy anët e tij, të cilat ndihmojnë në përcmimin e ngjyrave natyrore dhe neutrale.

Xhami i dyerve do të jetë i njëjti me atë të vetratave.

Alumini i vetrates do të jetë sistem fasade, alumini i ftohtë për shkak të ambienteve. Alumini i vetrates do të përcaktohet pas bërjes së mostrave, me miratimin e mbikqyresit. Tipi i profilit do të propozohet nga kontraktori dhe do të zgjidhet nga mbikqyresi, në varesi të kompanive që e ofrojnë atë në vendin tonë. Për këtë shkak kontraktori do të jetë i detyruar të bëjë llogaritjet statike. Korniza e aluminit duhet të ketë transmetrueshmëri termike në vlerën $U \geq 1.4W/m^2K$.



13. PUNIME RESTAURUESE

01. Pastrim dhe lyerje parapete ekzistuese betoni

- Do të bëhet pastrimi me furçë teli i materialit të degraduar të betonit dhe suvasë.
- Do të bëhet pastrimi me furçë teli i hekurave të zbuluar dhe të korrodur dhe zmerilimi i sipërfaqes së

hekurit për eliminimin e ndryshkut.

- Përpara se të aplikohet betoni i ri duhet që të bëhet pastrim me ujë të bollshëm i zonave ku është bërë pastrim me furçë teli, çukitje e sipërfaqes për të mundësuar lidhjen e betonit të ri me betonin ekzistues.
- Investigim I madhësisë së zgavrave në spërfaqen e betonit, për të përcaktuar procesin pasardhës: stukim apo do të kenë nevojë për mbushje me beton të ri)
- Në rast se do të nevojitet, betoni i ri duhet të jetë i njëjtë me betonin ekzistues

02. Heqje dhe rivendosje e fugave te llacit ne xokolin e objektit

Meqe fugat ekzistuese jane te zbatuara ne menyre te jashtme ndaj gureve te fasades, krijojne figure estetike jo te pranueshme, dhe jane pejeserisht te demtuara, duhet qe ato te pastrohen dhe te ribehen. Pastrimi duhe te behet me matrapik te vegjel te cilet duhet te hyjne ne thellesi te fuges per te ber te mundur qe mbushja e re te qendorje pak brenda gurit. Pasi eshte ber dhe pastrimi me rere fillon mbushja e fugave te reja me llac bastar M25, duke psaur parasysh qe kjo fuge te mos arrije siperfaqene jashtme te gurit. Pjesa qe ben pis gurin duhet te hiqet me furca me dhemb metalike, ne menyre qe guret te mbeten gjithmone te paster.

03. Pastrimi i pllakave ekzistuese të fasadës

- mbushja e fugave me bojak
- mbyllja e vrimave të vogla
- pastrimi me presion

Pershkrimi

Pasi janë restauruar të gjitha pllakat, ato që lëvizin dhe ato që kishin rënë, bëhet mbushja e fugave të tyre me bojak. Gjithashtu mbushen edhe cepat ose vrimat në keto pllaka. Mbushja do të bëhet me bojak industrial me ngjyrë sa më të përafërt me atë të pllakave. Lihen të thahen për rreth dy javë dhe përgatitemi për pastrimin e tyre. Në bazën objektit, ndërmjet vendit ku mbështetet skelera dhe murit të tij, do të vendoset një mushama (veshje plastike) për të mbledhur rërën që do të bjerë poshtë gjatë pastrimit të pllakave.

Përpara se të fillojmë pastrimin e pllakave është e domosdoshme që të bëjmë një provë në një sipërfaqje për 1 m², për secilën nga metodat e mëposhtme:

- me ajër me presion dhe rërë

Nese metoda e demton xokolaturen atehere do te te provohet po ne 1m2 siperfaqe pastrimi me

- me ajër
- me ajër me presion dhe ujë

Me miratimin e mbikqyrësit të njëjës prej këtyre tre provave, fillon pastrimi i pllakave me drejtim nga lart-poshtë. Vijohet me këtë punë pa ndërprerje deri ku fasada takon me tokën. Nëse shihet e nevojshme nga mbikqyrësi kjo punë mund të përsëritet edhe një here që të marrim një pastrim sa më të mirë të fasadës, ku nuanca e përftuar të jetë sa më pranë fasadës së re që do të ndërtohet.



04. Shtrim i dysHEMEVE me pllake grez e bardhe, mat

Klasifikimi i pllakave bëhet sipas këtyre kriterëve:

- Mënyra e dhënies së formës të pllakës
- Marrja e ujit
- Dimensionet e pllakave
- Vetitë e sipërfaqes
- Veçoritë kimike
- Veçoritë fizike
- Siguria kundër ngricës
- Peshë/ngarkesa e sipërfaqes
- Koefficienti i rrëshqitjes

Pllakat duhen zgjedhur për secilin ambient, duke marrë parasysh nevojat dhe kriteret, që ato duhet t'i përmbushin. Kriteret dhe tabelat e lartpërmendura mund të ndihmojnë në zgjedhjen e tyre.

05. Shtrese me pllaka mermeri te bardhe, mat $t=3\text{cm}$, bazamake per shkallet

Bazamakët e shkalleve (shkeljet) do të jenë me shkrim me pllaka mermeri me përmasa $33 \times 120 \text{ cm}$ me $t=3\text{cm}$ ndersa bazamakët (ngjitjet) do të jenë me pllaka mermeri $14 \times 120\text{cm}$, $t=2\text{cm}$.

Mënyra e vendosjes.

Bazamakët vendosen nga poshte lart. Fillimisht me ane të dy tullave të ngjitura me allci vendoset ngjitja

t=2cm dhe mbushet me llac cemento ndermjet bazamakut dhe betonit te struktures se shkalles. Kjo shtrese zakonisht realizohet 2cm. Pas vendosjes ne vertikalitet fillon mbushja me llac cemento per bazamentin e bazamakut (shkelje). Trashesia e llacit te perdorur arrin deri ne 5cm. Eshte e rendesishme qe ngjitjet dhe shkeljet kudo ne te gjith shtrirjen e shkalles te jene ekzaktesisht te barabarta. Kjo per arsye te komoditetit te ngjitjes, por dhe parandalimit te aksidenteve.

14. PUNIME TE NDRYSHME


01. Kosh mbeturinash

- materiali : celik
- dimensionet : ϕ 50
- H 85
- menyra e punimit : saldim , fiksimit ne gure me beton
- Mundesia per te hapur kapakun per te zbrazur mbeturinat.
- (Ref. koshat e zakonshem te plehrave)

Fillimi i procesit te ndertimit te koshave per mbeturinat nis me marrjen dhe perzgjedhjen e lamave te cilat do te priten sipas dimensioneve .Pas zgjedhjes dhe prerjes se lamave ato do te kthehen me kalander per te marr harkimin e deshiruar dhe me pas do te saldohen.

Me perfundimin e ketij procesi do te behet lysterja me boje e koshave te mbeturinave , por ky proces do te kryhet vetem pas pastrimit me rere dhe galvanizimit. Me pas behet lysterja me boje puder me pjekje.

Ne fund do te behet fiksimi i ketij koshi me beton i cili do te qendroje poshte siperfaqes se rifinitures.



03. Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat diameter 100

Janë për shkarkimin e ujrave të çative dhe taracave, mqenese ulluket ekzistues jane ne gjendje jo të mirë ato do te çmontohen dhe të zëvendësohen me ullukë të rinj. Ulluket do te jene llamarine xingat , me trashesi 4mm, dhe diametër 10 cm.Në çdo ulluk duhet të mblidhen ujrat e një sipërfaqe çatie ose tarace jo më të madhe se 60 m². Ullukët duhet të vendosen në pjesën e jashtme të ndërtesës, me anë të qaforeve përkatëse prej llamarine xingat, të fiksuar çdo 2 m. Ujrat e taracës që do të kalojnë në tubat vertikale duhet të

mblidhen nëpërmjet një pjate llamarine xingat, i riveshur me guainë të vendosur në flakë, me trashësi 3 mm, të vendosur në mënyrë të tërthortë, ndërmjet muraturës dhe parapetit, me pjerrësi 1%, e cila lidhet me kasetën e shkarkimit sipas udhëzimeve në projekt.

Para se të fillohen punimet aty ku tregohet në plane apo udhëzohet nga Supervizori i objektit, Sipërmarrësi do të kontrolloj në objekt të gjitha zonat na ta cilat do ta realizohet ndërhyrja .Në prezencë të Supervizorit të punimeve mbahet një proces-verbal për sasinë e sipërfaqes ku do të realizohet ndërhyrja. Në ze përfshihet blerja e të gjitha materialeve të nevojshme, transporti i tyre, ngarkim shkarkimi, skleria dhe çdo punë që lidhet me të.

04. Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm

Ulluqet horizontale realizohen me pjerrësi prej 1% për largimin e ujrave. Ulluqet horizontale do te jene gjithashtu prej llamarine xingat, me trashësi jo më të vogël se 0,8 mm, i formuar nga pjesë të modeluara



me mbivendosje minimale 5 cm, të salduara në mënyrë të rregullt me kallaj, me bord të jashtëm 2 cm më të ulët se bordi i brendshëm, të kompletuara me pjesë speciale për grykën e hyrjes. Ulluku horizontal, i modeluar sipas udhëzimeve në projekt, duhet të jetë i lidhur me hallka të forta të vëna maksimumi në 70 cm.

Ulluket do të vendosen në çdo fund catie për mbledhjen e ujrave të shiut. Forma e tyre do të përcaktohet nga specifikimet teknike të arkitektures.

- Materili prej 99.9% llamarine xingat
- Ngjyra sipas kërkesës së arkitektures.

05. Mbulim oxhakesh

Mbulesa e oxhakeve do të realizohet me impluvet e llamarines. Ato do të shërbejnë për të mbyllur daljen e oxhaqeve mbi cati. Impluvet do të mundesojnë kalimin e ujit në drejtim nga pjerresia më e madhe në atë me të ultën duke larguar kështu ujën e shirave. Në këtë mënyrë uji nuk do të depertojë brenda oxhakut. Impluvet do të kapen me UPA në strukturën ekzistuese të oxhaqeve dhe do të izolojnë me silikon poliuretani.

06. Davançal me mermer të bardhë 3cm

Pragjet e dritareve janë dy llojesh: pragje të brendshme dhe të jashtme. Ato do të jenë mermer me trashësi 3cm dhe me pikë kullim uji, sipas vizatimit teknik ose udhëzimeve të supervizorit. Pragjet do të kenë kënde të mprehta dhe çdo detyrim tjetër për përfundimin e punës. Permasat do të maten në vend para vendosjes. Para se të fillohen punimet aty ku tregohet në plane apo udhëzohet nga Supervizori i objektit, Sipërmarrësi do të kontrollojë në objekt të gjitha zonat në të cilat do të realizohet vendosja e


pragjeve . Në prezencë të Supervizorit të punimeve mbahet një proces-verbal për sasinë e sipërfaqes e cila do realizohet ndërhyrja. Në zonat në të cilat do të vendosen pragjet duhet të jetë e pastruar nga papastërtitë dhe materiali i përdorur duhet të jetë i njëjtë me origjinalin.

07. Riparim catie


Çdo ndërhyrje në një çati duhet të fillojë me të kuptuarit e çatisë ekzistuese. Duhet kuptuar nëse lëvizja në strukturë mund të maskojë një të metë të qenësishme në konstrukcion. Nuk është gjithmonë e qartë nëse një defekt i catise ka rezultuar në rrëshqitje të tjegullave. Për këto arsye dhe për shkak se ai ose ajo do të njohë çdo detaj të veçantë kur ato ekspozohen, personi që bën punën duhet të kuptojë plotësisht se si funksionon catia. Fotografitë e marra pingul me pjerrësinë dhe duke përfshirë një shkallë dhe numrat e kursit do të tregojnë gjendjen aktuale. Duke manipuluar imazhin, është gjithashtu e mundur të përpunohet detaji original. Arsyeja për sondazhin është ndoshta se çatia ka nevojë për vëmendje, por është e rëndësishme t'i jepet gjeodezitet një shpjegim të qartë të asaj që kërkohet. Duke lënë mënjanë çështjet e instalimit të shtresave të poshtme ose izolimit dhe ajrosjes, pyetja kryesore është nëse çatia ishte e papërshkueshme nga moti siç ishte ndërtuar fillimisht dhe nëse i njëjti specifikim do të jetë i kënaqshëm për të ardhmen. Kjo do të kërkojë përvijë dhe gjykim nga ana e anketuesit dhe specifikuesit dhe ishte shumë më e lehtë për t'u përcaktuar përpara se kodet tona të praktikës BS/EN të fillonin të parashikonin një rritje në frekuencën dhe intensitetin e shiut të përmbytjes.

08. Mbulim catie me llamarine xingat te valezuar


Ne strukturat e reja te propozuara hapësirat e brendshme te cilat jane te perdorshme gjate gjithë vitit mbulesa do te realizohet me llamarine xingat te valezuar sipas detajeve te vizatuara.




Fletë metalike e valezuar me një seksion prej 1 mm me një gjatësi efektive prej 0.95m



- Llamarine
- Fletë metalike e valezuar
- Bulona për fiksimin fletes metalike
- Tra metalikë profil 5x5cm
- Trare druri 5x3cm
- Hidroizolim
- Panel OSB 1.5cm



- llamarine për veshjen e mbuleses dhe kullimin e ujrave
- fletë metalike e valezuar
- trare druri 5x3cm
- hidroizolim
- panel osb 1.5cm
- tra metalikë profil 5x5cm



- llamarine për veshjen e mbuleses dhe kullimin e ujrave
- fletë metalike e valezuar
- trare druri 5x3cm
- hidroizolim
- panel osb 1.5cm
- tra metalikë profil 5x5cm

Llamarina e valezuar xingat furnizohet ne seksione me permasa 1x6m. lartesia e vales eshte 5cm. Kjo llamarine perdoret per mbulesa te perhershme. Fiksohet me vida vetefiletuese ne strukturen metalike. Videt duhet te jene me rondele gome per te mos lejuar futjen e ujit.

Mbivendosjet ne bashkime duhet te jene te pakten 10cm ne gjatesi dhe nje vale ne gjeresi.

Duhet patur kujdes qe furnitori te siguroje qe materiali te jete i galvanizuar nga fabrika.

Pasi ngjitet nje pjese e tyre ne konstruksionin metalik dhe te drurit, fiksohen ne pjesen e poshte te vales me vida vetefiletuese, zakonisht me 3 vida ne gjeresi te panelit, dhe cdo 1m ne gjatesi, duke u kujdesur vidat e fundit te bashkoje dy llamarina te vendosura njera mbi tjetren.

Mbi to fiksohen panelet OSB per te siguruar hidroizolim.

08. Panel OSB per catine e strukturave te perkohshme (poshte llamarines xingat te valezuar)

Panelet OSB perdoren shpesh ne ndertim per aplikime te ndryshme, duke perfshire nencatine. Kur behet fjale per nencatine e strukturave te lehta, instalimi i paneleve OSB do te varet nga dizajni dhe kerkesat specifike te projektit.

Paraqitja dhe planifikimi:

Duhet te krijohet nje plan i detajuar, duke marrë parasysh nivelet e ndryshme. Orientimi i paneleve OSB duhet te merret parasysh per te siguruar mbështetjen dhe shtrirjen e duhur.

Menyra e aplikimit:

Filloni instalimin nga nje pikë referimi fikse, kjo ndihmon ne ruajtjen e konsistencës ne lartësinë e dyshemesë.

Orientimi i panelit:

Panelet OSB zakonisht instalohen me dimensionin e gjatë pingul me trarët ose mbështetëset e catise. Kjo siguron stabilitet dhe rezistence.

Nyje të shkallëzuara:

Shtrëngoni nyjet e paneleve ngjitur për të rritur integritetin e përgjithshëm strukturor të catise. Kjo ndihmon në shpërndarjen më të barabartë të ngarkesave nëpër cati.

Panelet e sigurimit:

Panelet OSB fiksohen në cati duke përdorur vida ose gozhdë. Mbërthyesit duhet të vendosen në intervale të caktuara përgjatë skajeve dhe fushës së paneleve, duke ndjekur rekomandimet e prodhuesit.

Adresimi i ndryshimeve të nivelit:

Për zona me nivele të ndryshme, mund të jetë e nevojshme të përdoren materiale shtesë, të tilla si shirita ose traversa, për të krijuar një sipërfaqe të niveluar përpara se të instaloni panelet OSB.

Shkallët:

Për shkallët, panelet OSB duhet të priten dhe të vendosen rreth strukturës së shkallëve. Është e rëndësishme të sigurohet një tranzicion i qetë midis dyshemesë dhe shkallëve.

Mbështetja:

Aty ku panelet OSB takohen me skajet e catise, duhet të sigurohet mbështetja e duhur. Bllokimi ose korniza shtesë mund të jetë e nevojshme për të ruajtur integritetin e catise.

09. Sipërfaqe prej xhami (vetratat) te jashtme te palevizshme

Vetrata- Furnizimi dhe vendosja e vetratave prej xhami siç përshkruhet në specifikimet teknike me dimensione të dhëna nga kontraktori, përbëhen nga material alumini profilet e të cilat janë sipas standarteve Europiane dhe janë profile të lyera përpara se të vendosen në objekt. Ngjyra e tyre do të jetë sipas kërkesës së investitorit.

Korniza fikse e vetratave do të ketë një dimension që do të përcaktohet nga vizatimet teknike. Ato kanë elemente që shërbejnë për vëndosjen dhe ankorimin e vetratave në strukturat e murit. Forma e profilit të vetratave është tubolare me qëllim që të mbajë gjithë aksesoret e saj. Profili i skeletit të vetratës do të jetë me dimensione jo më pak se 25 mm që profili kryesor që do të fiksohet në mur të jetë i zbuluar.

Profilet e kornizave të lëvizshme kanë një dimension thellësia 32 mm dhe lartësia 75 mm të sheshta ose me zgjedhje ornamentale. Të dyja korniza fikse ose të lëvizshme janë projektuar dhe janë bërë me dy profile alumini të cilat janë bashkuar me njëra tjetrën dhe kanë një fugë ajri që shërben si thyerje termike, ato janë të izoluar nga një material plastik 15 mm.

Fiksimi i vetratave me kontrotelajo solide do të bëhet me kujdes me fashetat e hekurit për tek muri me llaç (me tapa me filete). Vendosja (fiksimi I vetrates) duhet të ketë një distancë të preferueshme nga qoshja e kornizës jo më shumë sesa 150 mm dhe midis tyre jo më shumë se 800 mm. Skeleti i fiksuar i vetratës do të vidhohet me telajon pas përfundimit të suvatimit dhe bojatisjes. Kanate të hapshëm me xhama do të vendosen me mentesha në skeletin e vetratës dhe do të pajisen me bravë mbyllëse dhe dorezë. Ngjitja dhe mbushja midis kasave dhe përbërjes së ndërtesës do të kryhet duke përdorur materiale elastiko-plastike, mbas mbylljes së çdo të çarë me materiale izoluese. Midis brendësisë së kornizës suportuese të hekurit dhe kornizës së jashtme fikse të aluminit është e preferueshme të ruash një tolerancë instalimi prej 6mm, duke konsideruar një dalje të hapësira fiksuese prej rreth 2 mm. Toleranca dimensionale dhe trashësia do të jenë sipas standarteve Europiane.

Panelet e xhamit do të jenë të fiksuara në skeletin metalik me anë të listelave të aluminit në profilet metalike të vetratës dhe të shoqëruara me gomina. Të gjitha punet e lidhura me muraturën dhe të gjitha kërkesat e tjera për kompletimin e punës duhet të bëhen me cilësi.

10. Hapje dyersh ne vetratat e brendshme

Kur behen hapjet e dyerve ne vetratat e rendshme duhet marre parasysh vendosja e kasave te aluminit ne pjesen e nderprerjes se zhami sipas specifikimeve te vetrates se mesiperme.

Duhet patur kujdes per montimin e mentshave, nuk duhet te pengojne hapjen dhe levizjen e dyerve.

Menteshat jane 3, 2ne pjesen e sipërme dhe 1 ne pjesen e poshtme ne menyre qe te perballojne ngarkesat dhe momentet e deres pa probleme, dhe montohen ne kasat e aluminit.

Vec ketyre duhen patur kujdes ne vendosjen e dorezave te aluminit ne lartesine 90cm nga toka, dhe bravave te celesit.

Permasat e hapjeve dhe te dyerve jane sipas vizatimeve ne projekt, lartesia e deres jo me pak se 210cm.

11. Trarë druri për fiksimin e llamarinës së valëzuar në mbulesat e strukturave të përkohshme.

Niveli Standard i Lagështirës:

Për ndërtim, druri duhet të ketë një përmbajtje lagështie prej 12–15% për të shmangur tkurrjen dhe deformimin.

Dimensionet Nominale:

Madhësia Nominale: 30 mm x 50 mm.

Madhësia Aktuale: Mund të jetë pak më e vogël për shkak të planifikimit (p.sh., 27 mm x 47 mm), në varësi të procesit të përpunimit.

Sipërfaqja:

Sipërfaqe e ashper: E përshtatshme për aplikime të fshehura.

Sipërfaqe e lëmuar: Për përdorim të ekspozuar, më i lehtë për lyerje ose lyerje me ngjyrë.

Sipërfaqe e trajtuar: Konservuesit duhet të mbrojnë kundër kalbjes, insekteve dhe lagështisë.

Trajtimet:

Rezistenca ndaj Zjarrit: Te perdoren shtresa retardante ndaj zjarrit për siguri në ndërtim.

Rezistenca ndaj Ujit: Te aplikohet shtrese izoluese ose te zgjidhet dru i trajtuar me presion për aplikime të jashtme.

Distanca e Rekomanduar: 30-50 cm midis trarëve për llamarinat e lehta metalike, në varësi të trashësisë dhe ngarkesës së pritur.

Vetitë e Drurit:

Te perdoren lloje të qëndrueshme si pisha, bredhi ose kedri. Preferohet druri i trajtuar me presion për të

rezistuar ndaj lagështisë dhe kalbjes.

Fiksimi dhe Ngjitja:

Te sigurohen trarët në strukturën e çatisë me mbajtëse të galvanizuara, gozhda ose vida.

Fiksohen llamarinat e valëzuara duke përdorur vida të galvanizuara për çati me rondela gome për të parandaluar rrjedhjet.

Ventilimi: Te sigurohet një hapësirë ventilimi nën llamarinat e valëzuara për të reduktuar kondensimin dhe kalbjen e drurit.

Kufiri i Përkuljes:

Përkulja maksimale e lejuar: $Gjatësia \div 240$ (për çatitë me llamarina metalike).

Për një hapësirë prej 50 cm, përkulja maksimale = $50 \text{ cm} \div 240 = 2.08 \text{ mm}$.

Këshilla për Instalimin:

Shtrirja e Trarëve: Vendosni trarët pingul me pjerrësinë e çatisë për fiksime të lehtë të llamarinave metalike.

Përdorni nivel për t'u siguruar që janë të drejtë.



Pjerrësia: Sigurohet një pjerrësi çatie prej të paktën 5° – 15° për kullim të duhur të ujit.

Fiksuesit: Përdoren fiksues që nuk ndryshken (të galvanizuar ose prej çeliku inox).

Mbivendosja: Mbivendosen llamarinat e valëzuara me të paktën një valë dhe sigurohen fort te trarët.

12. Stol me tulla te plota, seksion 50x50cm

Sikurse muratura me tulla të plota, stoli do jete me permasat seksion 50x50xcm sipas projektit dhe Ilaç bastard m-25 sipas pikës 1 me përmbajtje për m³: tulla të plota 424 copë, Ilaç 0.19 m³, çimento 400 dhe ujë.



SPECIFIKIMET TEKNIKE

PROJEKTI NDERTIMOR (KONSTRUKSIONI)

Rrugët e Shijes: Mollaj, Boboshticë, Drenovë, Qatrom_Shtigjet

Objekti:

"Shkolla sheshi Qatrom".

KONSTRUKTOR:

ING. EDISON DRISHTI

TIRANE
TETOR 2024

SEKSION 1 SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

1.1 Specifikime të përgjithshme

1.1.1 Njësitë matëse

Në përgjithësi njësitë matëse kur lidhen me Kontratat janë njësi metrike në mm, cm, m, m², m³, Km, N (Njuton), Mg (1000 kg) dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si “. “.

1.1.2 Grafiku i punimeve

Kontraktuesi duhet t'i japë supervisorit një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet në ndërtim deri në mbarim të punës.

Informacioni që mban supervisorin duhet të përfshijë: vizatime që tregojnë rregullimin gjeneral të ambienteve të godinës dhe të ndonjë ndërtimi apo strukture tjetër të përkohshme, të cilat ai i propozon për përdorim; detaje të vendosjes konstruksionale dhe punëve të përkohshme; plane të tjera që ai propozon t'i adaptojë për ndërtim dhe përfundimin e të gjitha punëve, si dhe në vijim, detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe jo të kualifikuar si dhe supervizionin e punimeve.

Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar këto punime permanente është temë për t'u rregulluar dhe aprovuar nga supervisorin, dhe çmimi i kontratës duhet të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga supervisorin gjatë zbatimit të punimeve.

1.1.3 Punime të gabuara

Çdo punë, që nuk është në përputhje me këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit.

1.1.4 Tabelat njoftuese, etj.

Asnjë tabelë njoftuese nuk duhet vendosur, përveç:

Kontraktori do të ndërtojë dy tabela, që përmbajnë informacion të dhënë nga Supervisorin dhe vendosen në vendet e caktuara nga ai. Fjalët duhen shkruar në mënyrë të tillë, që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 50 m. Gjuha e shkruar duhet të jetë në anglisht dhe shqip.

1.2 Dorëzimet te Supervisorin

1.2.1 Autorizimet me shkrim

“Rregullat me shkrim ” do t'i referohen çdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga Supervisorin të dërguara kontraktuesit që përmbajnë instruksione, udhëzime ose orientime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë ekzekutimin e kësaj kontrate.

Fjalët e aprovuara, të drejtuara, të autorizuara, të kërkuara, të lejuara, të urdhëruara, të instruktuar, të emëruara, të konsideruara të nevojshme, urdhëresa ose jo (duke përfshirë emra, folje, mbiemra, dhe ndajfolje) të një rëndësie, do të kuptohet që aprovimet e shkruara, drejtimet, autorizimet, kërkesat, lejet, rregullat instruksionet, emërimet, urdhëresat e Supervisorit do të përdoren deri në daljen e një plani tjetër pune.

1.2.2 Dorëzimet tek supervisorin

Kontraktori duhet t'i dorëzojë Supervizorit për çdo punim shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Supervizori.

Kontraktori duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, materiale, certifikata testi, kurdo që të kërkohen nga Supervizori. Supervizori do të pranojë çdo dorëzim dhe nëse janë të përshtatshme do t'i përgjigjet kontraktorit në përputhje me çdo klauzolë përkatëse të kushteve të kontratës. Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Supervizorin dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Supervizorit për të bërë këto pranime.

Mostrat

Kontraktori duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve, aksesoreve dhe tema të tjera që mund të kërkohen me të drejtë nga Supervizori për inspektim.

Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Supervizorit.

Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe librezat e masave

Kontraktori do t'i përgatisë dhe dorëzojë Supervizorit tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Supervizori, si dhe librezat e masave për çdo volum pune.

SEKSION 2 PUNIME PRISHJEJE DHE PASTRIMI

- **Pastrimi i kantierit**

- Pastrimi i kantierit

Në fillim të kontratës, për sa kohë që ajo nuk ka ndryshuar, kontraktori duhet të heqë nga territori i punimeve të gjitha materialet organike vegjetare dhe ndërtuese, dhe të djegë të gjitha pirgjet e mbeturinave të tjera.

- Skarifikimi

Largime të mëdha me ekskavatorë dhe skarifikime, të kryera me dorë ose makinë nga terrene, nga çfarëdo lloj toke, qoftë edhe e ngurtë (terrene të ngurtë, rërë, zhavori, shkëmborë) duke përfshirë lëvizjen e rrënjëve, trungjeve, shkëmbinjve dhe materialeve me përmasa që nuk kalojnë 0,30 m³, duke përfshirë mbrojtjen e strukturave të nëndheshme si kanalizime uji, naftë ose gazi etj dhe duke përfshirë vendin e depozitimit të materialeve brenda në kantier ose largimin e tyre në rast nevojë.

- Heqja e pemëve dhe shkurreve më të larta se 1.5m

Në përgjithësi duhet patur parasysh, që gjatë punimeve të pastrimit të mos dëmtohen ato pemë të cilat nuk pengojnë në rehabilitimin ose në ndërtimin e objektit të ri. Në rastet kur heqja e tyre është e domosdoshme, duhet të merren masa mbrojtëse në mënyrë që gjatë rrëzimit të tyre të mos dëmtohen personat dhe objektet përreth. Për këtë, për pemët që janë të larta mbi 10 m, duhet që prerja e tyre të bëhet me pjesë nga 3 m. Pjesa që pritet, duhet të

lidhet me litar ose kavo dhe të tërhiqet nga ana ku sigurohet mbrojtja e personelit dhe e objekteve.

- Prishja e godinave, gardheve dhe strukturave

Kontraktori duhet të heqë me kujdes vetëm ato ndërtime, gardhe, ose struktura të tjera të drejtuara nga Supervizori. Komponentët duhen çmontuar, pastruar dhe ndarë në grumbuj. Komponentët të cilët sipas Supervizorit nuk janë të përshtatshëm për ripërdorim, duhen larguar, punë kjo që kryhet nga kontraktuesi. Materialet që janë të ripërdorshme do të mbeten në pronësi të investitorit dhe do të ruhen në vende të veçanta nga kontraktori, derisa të lëvizen prej tij deri në përfundim të kontratës.

Kontraktori, duhet të paguajë çdo dëmtim të bërë gjatë transportit të materialeve me vlerë, të rrethimeve dhe strukturave të tjera dhe nëse është e nevojshme duhet të paguajë kompensim.

- Mbrojtja e godinave, rrethimeve dhe strukturave.

Gjatë kryerjes të punimeve prishëse, kontraktuesi duhet të marrë masa që të mbrojnë godinat, gardhet, muret rrethues dhe strukturat që gjenden në afërsi të objektit, ku po kryhen këto punime prishëse.

Për këtë, duhen evituar mbingarkesat nga të gjitha anët e strukturave nga grumbuj dhe materiale. Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshtë, duhet pasur kujdes që të parandalohet shpërndarja ose rënia e materialeve, ose të projektohet në mënyrë të tillë, që mos të përbëjë rrezik për njerëzit, strukturat rrethuese dhe pronat publike të çdo lloji.

Kur përdoren mekanizmat për prishje si: vinç, ekskavatorë hidraulik dhe thyes shkëmbinjsh të bëhet kujdes, që pjesë të tyre të mos kenë kontakt me kablllo telefonik ose elektrik. Kontraktori duhet të informojë në fillim të punës autoritetet përkatëse, në mënyrë që, ato të marrin masa për lëvizjen e kablllove.

- Mbrojtja e vendit të pastruar

Kontraktori duhet të ngrejë rrjete të përshtatshme, barriera mbrojtëse, në mënyrë që, të parandalojë aksidentime të personave ose dëmtime të godinave rrethuese nga materialët që bien, si dhe të mbajë nën kontroll territorin, ku do të kryhen punimet.

SEKSIONI 3 PUNIME DHEU, GËRRMIME DHE THEMELET

3 Punime dheu

3.1 Përgatitja e formacioneve

Përgatitja e formacioneve përfshin këto punë:

- Njohja dhe saktësimi i rrjeteve të instalimeve nën tokë si p.sh.: tuba të furnizimit të ujësjellësit, tuba të shkarkimit, kablllo elektrike e telefonie etj
- Matja e terrenit dhe marrja e provave të dheut
- Shpyllëzimi dhe heqja e rrënjëve prej terrenit
- Heqja e dheut me humus dhe transportimi apo ripërdorimi i saj

3.1.1 Përpunimi i pjerrësive

Në rastet e terrenit me pjerrësi veprohet sipas tre mënyrave të mëposhtme:

- Nivelimi i pjerrësisë sipas pikës më të ulët të terrenit
- Mbushja e terrenit me material ekstra, deri në nivelin e pikës më të lartë të terrenit
- Gërmime dhe mbushje sipas pikës mesatare

Secila nga këto raste do të përdoret në varësi të llojit të dheut, të aftësisë mbajtëse të truallit dhe të ngarkesave të godinës që do të ndërtohet në atë truall.

3.1.2 Drenazhimi i punimeve të dherave

Connectio ns	Gas Pipe		Ø,mm(i)	12.7(1/2")	12.7(1/2")	12.7(1/2")	12.7(1/2")
	Drain Pipe		Ø,mm	ID 18 HOSE	ID 18 HOSE	ID 18 HOSE	ID 18 HOSE
Field Wiring	Power Source Wire		mm2	1.5~2.5	1.5~2.5	1.5~2.5	1.5~2.5
	Transmission Cable		mm2	0.75/1.5	0.75/1.5	0.75/1.5	0.75/1.5
Refrigeran t	Type		-	R410A	R410A	R410A	R410A
	Control Method		-	EEV INCLUDED	EEV INCLUDED	EEV INCLUDED	EEV NOT
Sound	Sound pressure	High /	dBa	31/25	31/26	36/29	38/33
Dimensio ns	Net Weight		kg	8.500	9.000	9.000	12.000
	Shipping Weight		kg	10.200	10.600	10.600	14.000
	Net Dimensions (WxHxD)		mm	820.00x285.00x22	820.00x285.00x22	820.00x285.00x22	1065.00x298.00x24
	Shipping Dimensions		mm	880.00x363.00x28	880.00x363.00x28	880.00x363.00x28	1128.00x378.00x29
Panel Size	Panel model		-				
	Panel Net Weight		kg				
	Shipping Weight		kg				
	Net Dimensions (WxHxD)		mm				
	Shipping Dimensions		mm				

1.7 Gazi Ftohese R410 A

Ftohësi R410A përdoret gjerësisht si gas ftohës në shumë aplikacione të ajrit të kondicionuar.

Për shkak të natyrës së vetive të R410a, i cili përbëhet nga një ftohës HFC (hidrofluorokarbure), ai nuk ka ndonjë potencial për zvogëlimin e ozonit (Zero ODP). Ftohësi R410A ka ndikim të ulët mjedisor. Me poshte

paraqiten karaktersistkat teknike te Gazit Ftohes R410 A qe duhet furnizuar per te mbushur pajisjet e Kondicionimit.

RELACIONI TEKNIK

MBROJTJA KUNDRA ZJARRIT

OBJEKTI:

"RRUGËT E SHIJES: MOLLAJ, BOBOSHTICE, DRENOVE, QATROM", BASHKIA
KORÇË

KLIENTI: FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

BURHAN TURKESHI

K.1873/4

ERMIR GJOKA

M.1174/2

Inxhinieri Hidro-Mekanik dhe MNZ

TIRANE 2024

SPECIFIKIMET TEKNIKE PER IMPIANTI I MBROJTJES KUNDRA ZJARRIT “MKZ”

Shuarës Zjarri të Mbartshëm dhe të Levizshëm













Zgjedhja e llojit të shuarësit të zjarrit varion sipas llojit të mjetit shuarës që duhet të përdoret për llojin e materialit që digjet. Zjarret mund të klasifikohen si më poshtë:

- **Klasa A e Zjarrit:** zjarret e materialeve të ngurta, zakonisht organike në natyrë, të cilat çojnë në formimin e prusheve dhe te hirit. Uji, shkuma dhe pluhuri janë substancat më të përdorura për shuarjen e këtyre lloj zjarresh. Pajisjet që përdoren për shuarjen e zjarreve ne fjale janë shuarës zjarri, barabanë me zorrë dhe hidrantë zjarri.
- **Klasa B e zjarrit:** zjarret e lëngjeve ose materiale të ngurta që zbuten nga temperatura ,të tilla si vajrat, dyll parafine, bojë, graso, etj. Për këtë lloj zjarri substancat më të përdorura për shuarjen e zjarrit janë : shkuma, pluhuri dhe dioksidi i karbonit.
- **Klasa C e zjarrit:** zjarret nga gazi . Veprimi kryesor kundër këtyre lloj zjarresh është që të ndalohet së pari rrjedhja e gazit duke mbyllur valvula ndërprerëse ose hermetizimin e rrjedhjes. Është e rëndësishme të dimë se ekziston rreziku i shpërthimit në qoftë se një zjarr i shkaktuar nga djegia e gazit është shuar para ndërprerjes së rrjedhjes së gazit.
- **Klasa D e zjarrit:** zjarre të shkaktuar nga djegia e substancave metalike.
- **Klasa E e zjarrit:** zjarre të shkaktuar nga djegia e pajisjeve elektrike nën tension, si; transformator, motorë, panele, kablllo etj.

Vetëm tipat e Klasave A, E dhe F të zjarreve mund të priten të ndodhin në ambientet e ndertesave.

Substancat shuarës specifike për shuarjen e zjarreve nga djegia e instalimeve elektrike nën tension janë të përbërë nga pluhurat dielektrikë dhe dioksidit të karbonit.

Zgjedhja e shuarësve të zjarrit të mbartshëm dhe të lëvizshëm me rrota përcaktohet sipas klasës së zjarrit dhe nivelin e rrezikut të vendit të punës dhe personelit të përfshirë në përdorimin e tyre.

	Colours						
Type:		Fires involving wood, paper, textiles etc.	Fires involving Flammable Liquids, petrol oil etc.	Fires involving Flammable gases, butane, propane etc.	Fires involving burning metals eg magnesium	Fires involving electrical equipment	Fires involving cooking oils and fats.
Water		✓	✗	✗	✗	✗	✗
Foam		✓	✓	✗	✗	✗	✗
Dry Powder		✓	✓	✓	✗	✓*	✗
M28 / L2		✗	✗	✗	✓	✗	✗
Co2		✗	✓	✗	✗	✓	✗
Wet Chemical		✓	✗	✗	✗	✗	✓

Tipi i Shuarësit të Zjarrit	Sipërfaqja e mbrojtur nga shuarësi zjarrit		
	Rrezik i Ulët	Rrezik i Mesëm	Rrezik i Lartë
13 A - 89 B	100 m ²	-	-
21 A - 113 B	150 m ²	100 m ²	-
34 A - 144 B	200 m ²	150 m ²	100 m ²
55 A - 233 B	250 m ²	200 m ²	200 m ²

Në ambientet e restoranteve, bareve dhe moduleve do të instalohen këto tipa shuarësish zjarri :

- Shuarës të mbartshëm me pluhur 34 A – 233 BC.
- Shuarës të mbartshëm me doksid karboni CO2 - 113 B.

FAKES PORTABLE UNI EN 3-7 - PLUHUR

240 A • B • C • G • H
FAKES PLUHURI ABC
KG. 4-6-9-12




240 D - E
FAKES PLUHURI ABC
KG 1-2



**SPECIALE
BATERITË LITIUM**

240 I • ORGANIKE - LITH
**FAKES ME BAZE UJI
ME FUQI TË LARTË
FTOHEN**



TËRTOUAR E
MIRATUAR
PER ATE
FIKE
NGA PILE E
BATERITË TE
JONE LITIUM
DERI 625 KW

tipologji	artikulli	klasa zjarri	miratimi	diametri mm	lartësia 510	pesha
PLUHUR	240 A	34 A - 133 para Klorid	Ministria e Brendshme	160	410	10 kg
	240 H	55 A - 133 para Klorid	Ministria e Brendshme	160	510	10
	240 B	55 A - 133 para Klorid	Ministria e Brendshme	170	640	14.6
	240 C	55 A - 133 para Klorid	Ministria e Brendshme	190	640	17.6
	240 D	8 A - 18 para Klorid	Ministria e Brendshme	80	330	3.1
	240 E	13A - 18 para Klorid	Ministria e Brendshme	100	380	3.5
	240 G	kapaciteti kg G kg 0.9kg 0.9kg 1.2kg 1.2kg 2 kg 4			145	460

FAKES PORTABLE UNI EN 3-7 - ME BAZE UJI

241 A
FAKES I UJIT
6 litra shkumë AFFF 1%



INOX
ISI 304L
FISHA E BEHUTARIZO
0°C - +60°C

241 B
FAKES I UJIT
6 litra shkumë AFFF 1%

**SPECIALE
KUZHINA**



ÇELIK I VESHUR PLASTIK
FISHA E PERDORIMIT
0°C - +60°C

241 C
FAKES I UJIT
SERIA KROMI
6 litra shkumë AFFF 1%



INOX
AISI 304L
FISHA E BEHUTARIZO
0°C - +60°C

Fig 10 Romholat

SPECIFIKIME TEKNIKE TË PROJEKTIT ELEKTRIK

Projekti:	Rrugët e Shijes: Mollaj, Boboshticë, Drenovë, Qatrom
Objekti:	Qatrom
Klienti:	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Vendndodhja:	Mollaj, Boboshticë, Drenovë, Qatrom, Bashkia Korçë
Projektues:	BD Engineering
Ing Elektrik:	Bashkim SHAHINAJ
Nr. Licence:	E.0185/6
Ing Elektrik:	Besart DALLIU
Nr. Licence:	E.1412/2

NËNTOR / 2024

PERMBAJTJA

1.	TE PERGJITHSHME	30
1.1	Hyrje	30
1.2	Kategoria e objektit.....	30
2.	STANDARTE DHE NORMA.....	30
2.1	Kërkesa të Përgjithshme.....	30
2.2	Sigurimi Teknik	30
2.3	Standarte dhe Norma Teknike.....	31
3.	IMPIANTI PROJEKTIT ELEKTRIK.....	32
3.1	Përmiresimi i koeficientit te Fuqisë	33
4.	IMPIANTI QENDROR I TENSIONIT TE ULET	33
4.1	Paneli Kryesor i T.U. 0,4 kV	33
4.2	Ana konstruktive e Paneleve 0,4 KV	34
4.3	Automatet mbrojtës.....	35
4.4	Rrjeti ushqyes.....	38
4.5	Norma te rrjetit shperndares te grupeve	39
4.6	Kanalet dhe aksesoret.....	39
4.7	Rrjeti i Kabllo te Fuqise	41
4.8	Seksioni i percjellesit te Nulit	42
5.	SISTEMI I RRJETIT TE FUQISË.....	42
6.	SISTEMI I NDRICIMIT NORMAL.....	43
6.1	Sensoret e levizjes.....	48
7.	SISTEMI I NDRICIMIT TE EVAKUIMIT.....	49
8.	SISTEMI I DETEKTIMIT TE ZJARRIT	50
9.	SISTEMI I VEZHGIMIT ME KAMERA CCTV.....	53
10.	SISTEMI TOKËZIMIT DHE EKUIPOTENCIALIZIMIT	54
10.1	Ndërtimi i Rrjetit të Tokëzimit	55
10.2	Tokëzimi i Neutrit	55
10.3	Përcjellsat e Rrjetit të Tokëzimit	55
10.4	Lidhjet Ekuipotencializuese	56
11.	SISTEMI TOKËZIMIT DHE MBROJTJES NGA SHKARKIMET ATMOSFERIKE	57

1. TE PERGJITHSHME

1.1 Hyrje

Hartimi i specifikimeve teknike, realizimi i zbatimit të punimeve ndërtimore, blerja dhe instalimi i pajisjeve të ndryshme, si edhe përcaktimi për të gjithë materialet që do të përdoren, do të jenë nga vendet e BE-së, për të ndërtuar kështu një objekt sa më funksional ashtu edhe bashkëkohorë. Në hartimin e projektit elektrik të objektit do të përfshihen ndërtimi i sistemeve elektrike të mëposhtme :

1. Sistemi i Detektimit të Zjarrit;
2. Sistemi i Rrjetit të Fuqisë;
3. Sistemi i Ndriçimit Normal & Evakuimit;
4. Sistemi i Vëzhgimit me Kamera CCTV;
5. Sistemi i Tokëzimit dhe Mbrojtjes Atmosferike
6. Skemat Elektrike TU
7. Infrastruktura e Jashtme

Projektimi i sistemeve elektrike të mesiperme për objektet "Rrugët e Shijes", është bërë duke ju përshtatur dhe përgjigjur kërkesave të parashtruara në detyrën e projektimit. Ndërtimi i sistemeve elektrike do të lidhet ngushtë me hapësirën e brendshme të godinave.

Projekti elektrik parashikon furnizimin me energji dhe zgjidhjet për instalimet elektrike dhe sistemet e sigurisë në godina. Llogaritjet janë bërë duke u bazuar në fuqitë e paisjeve mekanike të dhëna nga projektuesi mekanik si dhe në ngarkesat e tjera kryesisht ndricimi, priza shërbimi, poste pune, paisje mekanik etj.

1.2 Kategoria e objektit

Në hartimin e projektit elektrik, për të gjitha sistemet elektrike janë zbatuar standardet dhe normat e projektimit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ato evropian CE (DIN, BS, IEC, etj..). Në projektin e sistemit elektrik të shpërndarjes është zbatuar sistemi TN-S (ku neutri dhe përcjellësi ekuipotencial i tokës PE janë të veçantë), sistemi i cili realizon një shkallë mbrojtje të lartë.

2. STANDARTE DHE NORMA

2.1 Kërkesa të Përgjithshme

Instalimet duhet të bëhen në mënyrë strikte siç kërkohen nga SSH në fuqi. Karakteristikat e impianteve dhe komponentëve të tyre duhet të jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Instalimet duhet të përmbushin dhe kërkesat e OSHEE dhe kompanisë IT për nderlidhjen me sinjal telefonik dhe data.

2.2 Sigurimi Teknik

Kontrulli dhe instalimet elektrike duhet të përputhen me kërkesat dhe rregullat e IQT dhe SSH në fuqi. Bazuar në Ligjin Nr.8734, datë 1.2.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike" dhe me VKM vendimin Nr. 245, datë 30.3.2016 ministria e Energjisë dhe Industrisë, Këshilli I Ministrave.

2.3 Standarte dhe Norma Teknike

- SSH HD 60364-7-718:2013 - Instalimet elektrike të TU - Pjesa 7-718: Kërkesat për instalimet ose vendndodhjet speciale - Mjetet e nevojshme dhe vendet e punës
- SSH HD 60364-7-718:2013/A11:2017 - Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 7-718: Kërkesa për instalimet ose vendndodhjet speciale - Objektet komunale dhe vendet e punës
- SSH HD 60364-1:2008 - Instalimet elektrike të TU - Pjesa 1: Parimet bazë, vlerësimi I karakteristikave të përgjithshme, përcaktimet
- SSH HD 60364-4-41:2007 - Instalimet elektrike të TU - Pjesa 4-41: Mbrojtja për garantimin e sigurisë - Mbrojtja kundër goditjeve elektrike
- SSH HD 60364-4-42:2011 - Instalimet elektrike të TU - Pjesa 4-42: Mbrojtja për garantimin e sigurisë - Mbrojtja kundër efekteve termale
- SSH HD 60364-4-42:2011/A1:2015 - Instalimet elektrike të TU - Pjesa 4-42: Mbrojtja për garantimin e sigurisë - Mbrojtja kundër efekteve termale
- SSH HD 60364-4-43:2010 - Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 4-43: Mbrojtja për sigurinë - Mbrojtja kundër mbirrymave
- SSH HD 60364-4-442:2012 - Instalimet elektrike të TU - Pjesa 4-442: Mbrojtja për garantimin e sigurisë - Mbrojtja e instalimeve të TU kundër mbitensionit të përkohshëm për shkak të defekteve të tokëzimit në sistemin e TL dhe defekteve në sistemin e TU
- SSH HD 60364-4-443:2006 Instalimet elektrike të ndërtesave - Pjesa 4-44: Mbrojtja për garantimin e sigurisë - Mbrojtja kundër çrregullimeve të tensionit dhe çrregullimeve elektromagnetike - Klauzola 443: Mbrojtja kundër mbitensionit me origjinë atmosferike ose për shkak të manovrimeve
- SSH HD 60364-4-443:2016 - Instalime elektrike të ndërtesave - Pjesa 4-44: Mbrojtja për garantimin e sigurisë - Mbrojtja kundër çrregullimeve të tensionit dhe çrregullimeve elektromagnetike - Klauzola 443: Mbrojtja kundër mbitensionit me origjinë atmosferike ose për shkak të manovrimit.
- SSH HD 60364-4-444:2010 - Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 4-444: Mbrojtja për sigurinë - Mbrojtja kundër çrregullimeve të tensionit dhe çrregullimeve elektromagnetike
- SSH HD 60364-4-444:2010/AC: 2012 - Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 4-444: Mbrojtja për sigurinë - Mbrojtja kundër çrregullimeve të tensionit dhe çrregullimeve elektromagnetike
- SSH HD 60364-5 -51:2009/A11:2013 - Instalimet elek të ndërtesave - Pjesa 5-51: Përzgjedhja & ngritja e pajisjeve elek - Rregulla të zakonshme
- SSH HD 60364-5-51:2009 - Instalimet elektrike të ndërtesave - Pjesa 5-51: Përzgjedhja dhe ngritja e pajisjeve elektrike - Rregulla të zakonshme
- SSH HD 60364-5-52:2011 - Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 5-52: Përzgjedhja dhe montimi i pajisjeve elektrike - Sistemet e instalimeve elektrike
- SSH HD 60364-5-53:2015 - Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 5-53: Përzgjedhja dhe ndërtimi i pajisjes elektrike - Pajisjet e shpërndarjes dhe kontrollit
- SSH HD 60364-5-534:2008 - Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 5-53: Përzgjedhja dhe ngritja e pajisjeve elektrike - Izolimi, çkyçja dhe kontrolli - Pika 534: Pajisje për mbrojtjen ndaj mbitensionit
- SSH HD 60364-5-534:2016 - Instalime elektrike të ndërtesave - Pjesa 5-53: Përzgjedhja dhe montimi i pajisjeve elektrike - Izolimi, çkyçja dhe kontrolli - Klauzola 534: Pajisje për mbrojtjen ndaj mbitensionit të përkohshëm
- SSH HD 60364-5-54:2007 - Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 5-54: Përzgjedhja dhe ngritja e pajisjeve elektrike - Sistemi i tokëzimit, përcjellësit mbrojtës dhe përcjellësit e lidhjes së mbrojtjes
- SSH HD 60364-5-54:2011 - Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 5-54: Përzgjedhja dhe ngritja e pajisjeve elektrike - Sistemi i tokëzimit dhe përcjellësit mbrojtës
- SSH HD 60364-5-551:2010 - Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 5-55: Përzgjedhja dhe ngritja e pajisjeve elektrike - pajisje të tjera - Klauzola 551: Kompletet gjeneruese të tensionit të ulët
- SSH HD 60364-5-551:2010/A11:2016 - Instalime elektrike të TU - Pjesa 5-55: Përzgjedhja dhe montimi i pajisjeve elektrike - Pajisje të tjera - Klauzola 551: Pajisjet gjeneruese të TU
- SSH HD 60364-5-557:2013 - Instalimet elektrike të TU - Pjesa 5-557: Përzgjedhja dhe ndërtimi i pajisjeve elektrike - Qarqet ndihmëse
- SSH HD 60364-5-557:2013/A11:2016 - Instalime elektrike të TU - Pjesa 5-557: Përzgjedhja dhe ndërtimi i pajisjeve elektrike - Qarqet ndihmëse
- SSH HD 60364-5-559:2005 - Instalimet elektrike të TU - Pjesa 5-55: Përzgjedhja dhe ngritja e pajisjeve elektrike - Klauzola 559: Instalimet e ndriçuesve
- SSH HD 60364-5-559:2012 - Instalimet elektrike të TU - Pjesa 5-559: Përzgjedhja dhe ngritja e pajisjeve elektrike - Ndriçuesit dhe instalimet e ndriçimit
- SSH HD 60364-5-56:2010 - Instalimet elektrike të TU - Pjesa 5-56: Përzgjedhja dhe ngritja e pajisjeve elektrike - Shërbimet e sigurisë
- SSH HD 60364-5-56:2010/A1:2011 - Instalimet elektrike të TU - Pjesa 5-56: Përzgjedhja dhe ngritja e pajisjeve elektrike - Shërbimet e sigurisë
- SSH HD 60364-5-56:2010/A11:2013 - Instalimet elektrike të TU - Pjesa 5-56: Përzgjedhja dhe ngritja e pajisjeve elektrike - Shërbimet e sigurisë
- SSH HD 60364-6:2007 - Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 6: Verifikimi
- SSH HD 60364-6:2016 - Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 6: Verifikimi
- SSH HD 60364-6:2016/A11:2017 - Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 6: Verifikimi
- SSH HD 60364-7-701:2007 - Instalimet elektrike të TU - Pjesa 7-701: Kërkesa për instalime ose vende të veçanta - Vende që kanë dush ose vaskë
- SSH HD 60364-7-701:2007/A11:2011 - Instalimet elektrike të TU - Pjesa 7-701: Kërkesa për instalime ose vende të veçanta - Vende që kanë dush ose vaskë
- SSH HD 60364-7-701:2007/AC:2011 - Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 7-701: Kërkesat për instalimet ose vendndodhjet speciale - Vendosja në vende që kanë dush ose vaskë
- SSH HD 60364-7-702:2010 - Instalimet elektrike të TU - Pjesa 7-702: Kërkesa për instalime ose vendndodhje të veçanta - Pishina dhe shatërvanë
- SSH HD 60364-7-703:2005 - Instalime elektrike të godinave - Pjesa 7-703: Kërkesa për instalime ose vende të veçanta - Dhoma dhe kabina ngrohës saunë

- SSH HD 60364-7-704:2007 - Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 7-704: Kërkesa për instalime ose vende të veçanta - Instalimet e kantierëve të ndërtimit dhe të shkatërrimit
- SSH HD 60364-7-705:2007 - Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 7-705: Kërkesa për instalime ose vende të veçanta - Lokal shërbimi agrikulture dhe hortikulture
- SSH HD 60364-7-705:2007/A11:2012 - Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 7-705: Kërkesa për instalime ose vende të veçanta - Stabilimentet agrikultural dhe hortikultural
- SSH HD 60364-8-1:2015 - Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 8-1: Eficenca e energjisë
- SSH IEC 60364-4-41:2005+A1:2017 - Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 4-41: Mbrojtja për garantimin e sigurisë - Mbrojtja ndaj goditjes elektrike
- SSH IEC 60364-4-44:2007 - Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 4-44: Mbrojtja për sigurinë - Mbrojtja nga zhurmat e tensionit dhe zhurmat elektromagnetike
- SSH IEC 60364-4-44:2007/A1:2015 - Amendament 1 - Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 4-44: Mbrojtja për siguri - Mbrojtja ndaj çrregullimeve të tensionit dhe çrregullimeve elektromagnetike
- SSH IEC 60364-4-44:2007+A1:2015 - Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 4-44: Mbrojtja për siguri - Mbrojtja ndaj çrregullimeve të tensionit dhe çrregullimeve elektromagnetike
- SSH IEC 60364-5-53:2001/A2:2015 - Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 5-53: Përzgjedhja dhe ndërtimi i pajisjes elektrike - Pajisjet e shpërndarjes dhe kontrollit
- SSH IEC 60364-6:2006 - Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 6: Verifikimi
- SSH IEC 60364-7-714:2011 - Instalime elektrike të ndërtesave - Pjesa 7-714: Kërkesat për instalimet ose vendndodhjet speciale - Instalimet e ndriçimit të jashtëm
- DS IEC/TR 60909-1:2009 - Rrymat e L.Sh në sistemet trefazore a.c. - Pjesa 1: Faktorët për llogaritjen e rrymave të L.Sh në përputhje me IEC 60909-0
- DS IEC/TR 60909-2:2009 - Rrymat e L.Sh në sistemet trefazore a.c. - Pjesa 2: Të dhënat e pajisjeve elektrike për llogaritjet e rrymave të L.Sh
- SSH EN 60909-0:2001 - Rrymat e qarkut të shkurtër - në sistemet e rrymës alternative trifazore – Pjesa 0: Llogaritja e rrymave
- SSH EN 60947-1:2007 - Tërësia e pajisjeve shpërndarëse të tensionit të ulët — Pjesa 1: Rregulla të përgjithshme
- SSH EN 60947-1:2007/A1:2011 - Pajisjet shpërndarëse dhe të kontrollit të tensionit të ulët - Pjesa 1: Rregullat e përgjithshme
- SSH EN 60947-1:2007/A2:2014 - Pajisjet shpërndarëse dhe të kontrollit të tensionit të ulët - Pjesa 1: Rregullat e përgjithshme
- SSH EN 60947-2:2003 - Specifikim për pajisjet shpërndarëse të tensionit të ulët - Pjesa 2: Ndërprerësit e qarkut
- SSH EN 60947-2:2006 - Pajisjet shpërndarëse dhe të kontrollit të tensionit të ulët — Pjesa 2: Ndërprerësit e qarkut
- SSH EN 60947-2:2006/A1:2009 - Pajisje shpërndarëse dhe kontrolli për tension të ulët - Pjesa 2: Ndërprerësit e qarkut
- SSH EN 60947-2:2006/A2:2013 - Pajisje shpërndarëse dhe kontrolli për tension të ulët - Pjesa 2: Ndërprerësit e qarkut
- SSH EN 61936-1:2010 - Instalimet e fuqisë që tejkalojnë 1 kV a.c. - Pjesa 1: Rregulla të zakonshme
- SSH EN 61936-1:2010/A1:2014 - Instalimet e fuqisë që tejkalojnë 1 kV a.c. - Pjesa 1: Rregulla të zakonshme
- SSH EN 60076-1:2011 - Transformatorët e fuqisë - Pjesa 1: Të përgjithshme
- SSH EN 60076-11:2004 - Transformatorët e fuqisë - Pjesa 11: Transformatorët e tipit të thatë
- SSH EN 60076-5:2006 - Transformatorët e fuqisë - Pjesa 5: Aftësia për t'i qëndruar qarkut të shkurtër
- SSH IEC 60076-12:2009 - Transformatorët e fuqisë - Pjesa 12: Udhëzues ngarkimi për transformatorët e fuqisë të tipit të thatë
- SSH IEC 60076-8:1997 - Transformatorët e fuqisë - Pjesa 8: Udhëzues për zbatim
- SSH EN 60947-2:2006 - Pajisjet shpërndarëse dhe të kontrollit të tensionit të ulët — Pjesa 2: Ndërprerësit e qarkut
- SSH EN 60947-2:2006/A1:2009 - Pajisje shpërndarëse dhe kontrolli për tension të ulët - Pjesa 2: Ndërprerësit e qarkut
- SSH IEC 60947-2:2016 - Pajisje shpërndarëse dhe kontrolli të tensionit të ulët - Pjesa 2: Ndërprerësit e qarkut

3. IMPIANTI PROJEKTIT ELEKTRIK

Furnizimi me energji elektrike do të behet nga paneli kryesor TU i kompleksit i cili ndodhet. E gjithë shpërndarja dhe lidhja e nenkuadrove elektrike do të behet nga paneli kryesor sipas skemave njevijore.

Përcaktimi i ngarkesave elektrike të vendosura është bere sipas projektit, ndërsa i atyre të pritshme duhet të behet në përputhje me rekomandimet që jepen në literature si edhe sipas përvojës së objekteve të tjera të ngjashme. Koeficientet e kërkesës ose ata të njëkohshmerise (faktori “gl” sipas normave VDE) janë të marre ne vlerat e mëposhtme:

- Për sistemin e ndriçimit elektrik,..... 1
- Kondicionimi, ventilim dhe ajrimi,..... 0.8
- Priza e fuqise,..... 0.4.

Për te realizuar këtë sistem është llogaritur fuqia e instaluar dhe e kërkuar dhe janë bere llogaritjet për furnizimin e te gjitha ngarkesave elektrike te objekteve dhe ngarkesat për sistemet e ngrohjes, kondicionim, ventilim, impiantet hidrosanitare qe mund te vendosen ne te ardhmen.

Nga llogaritjet e kryera, duke marre ne konsiderate te gjithë parametrat dhe targetat e paisjeve te impianteve mekanike dhe makinerive te vendosura ne objekte, kemi rezultat e mëposhtme :

Tabela Përmbledhëse e Fuqive Elektrike Totale të Projektit “Rrugët e Shijes”, Objekti Qatrom:

<i>Projekti</i>	<i>Objekti</i>
<i>Rrugët e Shijes</i>	<i>Qatrom</i>
1. Fuqia e Instaluar (P_{Inst})	85 kW
2. Fuqia e Kërkuar ($P_{Kërk}$)	40 kW
3. Koeficienti i Kërkesës: (K_{kerk})	0.47
4. Faktori i Fuqisë: ($\cos\phi$)	$\cos\phi=0.9$
5. Linja e Furnizimit:	5x16mm²

3.1 Përmirësimi i koeficientit të Fuqisë

Ne përputhje me V.K.M. vlera e koeficientit të fuqisë në impiantet e reja elektrike duhet të mos jete më e ulët se 0,9. Përmirësimi i $\cos\phi$ do të jetë i përgjithshëm në të gjithë impiantin, një përmirësim i natyrës së tillë do të behet edhe edhe do të instalohet në grupin e pare të ngarkesave të impianteve mekanike të kondicionimit, ventilimit dhe të sistemit të ngrohje/ftohje, pjesa hyrese e Panelit Elektrik Kryesor të TU; Kyçja dhe kyçja e këtyre kondensatorëve do behet në përputhje me vlerat e matura të çastit të $\cos\phi$ nëpërmjet një kuadri elektronik të rregullimit, që montohet në fasadën e panelit elektrik kryesor metalik, brenda të cilit janë instaluar grupet e baterive të kondensatorëve. Kyçja e kondensatorëve behet me shkalle (nëpërmjet kontaktoreve), kurse sinjalizimi i punës së tyre për çdo shkalle veprimi behet me llamba LED.

4. IMPIANTI QENDROR I TENSIONIT TE ULET**4.1 Paneli Kryesor i T.U. 0,4 kV**

Impianti shpërndarës qendror i TU duhet të jete i tipit me sirtar dhe të përmbajë të gjithë automatiken e domosdoshme për realizimin e skemave tepër të sofistikuara AKR (automatika e kyçjes së rezervës), duke klasifikuar konsumatorët në konsumatorë të kategorisë së pare (prioritare), të kategorisë së privilegjuar dhe super të privilegjuara. Te gjitha panelet 0,4kV duhet të plotësojnë kushtet teknike ICE, VDE ose ato italiane CEI-17-13/1 (botimi i dyte). Këto panele duhet të porositen vetem në kompani të certifikuar për prodhimin e panelve elektrike, të jene të kolauduara në uzinë dhe të shoqërohen me certifikatat e cilësisë (konformitetit).



Figura 1 : Modele të tipit të Panelit Elektrik Kryesor dhe Shpërndarës të TU

4.2 Ana konstruktive e Paneleve 0,4 KV

Paneli shpërndarës duhet të jete me hapsirën e nevojshme për vendosjen e të gjithë automatëve dhe të llogariten me një rezervë prej 15-20% për zhvillime të mundshme në të ardhmen. Këto panele duhet të plotësojnë kriteret termike të ngrohjes së automatëve, të kenë vëndin për vendosjen e klemave dhe të terminalevetë kablllove, të jenë të montueshëm në dysheme ose në mur sipas kërkesës:

- Panelet do të jene në mbulose metalike, me shërbim të njëanshëm, me sirtarë, për vendosje mbi dysheme dhe të shkalles së mbrojtjes IP-40.
- Te gjitha zbarrat lidhëse duhet të jene prej bakri elektrolitik duke plotësuar të gjitha kushtet e qendrushmerise dinamike dhe termike ndaj R.L.SH.
- Përveç automateve të punës duhen parashikuar edhe automate rezerve në masën 15% (te instaluar si automate) dhe 10% si vende bosh rezerve.

Ne rrjetin elektrik te objektit do te jene :

1. *Kuadri Elektrik Kryesor – Kati (0), [K.E.K-K(0)]*

- Me analizator digital te parametrave te rrjetit;
- Me shkarkues mbitensioni 3~ 400V/ 50Hz;
- Panel klemash per lidhjen e te gjithe kablllove hyres dhe dales;
- Hyrjet dhe daljet e kablllove jane nga poshte;
- Shkalla e mbrojtjes: tip plastik, IP 40;
- Sipas skemes qe jepet ne projekt;
- Me gjithe aksesoret e nevojshem dhe materialet ndihmese per nje montim dhe instalim korrekt dhe ne perputhje me standartet dhe rregulloret ne fuqi dhe me rekomandimet e prodhuesve, i gatshem per shfrytezim.

2. *Kuadri Elektrik Shpërndarës – Kati (1), [K.E.Sh-K(1)]*

- Me shkarkues mbitensioni 3~ 400V/ 50Hz;
- Panel klemash per lidhjen e te gjithe kablllove hyres dhe dales;
- Hyrjet dhe daljet e kablllove jane nga poshte;
- Shkalla e mbrojtjes: tip plastik, IP 40;
- Sipas skemes qe jepet ne projekt;
- Me gjithe aksesoret e nevojshem dhe materialet ndihmese per nje montim dhe instalim korrekt dhe ne perputhje me standartet dhe rregulloret ne fuqi dhe me rekomandimet e prodhuesve, i gatshem per shfrytezim.

3. *Kuadri Elektrik – Kati (0), [K.E-K(0)]*

- Me shkarkues mbitensioni 3~ 400V/ 50Hz;
- Panel klemash per lidhjen e te gjithe kablllove hyres dhe dales;
- Hyrjet dhe daljet e kablllove jane nga poshte;
- Shkalla e mbrojtjes: tip plastik, IP 40;
- Sipas skemes qe jepet ne projekt;
- Me gjithe aksesoret e nevojshem dhe materialet ndihmese per nje montim dhe instalim korrekt dhe ne perputhje me standartet dhe rregulloret ne fuqi dhe me rekomandimet e prodhuesve, i gatshem per shfrytezim.

4. Panel Elektrik - Matje, [P.E-M]

- Panel klemash per lidhjen e te gjithë kabllove hyres dhe dales;
- Hyrjet dhe daljet e kabllove jane nga poshte;
- Shkalla e mbrojtjes: tip metalik, IP 65 / IK08;



Figura 2 : Model i Kuadrove elektrik te kateve

Plotësimi dhe ndërtimi i kuadrove elektrike te brendshëm me kite dhe aksesoret e vetë. Si në figurën 5 Asemblimi i paneleve në mënyrën e duhur dhe arkitekturën e përshtatshme lejon një hapsirë të mjaftueshme për plotësimin e kushteve të punës së automatëve dhe eliminon gabimet njerëzore në montim dhe vendosjen e tyre. E këshillueshme është përdorimi i strukturave modulare.




Figura 3 : Kite të gatshme dhe aksesorë të nevojshëm




Figura 4 : Struktura të realizuara me kite dhe aksesorët e duhur të konsumatorit

4.3Automatet mbrojtës

Pajisjet mbrojtëse duhet të jenë automatë sipas normës CEI 60898 dhe CEI 60947-2. Këta automatë mbrojnë pajisjet dhe sigurojnë një veprim të shpejtë nga mbingarkesa dhe lidhjet e shkurtra. Këta automatë duhet të lidhen para pajisjeve fundore dhe qarqeve te cilat nuk kanë prezencë direkte të personelit.



Figura 5 : Automatë një dhe dy polarë sipas CEI 60898

Karakteristikat e automatëve:

- **Rryma e lidhjes shkurtër:** 6 kA;
- **Rryma nominale:** 6 – 32A;
- **Tensioni nominal i punës:** 230V;
- **Numri i cikleve:** 20 000.



Figura 6 : Automatë dy polarë sipas CEI 60947-2

Karakteristikat e automatëve:

- **Rryma e lidhjes shkurtër:** 6-10 kA
- **Rryma nominale:** 10–63A
- **Tensioni nominal i punës:** 230V
- **Karakteristika e rënies:** "C"
- **Numri i cikleve:** 10 000 - 20 000

Automatët diferencialë dhe MT diferencialë sipas normës CEI 61008, sigurojnë përveç mbrojtjes nga mbingarkesa dhe lidhjet e shkurtra edhe mbrojtjen nga rrymat e rrjedhjes me tokën. Në këtë mënyrë sigurojnë personelin nga ndonjë gabim i mundshëm gjatë instalimit dhe gjatë dëmtimit të pajisjeve të cilat kanë kontakt direkt me të. Në mënyrë kategorike të gjitha qarqet e mësipërme duhet të mbrohen me automatë diferencialë.



Figura 7 : Automatë diferencialë dy polare dhe katër polare sipas CEI 6100

Karakteristikat e automatëve diferenciale:

- **Rryma nominale:** 25 - 100A;
- **Tensioni nominal i punës:** 230/400V;
- **Karakteristika e rënies:** "C";
- **Numri i cikleve:** 2500;

Automatët e fuqisë sipas normës CEI 60947-2 të përshtatshëm për panelet TU si ata kryesore ashtu edhe ata shpërndarës të kateve. Sigurojnë dhe garantojnë furnizimin me energji të të gjithë objektit dhe mbrojnë gjithë panelin dhe instalimin nga lidhjet e shkurtra dhe nga mbingarkesat. Këta automatë janë me mbrojtje termike nga mbingarkesat të rregullshme. Në të gjitha rastet kur ngarkesat e llogariura e kalojnë rrymen 80A duhet të përdoren automatë si figuren e mëposhtme.



Figura 8 : Automatë magnetotermikë LSI dhe LSIG, tre dhe katër polarë sipas CEI 60947-2, të përdorur në kompozimin e Panelit Elektrik Kryesor dhe Panelin Elektrik Shpërndarës

Karakteristikat e automatëve magnetotermikë:

- **Rryma nominale:** 80 - 250A;
- **Tensioni nominal i punës:** 380/415V;
- **Karakteristika e reniës:** "C";
- **Tarimi i rymës termike:** $(0.7 - 1) \times I_n$;
- **Numri i cikleve mekanikë:** 40 000;
- **Numri i cikleve elektrike:** 20 000;

Pajisjet mbrojtëse nga mbitensionet sipas normës CEI 61643, shërbejnë për të mbrojtur sistemin elektrik nga mbitensione të paparashikuara të ndodhura nga goditjet e rrufeve apo edhe të atyre goditjeve që vijnë nga vetë rrjeti shpërndarës OSHEE gjatë komutimeve të ndryshme dhe gjatë defekteve të rënda në pajisjet transformuese.



Figura 9 : Shkarkues nga mbitensioni një dhe tre fazore sipas CEI 61643

Karakteristikat e shkarkuesve nga mbitensioni:

- **Tensioni nominal i punës:** 230/400V;
- **Frekuenca:** 50Hz;
- **Fuqia c'kycjes:** 25kA;
- **Koha veprimit:** 25ns;
- **Temperatura punës:** -25, +60C;

Pajisjet matëse sipas normës CEI 60051 shërbejnë për një kontroll të thjeshtë të parametrave të sistemit elektrik. Të domosdoshme gjatë mirëmbajtjes si dhe për eliminim sa më të shpejt të defekteve, këto pajisje ndihmojnë personelin teknik të shërbimit të veprojë shpejt në rast defekti të mundshëm dhe të vrojtojnë në mënyrë periodike të dhënat bazë të rrjetit elektrik si rryma dhe tensioni.

Për personelin e kualifikuar, për kontrollin dhe matjen e saktë të konsumit të energjisë dhe për vrojtimin e parametrave specifike si koeficienti i fuqisë të përdoren pajisje sipas normës IEC 62053-21 si në figurë. Këto pajisje sigurojnë një cilësi të matjes së energjisë aktive në shkallën 1 dhe të energjisë reaktive në shkallë 2.



Figura 10 : Pajisje matëse digitale sipas për matjen e të gjithë parametrave të rrjetit IEC 62053-21

Karakteristikat e pajisjeve matëse digitale:

- **Tensioni nominal i punës:** 230/400V;
- **Frekuenca:** 50Hz
- **Klasa saktësisë për rymën:** 0.5%;
- **Klasa saktësisë për tensionin:** 2%;
- **Klasa saktësisë për energjinë:** 2%;
- **Komunkimi:** MODBUS, RS485

Pajisjet komutuese sipas normës CEI 60947-3 si në figurën 10, janë ato pajisje të cilat bëjnë të mundur takimin apo stakimin e ngarkesës por nuk mund ta mbrojnë rrjetin nga lidhjet e shkurtra e mbingarkesa. Këto nuk janë pajisje mbrojtëse dhe detyrimisht duhet të shoqërohen me automatë ose të përdoren për pajisje dhe qarqe të cilat janë të mbrojtura në vetëvehte. Kanë vecorinë e kostos së ulët, lehtësisë së veprimit dhe shpejtësisë së hapjes dhe mbylljes.



Figura 11 : Pajisje komutuese sipas normës CEI 60947-3

Karakteristikat e komutatorëve:

- **Rryma nominale:** 40 - 250A;
- **Tensioni nominal i punës:** 380/415V;
- **Numri i cikleve mekanike:** 20 000;
- **Numri i cikleve elektrike:** 1 500;
- **Modulare deri ne:** 80A.

4.4 Rrjeti ushqyes

Me rrjet ushqyes nënkuptojmë linjat që nisen nga panelet qendrore të T.U.- 0,4 KV dhe përfundojnë në kuadrot lokale të kateve apo mjediseve të veçanta. Në përputhje me normat VDE, IEC dhe CEI kap. VI linjat ushqyese (si dhe ato shpërndarëse) duhet:

- Te zgjidhen: Sipas kushteve të ngrohjes nga rrymat e punës;
- Te kontrollohen: Ne humbje tensioni

Per mbingrohje nga R.L.SH. Interruptoret (automatet) magnetotermike të çilet instalohen për të mbrojtur rrjetat ushqyese dhe ato shpërndarëse duhet të plotësojnë kushtet që pasojnë:

Kushti 1: $I_b \leq I_n \leq I_z$

Kushti 2: $I_f \leq 1,45 I_z$

- I_n – rryma nominale e automatit (A)
- I_b – rryma e punës (llogaritëse) në A
- I_z – rryma e lejuar e përcjellësve apo kablllove (korrigjuar sipas gjithë koefiçenteve përkatës K1 deri K8 të mënyrës së vendosjes, temperaturës së ambientit, etj.)

Kushti 3: Sipas normave VDE dhe CEI 64 – 8-automatet magnetotermike duhet te plotësojnë:

$$I^2 x t \leq K^2 x S^2$$

Kjo do të thotë që automatet duhet të kenë aftësinë çyqçësë më të madhe se sa vlera e RLSH të llogaritur në piken ku instalohen këta automate. Te gjithë fiderat e paneleve (power center) duhet të pajisen edhe me rele diferenciale të regullueshme si për sa i përket vleftës së rrymës ashtu edhe kohës së veprimit. Ne çdo rast duhet të behet kujdes i veçantë për të plotësuar kudo kushtet e selektivitetit.

4.5 Norma te rrjetit shperndares te grupeve

- Te gjithë grupet e ndriçimit dhe prizave do të mbrohen me automate magnetotermike dhe shkeputes diferencial 30 mA;
- Seksioni i percjellsave të linjave te ndriçimit nuk do të jete me i vogel se seksioni $S=1,5 \text{ mm}^2$ prej bakri. Automatet magneto-termike do të jene 10 A me fuqi maksimale të çdo grupi monofazor jo me shume se 1500 W;
- Seksioni i percjellsave të prizave, që do të përdoren për ndriçim lokal të vendeve të punës gjithashtu do të jene $1,5 \text{ mm}^2$ prej bakri. Automatet njëlloj si pika b me sipër;
- Prizat për aparaturat e ndryshme elektrike të zyrave me fuqi më të vogël ose të barabarte me 2600 W, do të jene me seksion $2,5 \text{ mm}^2$ /baker kurse mbrojtja përkatëse 16 A;
- Për konsumatorët e veçantë me fuqi mbi 3600 W seksionet e percjellsave duhet të merren 4 mm^2 , kurse mbrojtja të jete 25 A;

4.6 Kanalet dhe aksesoret

Aksesoret e instalimeve nen suva jane:

- Tubat fleksibel PVC te dimensioneve te ndryshme ne varesi te dimensionit dhe te numrit te telave/kablllove qe do te futen ne te.
- Kutite per fiksimin e prizave ose te çelesave. Te gjitha keto vendosen para se te behet suvatimi.

Per kryerjen e instalimeve elektrike te futura nen suva duhet te ndiqet rradha e punes si me poshte:

- Hapja e kanaleve ne mur me dimension te tille qe te vendoset lirshem tubi fleksibel dhe me thellesi te tille qe te mos dale mbi nivelin e suvase perfundimtare.
- Vendosen tubat fleksibel dhe kutite prej PVC te cilet provizorisht fiksohen me allçi (me vone mbylljen kanalet me llaç suvatimi)

- Pasi është kryer suvatimi, futen percjellesat ose kabllot, me ane të udhëzuesit të tyre, të cilat duhet të hyjnë lirshëm dhe të lihet në të dy krahet një sasi e mjaftueshme për kryerjen e lidhjeve dhe montimeve të tyre sipas kushteve teknike të instalimit.
- Kanalet dhe vendosja e tubave fleksibel PVC duhet të bëhet në distancë 0.4 m me poshtë nga niveli i tavanit në vijë të drejtë horizontale dhe zbritjet për çelës ose prizat të bëhen vertikale të drejta dhe jo me kënd ose në formë harku.
- Kutitë shpërndarëse në varesi të sistemit që do të përdoret janë për nën suvatim ose mbi suvatim kështu që menyrë e fiksimit të tyre është ose me allçi ose me ane të vidave me upa.
- Permasat e kutive shpërndarëse variojnë sipas rastit dhe nevojës. Ato janë në formë rrethore, katrore ose drejtkëndëshe dhe kapaket e tyre mbylles fiksohen me vida.

E rëndësishme është që lidhja e telave/kabllave brenda në kutitë shpërndarëse të realizohet me ane të klemëve bashkuese/ kapucave lidhës, dhe jo me nastro. Sistemi i kanalave ashtu si sistemi nën suva me tuba fleksibel duhet të plotësojë të gjitha kushtet teknike të instalimeve elektrike.

Impianti elektrik duhet të zbatohet sipas :

- permasave, markes, karakteristikave dhe cilësive të materialit të treguar në projektet e hartuara;
- udhëzimeve të D.R. gjatë kryerjes së punëve ;
- respektimit të ligjeve në fuqi ;

Materialet dhe aparatet që duhet të përdoren në ndërtimin e impiantit duhet të kenë të gjitha cilësitë e fortësive, kohezgjatjes, izolimit dhe të funksionimit të mirë; dhe duhet gjithashtu të jenë të tilla që të rezistojnë veprimeve mekanike, gërryese, termike dhe lageshtires për ato që duhet të jenë në kontakt me të gjatë punës. Gjithashtu, janë nën përgjegjësinë e sipërmarresit montimet dhe cmontimet përkatëse të pjesëve të instalimit për realizimin e provave dhe të verifikimeve.

Të gjitha aparatet, kuadrot, centralët e inkasuar, çelësat, butonat, prizat etj..., duhet të vendosen në vepër nëpërmjet kutive të instaluara me Llaç çimentoje m-1:2, me dozim për m²: çimento 400 kg 527, rërë e lare m³ 0.89 dhe ujë, duke u kujdesur vecanerisht që instalimi i kutive të mesiperme të bëhet rrafsh me murin në lidhje me sipërfaqet e suvatuara dhe të veshura, në menyrë që të mos verifikohen dalje apo futje të tepërta të këtyre kutive.

Tubot PVC fleksibel duhet të jete i nderfutur në kutitë, që përmbajnë celesat ose prizat, që në asnjë menyrë të mos demtojnë që hyjnë në kuti. Është absolutisht i ndaluar përdorimi i llaçit me allçi ose i lendeve të tjera të ngjashme për vendosjen në vepër të kutive, mbylljen e kanaleve të hapura dhe të çdo punimi tjetër në murature të nevojshëm për impiantin.

4.7 Rrjeti i Kabllo te Fuqise

Kabllo e përdorur do të jenë të tipit FG16OR16, dhe FTG10(O)M1, sipas normës CEI 20-20, Classe 5, me cilësi të larta antizjarr dhe pa gazra toksike sipas normës CEI 20-38. Gjithashtu do te perdoren edhe percjelles FS17 per shperndarjen e linjave nga kutite shperndarese ne kutite e celesave te ndricimit.



Figura 12 : Kabllo multipolar te tipit FG16OR16



Figura 13 : Percjelles te tipit FS17

Përshkrim i përgjithshëm per kabllo FG16OR16

Kabllo FG16OR16 është kabllo HEPR fleksibël, i izoluar, me mburojë të endur, të përbërë prej percjellësish me bakër të kuq, me mbrojtje PVC, antikorroziv dhe pa halogjen. Është i përshtatshëm për transmetimin e fuqisë dhe kontrollin e fuqisë në industri dhe ndërtime. I përshtatshëm për instalime fikse të brendshme dhe të jashtëm, instalime në ura, në tuba, etj.

Specifikime teknike:

- Tensioni nominal: U_0/U : 0,6/1kV;
- Tensioni maksimal U_m : 1200V;
- Temperatura maksimale operative: +90°C;
- Temperatura maksimale e qarkut te shkuter: +250°C;
- Fleksibiliteti: Classe 5.

Mbeshtetur ne Standartet:

- CEI 20-13, CEI 20-11, CEI 20-29, IEC 60502-1, CEI UNEL 35375, CEI UNEL 35377 - Konstruksioni dhe kërkesat.
- CEI 20-22 II, CEI EN 60332-1-2 – Cilesi të larta antizjarr.
- CEI EN 50267-2-1 – Antikorroziv.

Ngarkesa e llogaritur për kabllo e mësipërm duhet të repektojnë kushtin:

- Për kabllo 1-6mm² dendësia mesatare e rrymës 4A/mm²;
- Për kabllo 6-16mm² dendësia mesatare e rrymës 2-4Amm²;
- Për kabllo >16mm² dendësia mesatare e rrymës 1-2Amm²;

Kabllo FTG10(O)M1:



Figura 14 : Kabllo multipolar te tipit FTG10(O)M1

Specifikime teknike per kabllo FTG10(O)M1 0.6/1kV:

Percjellesi: Percjellesi bakri fleksibel ne baze te standartit IEC 60228

Izolimi : gome, tipi G10

Mbeshtjellja e jashtme: johalogjen, blu RAL 5012

Tensioni nominal: 0.6/1kV

Diapazoni i temperaturave: -25°C deri ne +90°C

Mbeshtetur ne standartet:

- EN 50266 / IEC 60332-3-24 / CEI 20-22III
- EN 50267-2-1 / IEC 60754-1 / DIN VDE 0482 part.267-2-1
- IEC 60331 / EN 50200

Markat e kablllove do të jene të tipit FG16OR16, per linjat e fuqise dhe ndricuesve normal dhe te emergjences me durueshmeri kundra zjarrit prej 3 oresh me izolacion PVC. Dejet e kablllove do të jene me ngjyra të veçanta dhe standarde (percjellesi i nulit me ngjyre blu, percjellesi i tokezimit ngjyre verdhe-jeshile). Në kabllot trefazore duhet të jene të dallueshme edhe ngjyrat e fazave si edhe toka.

Duke zbatuar këto kushte për ngarkesat në sistemin e fuqisë kabllot do të shfrytëzohen për kohë të gjatë dhe instalimi i tyre do të ketë garancinë dhe jetëgjatësinë e kërkuar. Rrjeti shpërndarës do të përbëhet nga paneli kryesor i cili duhet të vendoset në dhomën teknike dhe nga panelet e kateve. Në secilin panel elektrik do të vendosen pajisje mbrojtëse, pajisjet matëse dhe ato komutuese, të cilat do të bëjnë mbrojtjen, matjen dhe komutimin e konsumatorit.

Kudo që do të shtrihen ura kablllore apo kanalino, kabllot do shtrihen brenda tyre. Atje ku mungojnë urat apo kanalinet murale apo nene dysheme, shtrirja e kablllove të rrjetit shpërndarës do të behet me tuba TVC pesante veteshues të tipit me përbërje dielektrike RK15.

4.8 Seksioni i percjellesit te Nulit

Percjellesat e nulit duhet të kenë seksion më të vogël se seksioni i fazave. Për kabllot me seksion $> 16 \text{ mm}^2$, seksioni i nulit sipas CEI mund të reduktohet deri në gjysmen e seksionit të fazave. Sipas VDE seksioni i nulit duhet gjithmonë (pavarësisht nga seksioni i fazave) i njëllojte me atë të fazave.

5. SISTEMI I RRJETIT TE FUQISË

Persa i perket sistemit te prizave te fuqise ato jane vendosur ne vizatime mbeshtetur ne planimetrite dhe arredimin e brendshem te ambienteve. Ato duhet te kene montim rafsh dhe duhet te kene nje ngjyre qe te shkoje me kapaket e çelësve te ndriçimit. Ky sistem është vendosur ne te gjitha ambientin e objekteve.

Te gjitha prizat jane 230V, 16A, me tokëzim, industriale, per montim jashte murit IP55. Instalimi nga kuadrot e shperndarjes deri tek kutia shperndarese te prizave do te behet me kabell FG16OR16 me $S=3 \times 2.5 \text{ mm}^2$ te futur ne tubo metalik $d=20 \text{ mm}$. Instalimet elektrike te fuqise dhe sinjalizimit qe kalojne ne dysheme behen me tub te rende, kurse ato qe kalojne ne mure dhe tavane jane te serise se lehte.

Tubat e dyshemese jane vendosur nen shtresat e dyshemese dhe ne mure brenda suvase dhe behen para se muret te suvatohen. Tubat duhet te jene te gjitha te pa djegeshme. Projekti parashikon mbrojtjen diferenciale me rele diferenciale 30mA. $R_t < 3\Omega$ dhe mbrojtjen nga LSH me automat termoelektromagnetik.

Linjat e furnizimit jane me tre percjelles dhe karakteristikat e automateve duhet te zbatohen rigorozisht sipas klasit A. B. C. D. (karakteristika termike e momentit te inercise) per te garantuar selektivitet. Percjellesit qe do te perdoren do te jene fleksibel antifiam.

Instalimi i elementeve do te behet si me poshte:

- Lartesia e çelsave do te jete 110 cm nga dyshemeja.
- Laresia e kutive shperndarese 25 cm nga dyshemeja.
- Lartesia e prizave do te jete 40cm nga dyshemeja.

Persa i perket sistemit te prizave te fuqise ato jane vendosur ne vizatime mbeshtetur ne planimetrite dhe arredimin e brendshem te magazines. Te gjitha prizat jane te tipit shuko dhe te pajisura me tokëzim.

6. SISTEMI I NDRICIMIT NORMAL

Pavaresisht ambientit i cili do të ndricohet llogaritja e ndricimit është bërë sipas normes UNI EN 12464 duke krijuar një sipërfaqje uniforme të ndricuar mirë në çdo pjesë të saj dhe të qetë për punën e personelit dhe të gjithë njëzëzve. Ndricimi është projektuar sipas tipologjisë së ambienteve duke plotësuar kushtet dhe normat mbi llojin e ndricimit, niveleve të ndricimit dhe rezikshmërinë e instalimit të ndricimit.

Sipas standartit evropian të ndricimit EN 12464, është respektuar me rigorozitet fuqia e ndricimit sipas ambienteve si më poshtë:

▪ Ambientet e zyrave	500lux
▪ Dhoma e sallës së mbledhjeve	500lux
▪ Ambienti Teknik	200lux
▪ Korridoret	200 lux
▪ Tualete	150 lux
▪ Shkallet	150lux

Për ndricimin e objektit është projektuar i gjithë rrjeti i ndricimit dhe sipas tipologjisë së ambienteve janë vendosur këto tipe ndricuesisht :

- a. Tipi i ndricuesit të përdorur në ambientet e klasave



Figura 15 : Ndricues LED 36W, 60x60cm

Specifikimet teknike të ndricuesit Panel Led 36W, 60x60cm, IP40:

▪ Montimi:	Inkaso i instaluar në tavan
▪ Burimi i dritës :	LED;
▪ Sistemi optik :	difuzor opal;
▪ Sistemi i ndricimit:	Direkt;
▪ Instalimi :	me kitin e transformatorit AC/DC;
▪ Ushqimi :	220-240 V, 50-60 Hz;
▪ Fuqia Instaluar :	1x36W;
▪ Fluksi i ndricimit	3600lm;
▪ Shkalla e mbrojtjes :	IP 20;
▪ Klasa mbrojtjes mek:	IK 07;
▪ Pesha ndricuesit :	8.1kg;
▪ Dim. (LxWxH) :	(605x605x101)mm ;
▪ Sipërperfunduar:	White RAL 9003 (W03);
▪ Sistemi Efikasitetit:	100lm/W
▪ Indeksi I ngjyres :	CRI(Ra) 80+
▪ Ngjyra e tempera:	4000K
▪ Kendi i rrezes:	60°
▪ Temp. Punes:	-20°C në +35°C
▪ Jetegjatesia:	50,000 ore pune, me efikasitet të lartë.

b. Ndricues industrial LED, 1x43W, IP65



Figura 16 : Ndricues industrial LED 1x43W, IP-65

Specifikime teknike te ndricuesit:

- **Montimi:** I montuar jashte tavanit
- **Burimi i drites :** LED;
- **Ushqimi :** 220-240 V, 50-60 Hz;
- **Fuqia Instaluar :** 1x43W;
- **Fluksi i ndricimit** 4100lm;
- **Shkalla e mbrojtjes :** IP 65;
- **Dim. (LxWxH) :** 1215mm
- **Siperf.perfunduar:** White RAL 9003 (W03);
- **Indeksi i ngjyres :** 80 Ra
- **Ngjyra e tempera:** 4000K
- **Jetegjatesia:** 50,000 ore pune, me eficence te larte.

c. Ndricules mural LED, 19W, IP65



Figura 17: Ndricules mural LED 19W, IP65

Karakteristikat teknike:

- Reference:	EN60598-1; EN 62471;
- Modeli:	Mural;
- Montimi:	Montuar ne sipërfaqe te murit;
- Burimi I drites:	Ndricim LED ;
- Sistemi optikal:	Difuzor opal;
- Shperndarja e drites:	Direkt;
- Materiale:	Alumin i bardhe;
- Ngjyra e jashtme:	E bardhe RAL 9003 (W03);
- Burim Tensioni	220-240 [V];
- Frekuenca:	50 [Hz];
- Faktori I Fuqise (cos (fi):	0.95;
- Fuqia e Ndriculesit:	19[W];
